Republika e Kosovës
Komuna e Kaçanikut

# KOMUNA E JUAJ PËR JU

# VJETARI 2010

Janar 2011

Boton:
Komuna e Kaçanikut

Përmbajtja:
Zyra e Informimit
http://kk.rks-gov.net/kacanik/

Retushimi profesional:
Klubi i Gazetarëve të Kaçanikut

Shtypi: Shtypshkronja “ERA” Ferizaj

Shpërndarja falas

*Bashkëqytetarë të nderuar,*

*Besoj se e ndani mendimin tim se viti që e lamë pas ishte një vit i sukseseve të Komunës sonë. Janë miratuar dy dokumentet strategjike zhvillimore për periudhën vijuese 10-vjeçare; Plani Zhvillimor Komunal dhe Plani Zhvillimor Urban. Arritje tjetër që duhet vlerësuar është shpallja nga MAPL-i e Komunës së Kaçanikut si më e mira në Republikën e Kosovës sa i përket shërbimeve administrative ndaj qytetarëve. Kanë vazhduar investimet e shumta në infrastrukturën rrugore, shkollore, rrjete kanalizimesh, ujësjellësish, terrene sportive etj. Edhe më 2010 ka vijuar trendi i shtimit të arkëtimit të mjeteve nga tatimi në pronë dhe burimet tjera vetjake komunale. Edhe në këtë vëllim të Vjetarit 2010 në mënyrë kronologjike janë përfshirë vetëm punët dhe aktivitetet më me peshë gjatë tërë vitit.*

*Vazhdojmë të besojmë se bashkëpunimi i ndërsjellë na bënë më të suksesshëm.*

*Me respekt,*
*Xhabir Zharku*
*Kryetar i Komunës*

# Ekzekutivi dhe përbërja e tij



*Heset Loku, Nënkryetar i Komunës*



*Xhabir Zharku,, Kryetar i Komunës*



*Xhelal Gash,i kryesues i Kuvendit të Komunës*



*Jeton Topalli, drejtor i Administratës së Përgjithshme*



*Misim Sopa, drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale*



*Azem Guri, drejtori i Drejtorisë së Arsimit e Kulturës*



*Fikri Vërbani, drejtor i Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit*



*Bekim Troni, drejtor i Drejtorisë së Urbaniz-mit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Ambientit*



*Rushan Ceka, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë*



*Nuhi Provoliu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural*



*Shqipe Ceka asistente dhe shefe e protokollit*



*Hajrush Dullovi, shef i Zyrës së Informimit*



*Fadil Guri, shef i personelit*



*Zeqir Selmani, shef i Zyrës së Prokurimit*

Anëtarët e Kuvendit të Komunës bashkë me kryetarin z. Xhabir Zharku



*JANAR 2010*

## Kryetari Zharku vizitoi institucionet shtetërore pak minuta pas ndërrimit të moteve

**1 janar** - Pak minuta pas ndërrimit të moteve, kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku, i ka vizituar stafet kujdestare të institucioneve përgjegjëse për sigurinë dhe shëndetin e qytetarëve. Vitin e Ri 2010 z.Zharku ia ka uruar personelit kujdestar të Stacionit Policor në Kaçanik, sikundër edhe personeleve të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe të Shërbimit të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit. Kryetari Zharku i ka përgëzuar stafet e institucioneve të sipërpërmendura shtetërore për përkushtimin e tyre për të qenë në shërbim të qytetarëve edhe në ditë festash. Ndërkaq, nikoqirët nuk e kanë fshehur kënaqësinë për praninë e kryetarit Zharku në mesin e tyre edhe në çastet festive, ndërsa i kanë premtuar atij se do të vazhdojnë të punojnë me përkushtim për sigurinë dhe shëndetin e qytetarëve.

## Shërbyesit civilë ftohen t'i kryejnë obligimet ndaj Komunës

**5 janar** - Komuna ka vendosur që asnjë punëtor i Shërbimit Civil Komunal nuk do të jetë pjesë e kësaj strukture nëse paraprakisht nuk e ka të paguar obligimin ndaj tatimit në pronë. Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku ka thënë nuk ka kuptim që ata zyrtarë të cilët paguhen nga buxheti t'i kenë borxh buxhetit apo të kërkojnë nga qytetarët që t'i paguajnë taksat. Kjo masë e paralajmëruar ka filluar të zbatohet dhe është duke ndikuar në mbushjen e arkës së tatimit në pronë. Menaxheri i Zyrës së Tatimit në Pronë, z. Xhelal Dema ka theksuar se brenda një jave 29 punonjës komunalë borxhlinj të tatimit në pronë e kanë kryer këtë obligim. Ndërkaq, sipas z. Fadil Guri, shef i personelit, kontratat e punës shërbyesve civil do t'u vazhdohen vetëm pasi ta kenë sjellë dëshminë se e kanë shlyer borxhin ndaj tatimit në pronë.

# Komuna ndan 5 mijë euro për përmbytjet në Shqipëri

**12 Janar** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, ka marrë vendim për ndarjen e 5 mijë eurove, ndihmë familjeve të zonave të përmbytura nga vërshimet e fundit në Shqipëri. Kryetari z. Zharku ka apeluar me këtë rast edhe te përfaqësuesit e bizneseve dhe të gjithë ata që kanë mundësi që t'u dalin në ndihmë familjeve të prekura nga vërshimet atje.

# Zgjidhet sportisti i vitit

**15 janar** - Futbollisti i Lepencit, z. Rinor Zeneli, është shpallur sportisti më i mirë për vitin 2009 në komunën e Kaçanikut. Në një ceremoni të organizuar nga Drejtoria e Arsimit dhe e Kulturës, çmimin e parë Zenelit ia ka ndarë kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku. Vendi i dytë i ka takuar z. Xhevdet Shabanit, po ashtu futbollist i të njëjtës skuadër, ndërsa i treti është shpallur hendbollisti z. Ibrahim Brruti (KH Lepenci). Tetë sportistët më të mirë të kësaj komune janë nderuar me medalje dhe mirënjohje. Me mirënjohje janë nderuar edhe donatorët dhe punëtorë sportiv të cilët e kanë ndihmuar sportin kaçanikas gjatë vitit të kaluar. Kryetari z. Zharku ka premtuar me këtë rast se brenda mundësive buxhetore komunale do ta ndihmojë sportin e kësaj komune edhe në të ardhmen.



## Emërohen drejtuesit e ekzekutivit

**18 janar** - Në përputhje me nenin 60.2 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe nenin 76 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, e ka emëruar zëvendësin e tij dhe drejtuesit e të gjitha dikastereve të qeverisë komunale për mandatin e sapofilluar katërvjeçar. Në postet më të larta të pushtetit ekzekutiv për qeverisjen "Zharku 2" janë emëruar: z. Heset Loku, nënkryetar i Komunës, z. Fikri Vërbani- drejtor i Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, z. Azem Guri- drejtor i Arsimit dhe Kulturës, z. Bekim Troni- drejtor i Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, z. Misim Sopa- drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, z. Rushan Ceka- drejtor i Emergjencës dhe Shërbimeve Publike, z. Jeton Topalli- drejtor i Administratës së Përgjithshme dhe z. Nuhi Provoliu, drejtor i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë.

## Nxënësit semajas kthehen në shkollën amë

**19 Janar** - Komuna ka siguruar udhëtimin e 14 nxënësve të fshatit Semajë, të cilët deri tani kanë vijuar mësimin në Gaçkë të Ferizajt. Nxënësit tash e tutje do ta vijojnë mësimin në shkollën fillore "Nazmi Osmani" në Elezaj dhe do të udhëtojnë me kombibus, ndërsa shpenzimet do t'i heq Komuna. Për t'i sjellë në shkollën amë, simbolikisht



kishte shkuar në Semajë edhe drejtori i Arsimit, z. Azem Guri dhe ai i ShF "Nazmi Osmani", z. Zijadin Osmani, të cilët një udhëtim e kanë bërë bashkë me njomakët. Drejtori z. Guri, është shprehur me këtë rast se, tash e tutje të gjithë nxënësit e fshatit Semajë, nga klasa e gjashtë e deri në të nëntën do ta vijojnë mësimin në shkollën fillore "Nazmi Osmani" në Elezaj dhe do ta do ta kenë të siguruar përherë transportin në të dy drejtimet.

## Turqit interesohen për investime në Kaçanik



**21 Janar -** Përfaqësuesi i firmës turke "Muson", z. Irfan Kurtulmus, ka qëndruar në një vizitë në komunën tonë dhe është takuar me kryetarin e Komunës, z. Xhabir Zharku. Ky biznesmen është interesuar të investojë në ndërtimin e një qendre tregtare. Pronari i kompanisë tregtare, industriale e ndërtimore, është joshur nga kushtet të cilat i janë ofruar nga kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku. Kryetari i ka prezantuar lokacionet e dy zonave industriale dhe të hapësirës komerciale në Fushë të Pajtimit, si vende shumë të volitshme për investime. Ai u ka premtuar përfaqësuesve të "Muson" edhe lehtësira të tjera, si truallin për periudhën 10-vjeçare dhe, nëse investimi është i

madh, dhënien e hapësirës në shfrytëzim deri në 99 vjet, por edhe lirimin nga tatimi, në kohëzgjatje deri në 5 vjet.

## KK-ja i kompletoi komitetet e obligueshme

**27 Janar -** KK i Kaçanikut ka formuar dy komitetet e obligueshme: Komiteti për Politikë dhe Financa është kompletuar me përbërjen e vet, ndërsa në atë të Komuniteteve kanë mbetur për t'u emëruar vetëm edhe përfaqësuesit nga shoqëria civile. KPF-në 7-anëtarësh e përbëjnë: z. Xhelal Gashi (kryesues i KK-së), z. Zekirja Loku, z. Kemajl Murseli dhe znj. Arbnora Sallahu të PDK-së, pastaj z. Shukri Luta e z. Shyqeri Luzha të AAK-së dhe z. Daut Rudi i LDK-së. Ndërkaq, nga përbërja e KK-së për anëtarë të Komitetit 5-anëtarësh të Komuniteteve janë emëruar: z. Rami Çaka (AAK), z. Ibrahim Hoxha (LDK) dhe znj. Sherife Troni (AKR), ndërsa dy anëtarë nga shoqëria civile ka mbetur të emërohen më vonë.



# Shtraza bëhet me shkollë të re

**29 Janar** - Rreth 50 nxënës nga klasa e parë deri në atë të shtatën të fshatit Shtrazë, tani e tutje do të kenë kushte më të mira për vijimin e procesit mësimor. Falë një investimi të disa shoqatave italiane nga krahina e Sardenës dhe Komunës, ky fshat është bërë me shkollë të re. Në një ceremoni solemne godinës së re shkollore i është prerë shiriti të premten, ndërsa përveç banorëve të këtij fshati, në inaugurimin e saj kanë marrë pjesë edhe një delegacion i gjerë nga komunat e kësaj krahine italiane dhe ata të Komunës tonë. Shiritin e përurimit e kanë prerë: z. Xhabir Zharku- kryetar i Kaçanikut, znj. Rosario Cadelano (ALPO), z. Isa Rexha, drejtor shkolle dhe z. Mustafë Lika, administrator i fshatit Shtrazë. Kjo shkollë i ka 4 dhoma mësimi dhe pjesët tjera përcjellëse, ndërsa është ndërtuar në lokacionin e quajtur "Te Tupani" afër "Lagjes së Re" të Shtrazës.



*SHKURT 2010*

# Diskutohet drafti final i PZHK-PZHU-së

**2 Shkurt** – Në ambientet e objektit të Administratës komunale të Kaçanikut është prezantuar drafti final i Planit zhvillimor komunal dhe Planit zhvillimor urban të Komunës tonë. Prezantimin e këtyre planeve e ka bërë z. Hasim Kryeziu, përfaqësues i kompanisë "Data Gis Consulting", e cila është kontraktuar nga Komuna, për hartimin e këtyre planeve. Në këtë paraqitje kanë marrë pjesë edhe ekspertë komunalë të fushave të ndryshme, të cilët janë pjesë e hartimit të këtij plani, si dhe qytetarë tjerë. Këtij drafti i ka dhënë note pozitive z. Shpend Agaj, përfaqësues i Institutit të Planifikimit Hapësinor (MMPH), ndërkohë që z. Heset Loku, nënkryetar Komune, këtyre planeve ua ka bërë disa vërejtje terminologjike.



# "Elita" interesohet për funksionimin e KKSB-së

**3 Shkurt** - Përfaqësues të Qendrës së Pavarur Kulturore Informative Rinore "Elita" me seli në komunën e Vitisë, janë takuar me kryetarin z. Xhabir Zharkun, ndërsa kanë shprehur interesimin rreth funksionimit të Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi në këtë komunë. Përfaqësuesi i "Elitës", z. Emrush Azemi ka thënë se kjo OJQ është

partnere implementuese dhe ndihmon funksionimin e KKSB-ve në komunat: Kaçanik, Viti dhe Ferizaj. Ndërkaq, kreu i Komunës tonë, z. Xhabir Zharku ka përmendur si shqetësuese mungesën e disiplinës, përdorimin e substancave narkotike dhe alkoolit nëpër shkollat e mesme.



## Avokati i Popullit viziton Kaçanikun

**4 Shkurt** - Avokati i Popullit, z. Sami Kurteshi me bashkëpunëtorë të tij kanë vizituar komunën e Kaçanikun dhe është takuar me kreun e Komune, z. Xhabir Zharkun. Avokati Kurteshi ka shprehur përpjekjen e këtij institucioni për shtrirjen e bashkëpunimit me të gjitha



institucionet e Kosovës, në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Nga ana tjetër, kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku i ka ofruar gatishmëri avokatit Kurteshi për bashkëpunim me këtë institucion i cili mbron të drejtat e njeriut.

## GK-ja përcaktohet për projektet e donacionit zviceran

**5 Shkurt** - Grupi Komunal i projektit Zvicër-Kosovë, për përkrahjen e qeverisjes lokale dhe decentralizimit LOGOS, është përcaktuar për prioritetet e investimeve për tre vjetët e ardhshme, nëse komuna jonë përzgjidhet për të përfituar nga një donacion i Qeverisë Zvicerane. Fondacioni zviceran "Inter Coorporation" është implementuese e projekteve të cilat Qeveria helvetike i realizon nëpërmjet zyrës së saj në Prishtinë. Zviceranët nëpërmjet këtij projekti janë përcaktuar të investojnë në fushën e planifikimit dhe menaxhimit të burimeve dhe në atë të administratës e shërbimeve publike. GK-ja është përcaktuar



për realizimin e hartimit të planit rregullativ të qytetit të Kaçanikut dhe renovimin e objektit të Administratës komunale, Zyrës së arkivit komunal, ndërtimin e Zyrës së Vendit në Kaçanik të Vjetër, ndërtimi i Qendrës për regjistrimin e automjeteve, ndërtimi i rampave për personat me aftësi të kufizuar, vendosja e hidrantëve në disa pjesë të komunës së Kaçanikut, rregullimi i gjelbërimit, mbjellja e fidanëve dhe vendosja e shportave për mbeturina në qytetin e Kaçanikut dhe disa projekte të tjera trajnuese e furnizuese. Grupin komunal të Kaçanikut e udhëheq z. Jeton Topalli, drejtor i Administratës së Përgjithshme, ndërsa janë përfshirë edhe zyrtarë të tjerë të fushave përkatëse.

## Komuna zbulon shkelje ligjore



**9 Shkurt** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, në një konferencë me gazetarë ka përmendur një rast të shkeljeve ligjore me skemat sociale, ku një qytetar kishte përfituar ndihma sociale për një fëmijë të pa ekzistuar. Rasti është zbuluar si rezultat i informacioneve nga qytetarët, ndërsa është hulumtuar nga një komision komunal dhe ka marrë rrugën e hetimeve të mëtutjeshme. Kryetari z. Xhabir Zharku, është shprehur këmbëngulës në hetimin e të gjithë përfituesve të kësaj ndihme. Fëmija inekzistent ishte regjistruar më 4 prill 2005.

# Intervistë e kryetarit Zharku dhënë të përditshmes "Zëri"

**11. Shkurt** - Xhabir Zharku e ka marrë edhe një mandat të dytë për ta udhëhequr Komunën e Kaçanikut. Sovrani kaçanikas ia ka dhënë besimin për ta pasur në krye të Komunës edhe për katër vjetët e ardhshëm. Si e gjeti Komunën në momentin kur e pranoi postin e kryetarit? Me çfarë probleme u ballafaqua dhe cilat ishin përparësitë që i lehtësuan përmbushjen e objektivave? Çfarë projekte realizoi dhe çfarë ka në plan për këtë mandat të ri? Cilat janë rezultatet e dyvjeçarit të qeverisjes, e cilat janë dështimet?...

Zëri: Çfarë keni ndryshuar në qeverisjen e kaluar, nga ajo që e keni trashëguar?

Xhabir Zharku: Me ardhjen time në mandatin e kaluar dyvjeçar kam ndryshuar qasjen dhe metodën e punës dhe kam krijuar disiplinë tek stafi i Administratës komunale...



Zëri: Cilat janë të arriturat e Komunës, e cilat janë dështimet?

Xhabir Zharku: **Të arriturat janë:** shërbimet ekspeditive në pajisjen me dokumente personale dhe të udhëtimit të qytetarëve, ndikimi në vetëdijesimin e për kryerjen e obligimeve financiare ndaj Komunës, realizimi i projekteve të infrastrukturës rrugore në qytet dhe nëpër fshatra, e cila është mundësuar edhe në saje të përkrahjes nga Qeveria e Kosovës. Ndërkaq, ndihem keq sepse buxheti i Komunës është i limituar dhe pamundëson realizimin e shumë projekteve, përndryshe nuk ka pasur asnjë dështim, që mund t'i referohet neglizhencës së stafit tim profesional.

Zëri: Gjatë mandatit të kaluar keni pasur një akuzë. Sa e ka vështirësuar kjo punën e kreut të Komunës?

Xhabir Zharku: Akuzat të cilat janë ngritur ndaj meje janë fabrikim i shërbimeve sekrete serbe, të cilat për mua dhe opinionin në Kosovë janë të njohura. Gjatë kohës së zgjedhjeve 2007 janë gjetur individ të caktuar të cilët me prapavijë politike dhe qëllime komprometuese kanë hedhur akuza kundër meje dhe PDK-së. Natyrisht se këto akuza më kanë penguar në ushtrimin e detyrës sime. I jam përgjigjur drejtësisë, edhe pse ajo ndonjëherë është e brishtë dhe nën nivelin e kompetencave të saj. Sovrani i qytetarëve ka vlerësuar se unë duhet t'u prijë atyre edhe për katër vjetët e ardhshëm. Ky mund të shërbejë edhe si mesazh i qartë për organet e drejtësisë, e sidomos për EULEX-in.

Zëri: Qeverinë "Zharku 2" e keni kompletuar me përbërjen e vjetër

Xhabir Zharku: Në këtë mandat kam rizgjedhur të njëjtin staf qeverisës, ngase gjysma e tyre kanë më pak se një vit që janë zgjedhur në postet e drejtorive komunale, por edhe mendoj se ka pasur suksese të dukshëm. Tash për tash për një kabinet qeverisës ndryshe nuk ka nevojë.

Zëri: Cilat janë prioritetet kryesore të qeverisjes suaj katërvjeçare?

Xhabir Zharku: Do të vazhdojmë me investime në infrastrukturë rrugore, kanalizime, shkolla, etj. Do të përpiqemi të sjellim investitorë nga vendet e rajonit në zonat industriale dhe komerciale, në mënyrë që të gjenerojmë vende të reja pune.

Zëri: Çfarë mund të presin nga kjo qeveri familjet, nxënësit, pacientët, qytetarët...?

Xhabir Zharku: Në momentin kur të përmbyllen punimet e objektit të banimit kolektiv në lokacionin të cilin e kemi dhënë me koncesion, nga hisja që i takon Komunës (20 për qind) do të përpiqemi që në mënyrë racionale t'i ndajmë disa banesa për familje të dëshmorëve që nuk kanë strehim të siguruar, por edhe për familje eventuale që kanë nevojë emergjente për banim. Jam i vetëdijshëm se kjo nuk mund t'i përmbush kërkesat e të gjithë qytetarëve që kanë nevojë për strehim, por me përpjekje për alternativa të reja brenda mundësive financiare do të vazhdojmë edhe në të ardhmen. Ndërkaq, sa i përket infrastrukturës fizike nëpër shkolla, me ndërtimin e objekteve të reja shkollore, që besojmë se do të fillojnë së shpejti, do të zgjidhet ky problem i trashëguar nga e kaluara. Në shëndetësi kemi bërë përpjekje për të përmirësuar sadopak situatën e rëndë, por mundësitë e kufizuara buxhetore komunale pothuaj pamundësojnë përparimin në këtë segment të rëndësishëm.

Zëri: Cilat do të jenë burimet financiare për përmbushjen e agjendës sivjet dhe cila do të jetë panorama e Kaçanikut në vitin 2013?

Xhabir Zharku: Do të përpiqem që me prezantimin e projekteve të arsyeshme te donatorët e jashtëm dhe te Qeveria e Republikës së Kosovës, do të përfitojmë donacione për të zhvilluar dhe përmbushur objektivat të cilat tashmë i kemi bërë edhe publike. Jam i bindur që viti 2013 do të karakterizohet me shumë suksese dhe ndryshime të mëdha për të mirë. Synimet zhvillimore në komunën tonë mbetet që t'i bëjmë realitet gjatë këtij mandati, ndërsa qytetarëve ua lëmë t'i bëjnë vlerësimet.

Zëri: A do t'i lejoni hapësirë edhe opozitës, për idet dhe propozimet që mund të kenë ata?

Xhabir Zharku: Gjithsesi, kërkoj nga qytetarët që me vërejtjet, sugjerimet dhe angazhimin e tyre për çështje konkrete të japin kontributin e tyre dhe të bëhen pjesë e projekteve zhvillimore. Po ashtu kërkoj edhe nga opozita që të kenë qasje konstruktive, duke propozuar projekte konkrete dhe këshilla të tjera, jo vetëm në strukturat komunale në të cilat ata përfaqësohen. U garantoj se në funksion të projekteve progresive të Komunës, kontributi i opozitës do të jetë i mirëseardhur. Në fund dua ta shfrytëzoj rastin e kësaj interviste që t'u bëj ftesë të gjithë qytetarëve që,

nëse hasin në ndonjë rast të keqpërdorimit apo korrupsionit nga zyrtarët, t'i paraqesin me emra e mbiemra dhe me argumente, sepse kështu mund t'i luftojmë këto dukuri. Adresimi i problemeve është forma më e mirë dhe më e ndershme si dhe patriotizmi më institucional për zgjidhjen e problemeve në një shoqëri demokratike dhe shtetformuese.
(E intervistoi: Kjani Sallahu, gazetar)

## Shumë aktivitete për Ditën e Pavarësisë

**12 Shkurt -** Për nder të dyvjetorit të Pavarësisë së Kosovës, në komunën tonë janë paraparë një mori aktivitetesh. Më 17 shkurt do të mbahet një akademi solemne, pastaj një ekspozitë me motive nga Dita e Pavarësisë dhe një mega-koncert, në të cilin do të marrin pjesë Ansambli i Këngëve dhe Valleve "Shota" dhe këngëtarët Violetë Kukaj, Riza Bytyqi, Ismet Bexheti, Ismet Bogujevci etj. Po ashtu do të ketë një defile të fëmijëve nëpër rrugët kryesore të qytetit dhe një koncert për fëmijë. Nga aktivitetet sportive do të zhvillohen finalet e një turneu të futbollit në kategorinë e meshkujve dhe atë të femrave. Këto aktivitete janë organizuar nën përkujdesjen e kryetarit z. Xhabir Zharku.

## Komuna paralajmëron fituesit e tenderëve

**12 Shkurt** - Komuniteti shpesh është ankuar se kompanitë po i stërgjatin kryerjen e punimeve në projekte të ndryshme të cilat janë kontraktuar nga Komuna, nga ministritë e Qeverisë së Kosovës, por edhe projektet e financuara nga donatorë të jashtëm. Të paktën për projektet e këtyre dy të fundit janë ankuar disa herë edhe vetë autoritet komunale. Qeveria komunale ka paralajmëruar ndërmarrësit që konkurrojnë në tenderët e saj, se do të kërkojë nga ata seriozitet dhe ekspeditivitet në zbatimin e projekteve të cilat i kontrakton Komuna. kryetari i Komunës së Kaçanikut, z. Xhabir Zharku, u ka thënë

pronarëve të disa kompanive vendëse, të cilat kanë marrë deri tani dhe pretendojnë edhe në të ardhmen projekte të Komunës se, projektet të cilat kontraktohen nga Komuna duhet të realizohen brenda afatit të kontratës, përndryshe do të ndëshkohen kompanitë përkatëse. Kreu i Komunës ka kërkuar nga ndërmarrësit që të jenë edhe dinamik në kryerjen e punëve, por të kenë edhe cilësi të punës dhe të materialit. Për vitin 2010 janë planifikuar 24 projekte në vlerë rreth 1.3 milion euro.



# Urimi i Kryetarit për Ditën e Pavarësisë

**16 shkurt-** Qytetarë të nderuar të komunës së Kaçanikut!
Kam kënaqësinë time, që me rastin 17 shkurtit - dy vjetorit të Pavarësisë së vendit, të gjithë qytetarëve të komunës së Kaçanikut dhe më gjerë t'ua uroj:

Gëzuar Festa e Pavarësisë!
Kosova e pavarur, sovrane e demokratike sot feston Ditën e Pavarësisë, për të cilën ditë u derdh shumë gjak. Edhe në këtë ditë feste, me krenari i kujtojmë dëshmorët e rënë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, ata që dhanë më të shtrenjtën, jetën e tyre, që ne të festojmë sot të lirë.
Gjaku i tyre u bë themel i së sotmes dhe të ardhmes së vendit.
Urime!
Gëzuar përgjithmonë!

Me respekt,
Kryetari i Komunës
z. Xhabir Zharku



# Përkujtohet veprimtari Baki Dullovi

**17 Shkurt** - Me një manifestim të mbajtur në shkollën e fshatit Biçec është përkujtuar në dyvjetorin e ndarjes nga jeta veprimtari i çështjes kombëtare Baki Dullovi, i cili pat ndërruar jetë një ditë para shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Nëpërmjet një fjale rasti jetën dhe veprimtarinë e këtij atdhetari e ka përshkruar z. Kjani Sallahu, kryetar i Këshillit organizues. Ai e ka vlerësuar këtë figurë si ndër më aktivët të veprimtarive kombëtare për zgjidhjen e çështjes shqiptare në trojet etnike. Në emër të institucioneve të Komunës së Kaçanikut tubimin e ka përshëndetur kryetari z. Xhabir Zharku. Të pranishmëve me disa fjalë i është drejtuar edhe veprimtari i dalluar i çështjes kombëtare dhe aktivisti i LNDSH-së, z. Rexhep Bunjaku. Një telegram përshëndetës e ka dërguar nga Gjermania z. Emin Fazlia (alias Emil Kastrioti), bashkëveprimtar në LNDSH, ndërsa në emër të familjes së veprimtarit Baki Dullovi, i ka falënderuar pjesëmarrësit djali i tij z. Rufki Dullovi.



# Promovohet dokumentari “Heshtat e Lirishtës”

**17 Shkurt** - Në Shtëpinë e Kulturës “Xheladin Kurtaj” është promovuar dokumentari “Heshtat e Lirishtës”, i cili u është kushtuar dëshmorëve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Avdulla Baftiut, Bashkim Vishit, Nazmi Osmanit, Kemal Kolshit dhe Nazim Terziut, të cilët ranë në altarin e lirisë në dy beteja të ndara në Biçec dhe në Jezerc të Ferizajt. Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, në një fjalë rasti e ka vlerësuar lartë sakrificën e dëshmorëve të rënë për lirinë e Kosovës. “Luftëtarët trima, me në krye komandantin legjendarë Adem Jasharin, të frymëzuar nga historia e lavdishme e të parëve tanë, mblodhën forcë dhe guxim në luftë për ta bërë Kosovën të lirë e të pavarur”, është shprehur kryetari Zharku. Fjalë përshëndetëse më rastin e përurimit të këtij dokumentari ka prezantuar Hajrush Kurtaj, ish-zëvendëskomandant i Brigadës 162 të UÇK-së "Agim Bajrami", ndërsa në emër të këshillit organizues ka përshëndetur z. Tefik Vishi. Ky dokumentar i autorit Xheladin Rexhepi është sponzoruar nga banorët e fshatit Dubravë të Kaçanikut.



# Kaçanikasit festuan Ditën e Pavarësisë



**18 Shkurt** - Me një seri aktivitetesh kulturore-artistike e sportive, është shënuar dyvjetori i pavarësisë së Kosovës. E veçanta e këtij manifestimi ishte performansa e Ansamblit të Këngëve dhe Valleve "Shota" nga Prishtina, e cila për herë të parë ka marrë pjesë në një solemnitet të tillë në Kaçanik. Programin e valleve artistike dhe këngëve të interpretuara nga këngëtarë të mirënjohur të estradës kosovare e kanë ndjekur një numër jashtëzakonisht i madh i dashamirëve të këngëve dhe valleve, ndërsa ky eveniment kulturor ka shënuar edhe përfundimin e aktiviteteve njëditore të dyvjetorit të lindjes së shtetit të Kosovës. Për nder të kësaj feste paraprakisht është mbajtur një akademi solemne në të cilën ka folur kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, i cili ka përvijuar nëpër periudha veprimtarinë atdhetare dhe sakrificën e brezave për lirinë e shqiptarëve. Më pas, përmes një video-projektori janë shfaqur imazhe filmike të realizuara para dy vitesh me rastin e kremtimit në Kaçanik të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Në hollin e Pallatit të Kulturës "Xheladin Kurtaj" është hapur edhe një ekspozitë me fotografi me përmbajtje të përgatitjeve për Pavarësinë e Kosovës dhe ditën e shpalljes së saj shtet i pavarur. Nga aktivitetet sportive janë zhvilluar finalet e futbollit të vogël në kategorinë e femrave dhe atë të meshkujve. Aktivitetet kanë filluar me një defile të fëmijëve

nëpër rrugët e qytetit, të cilët të grumbulluar në një masë të madhe fëmijësh i kanë dhënë vërtet një imazh festiv dhe gjallëri nismës së Ditës së Pavarësisë. Gjatë gjithë ditës nëpër rrugë të qytetit, të stolisur me flamuj kombëtar e shtetëror, kanë defiluar edhe automjete në shoqërim të sirenave. Për nder të kësaj dite janë bërë edhe homazhe te Varrezat e Dëshmorëve të komunës tonë.

## Ridestinohen mjetet e bartura nga viti i kaluar

**18 Shkurt** - Ekzekutivi i Komunës mjetet e pashpenzuara nga vitit i kaluar i ka ridestinuar për t'i shpenzuar sivjet. Shuma e mjeteve të ridestinuara është 118.839 euro dhe do t'i shpërndahen 8 programeve buxhetore. Për investime kapitale janë ridestinuar 41.600 euro, për paga e mëditje 26.574 euro, për mallra e shërbime 33.575 euro, për subvencione e transfere 13.950 euro dhe për shërbime komunale 3.141 euro. Nga 10 mijë euro të mjeteve të ridestinuara për investime kapitale do të shpenzohen për renovimin e objektit të administratës komunale dhe për bashkëfinancim të disa projekteve, 15 mijë euro për blerjen e një veture zyrtare dhe 6.600 euro për shpenzime të hartimit të planit zhvillimor dhe urban të Kaçanikut, me 16.879 euro do të kompensohet



stafi mjekësor për shpenzimet e shujtës për 4 muajt e fundit të vitit të

kaluar. Nga mjetet e rindara për subvencione dhe transfero 5 mijë euro janë destinuar si donacion për OVL të UÇK-së, 6 mijë euro për shpenzimet e sezonit vjeshtor të KF Lepenci dhe 2.150 euro për mbështetje të aktiviteteve të SHKA "Shqiponja".

## Duhanpirësve u sigurohet vend i veçantë

**22 Shkurt** - Pirja e duhanit në objektin e Administratës komunale të Kaçanikut dhe në institucione tjera publike është ndaluar në qershor të vitit 2008. Me ndërtimin edhe të një kati të objektit të administratës komunale, në katin përdhes është liruar hapësirë e mjaftueshme në njërën nga ish-zyrat e Drejtorisë së Financave, ku tani është shndërruar në vend për pirjen e duhanit. Pirjen e duhanit në objektet publike e kishte ndaluar kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, me një vendim në përputhje me Ligjin për duhanin nr.02/L-36/2007.

## Kryetari takoi koordinatorin e projektit LOGOS



**23 Shkurt** - Koordinatori i projektit, z. Norbert Pijls dhe kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, kanë diskutuar për projektet e propozuara të komunës sonë të cilat iu janë prezantuar për financim projektit LOGOS. Z. Pijls e komentoi listën e

projekteve të propozuara nga komuna jonë, duke vlerësuar se Komuna ka bërë përzgjedhje të duhur të projekteve, ndërsa e ka veçuar përcaktimin për hartimi i Planit rregullativ për qytetin e Kaçanikut. Ndërkaq, kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku ka përkujtuar se Komuna është në fazën finale të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban për qytetin e Kaçanikut, duke vlerësuar se është i nevojshëm edhe hartimi i Planit rregullativ për qytetin. Projekti "Përkrahja për qeverisje lokale dhe decentralizim"- LOGOS, është projekt për qeverisje lokale, i financuar nga Qeveria Zvicerane, nëpërmjet Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë- SCO, ndërsa realizohet nga Fondacioni zviceran "Intercoorporation".

## Largpërçuesit në prag të çrrënjosjes nga trotuarit

**24 Shkurt** - Dy largpërçuesve të tensionit të lartë në bulevardit "Ismail Raka" do të dislokohen nga trotuari. Po ashtu edhe shtyllat e rrjetit shpërndarës të rrymës përgjatë kësaj rruge do të shuhen tërësisht, pasi rrjeti ajror do të shndërrohet në atë kabllor nëntokësor. Për këtë qëllim kanë nënshkruar marrëveshje kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku dhe z. Avni Alidemaj, drejtor ekzekutiv i divizionit të rrjetit (KEK). Komuna e ka marrë për obligim t'i zgjidhë çështjet pronësore-juridike për komplet projektin, ndërtimin e kanalizimit për shtrirjen e kabllove dhe gypave të rrjetit, ndërtimin e pusetave dhe punët fizike. KEK-u do t'i realizojë punët teknike, pastaj sigurimin e kabllos 10 (20) kV në gjatësi 3.300 metra, pajisjen me dy shtylla çeliku të gjata 15 metra, betonimin dhe tokëzimin e shtyllave, sigurimin e kokave kabllore të brendshme e të jashtme dhe të shkarkuesve katodik, si dhe kryerjen e punëve profesionale për shtrirjen dhe montimin e kabllos së sipërpërmendur. Dy largpërçuesit aktualë do të largohen tërësisht nga trotuari ekzistues, ndërkohë që dy shtyllat e reja nga çeliku do të vendosen më poshtë në hapësirën e gjelbër të pjesës së epërme të shtratit të lumit Neredime.

# Caritas-i edhe sivjet ndihmon dy fshatra të komunës tonë

**24 Shkurt** - Fondacioni qeveritar CARITAS nga Luksemburgu ka bërë të ditur se edhe këtë vit do të ndihmojë me donacione komunitetet e fshatrave Biçec dhe Kaçanik i Vjetër. Koordinatori i CARITAS-it, z. Rifat Krasniqi ka thënë se edhe për vitin 2010 kjo organizatë do të investojë nga 45 mijë euro në këto dy fshatrat: në infrastrukturë nga 20 mijë euro, në sektorin social-ekonomik nga 10 mijë euro, për rini dhe fëmijë nga 10 mijë euro dhe për ambientit nga 5 mijë euro. Nga ana tjetër kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku ka premtuar mbështetjen e Komunës për këto projekte, ndërsa këto donacione dhe angazhimin e komunitetit e ka cilësuar si për avancimin e kushteve të jetesës së banorëve të këtushëm. Koordinatori i KZHK të fshatit Biçec, z. Kjani Sallahu, ka bërë të ditur në këtë takim se tash për tash banorët e këtij



fshati janë përcaktuar për zgjerimin dhe asfaltimin e rrugës kryesore të Biçecit, ndërtimin e një muri ambiental te shkolla e fshatit, etj. Fshatrat e sipërpërmendur edhe vitin e kaluar kanë përfituar nga 45 mijë euro donacion nga CARITAS-i i Luksemburgut.

# Kryetari Zharku priti një delegacion të FSK-së

**25 Shkurt** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku ka pritur në zyrën e tij një delegacion të Forcës së Sigurisë së Kosovës, të udhëhequr nga z. Enver Cikaqi, komandant i KDF dhe z. Shemsi Syla, shef i Njësisë Ndërlidhëse për Reagim në Kriza.
Komandanti i KDF, z. Cikaqi ka thënë me këtë rast se për 400 vende të lira deri më tani kanë aplikuar mbi 3200. Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, i përgëzoi pjesëtarët e FSK-së për misionin e tyre, ndërkaq tha se FSK-ja është e ushtria e ardhshme e Kosovës. Kryetari Zharku ka vlerësuar se regrutët duhet të jenë vajza dhe djem të rinj, të cilët dinë të çmojnë vlerat e lirisë dhe të jenë të përkushtuar për arritjen e nivelit për të synuar inkuadrimin në forcat e NATO-së.



# Kryetari Zharku takohet me kolonelin Robert Fode

**25 Shkurt** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, në një takim miqësor dhe njoftues ka takuar kolonelin amerikan Robert Fode, zëvendëskomandant i Brigadës Shumëkombëshe të Lindjes.

Koloneli Fode e përgëzoi kryetarin për mandatin e tij të dytë dhe u shpreh i bindur për një bashkëpunim të ndërsjellë. Me këtë rast koloneli Fode i ka dhuruar kryetarit Zharku një pikturë me flamuj të SHBA-së dhe Kosovës. Nga ana tjetër, kryetari Zharku e falënderoi kolonelin amerikan për vizitën dhe dhuratën, ndërsa u shpreh i gatshëm për bashkëpunim të dyanshëm.



# Aprovohet bartja e mjeteve të pashpenzuara

**26 Shkurt** - KK i Kaçanikut ka aprovuar propozim-vendimin për bartjen e bilanceve të pashpenzuara nga vitet 2008 e 2009 në vitin 2010. Z. Fikri Vërbani, drejtor i Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, ka bërë të ditur se janë 118.839 euro, të cilat janë shpërndarë nëpër kategori buxhetore të këtij viti, prej të cilave 26.573 euro janë ridestinuar për paga e mëditje, 33.129 euro për mallra e shërbime, 11.378 euro për shërbime komunale, 21.157 euro për subvencione dhe 26.600 euro për investime kapitale. Vërbani ka thënë se në kuadër të kësaj shume të ridestinuar janë përfshirë edhe borxhet e mbetura nga viti i kaluar. KK i Kaçanikut ka vendosur edhe për shpalljen e konkursit për formimin e komiteteve konsultative, anëtarët e të cilit do të zgjidhen nëpërmjet konkurrencës me konkurs. Në këtë mbledhje këshilltarët janë njoftuar edhe me buxhetin e vitit 2010, me vlerësimet buxhetore për vitet 2011 dhe 2012, si dhe për realizimin e mjeteve buxhetore për periudhën janar – dhjetor 2009.



*MARS 2010*

# KKSB nis me takimet e vitit 2010

**3 Mars** – Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi, pas një pauze për shkak të zgjedhjeve lokale, ka rinisur me takimet e rregullta. Në mbledhjen e parë të këtij viti, gjendja e sigurisë në komunën tonë është vlerësuar të jetë e mirë, pasi nuk është shënuar ndonjë rast i cili e ka cenuar sigurinë e përgjithshme. Kreu aktual i Stacionit të Policisë në Kaçanik, togeri Jaser Jaha, ka prezantuar disa të dhëna nga raporti i policisë për vitin 2009. Ai ka thënë se në raport me vitin 2008, vitin që lamë pas të gjitha llojet e veprave penale kanë shënuar rënie, ndërkohë që janë regjistruar rritje të aksidenteve të trafikut, 16 sish më shumë se një vit më parë. Disa shqetësime i kanë prezantuar edhe përfaqësues të shoqërisë civile. Z. Ekrem Dauti (Shoqata e Zejtarëve) ka shprehur preokupimin e shembjes së një pjese të rrugës afër "Lagjes së Re", mungesën e pjerrinave në objektet e institucioneve publike për personat me aftësi të kufizuara etj.



# Nënshkruhet Marrëveshja e Mirëkuptimit për PEPF-në

**4 Mars** - Nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku dhe drejtori i Institutit për Politika Sociale në MPMS, z. Gafurr Podvorica, kanë nënshkruar një Marrëveshje Mirëkuptimi për formimin e Komiteteve Lokale të Veprimit për eliminimin e punës së fëmijëve.

Marrëveshja ka për qëllim zyrtarizmin e procesit të monitorimit të punës së fëmijëve si dhe parandalimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve nga eksploatimi ekonomik dhe nga kryerja e punëve që pengojn ë edukimi n e tyre ose qe janë te dëmsh me për shëndet in dhe zhvillimi n psiko-fizik, mendor, shpirtër or,



moral dhe shoqëror të fëmijës.KLV do të përbëhet nga 20 anëtarë, zyrtarë të përzgjedhur që përfaqësojnë institucione të niveleve lokale si: drejtorë të drejtorive komunale, ai i Qendrës për Punë Sociale, përfaqësues të Policisë, OJQ-ve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, etj.

# Kryetari uron mësuesit për 7 Marsit

**5 Mars** - Në Ditën e Mësuesit ne të gjithë kujtojmë mësuesit tanë të dashur që patëm me vite, ata që na mësuan e edukuan, ata që u bënë pjesë e pandarë e jetës dhe suksesit tonë, që nuk kursyen asgjë për ti pasuruar nxënësit me dije, kulturë dhe edukatë.
Mësuesit tanë qëndruan besnik misionit fisnik të arsimimit e edukimit të brezave, edhe atëherë kur regjimi okupues serb mendoi se do ta ndal ABC-në shqipe duke mbyllë shkollat shqipe në Kosovë. Populli ynë hapi zemrat, hapi shtëpitë shkolla. Shumë mësues u dënuan e u gjykuan, por asnjëherë nuk u gjunjëzuan në rrugën e diturisë dhe lirinë e atdheut, duke sakrifikuar edhe jetën.
Ne i kujtojmë me respekt!
Të dashur mësues, Gëzuar festën tuaj!

Kryetari i Komunës
z. Xhabir Zharku



## Shënohet 12-vjetori i "Epopesë së UÇK-së"

**7 Mars** - Me ndezjen e zjarreve te Varrezat e Dëshmorëve, në kuadër të manifestimit "Epopeja e UÇK-së", u shënua "Nata e Zjarreve". Pos qytetarëve të shumtë, morën pjesë edhe udhëheqës komunal, familjarë të dëshmorëve dhe ish-ushtarë të UÇK-së. Për nder të kësaj dite, dje, institucionet komunale, OVL e UÇK-së dhe qytetarët, kanë bërë homazhe pranë varreve të dëshmorëve. Lule pranë varreve të dëshmorëve ka vënë edhe gjenerali i ushtrisë shqiptare, z. Kudusi Lama, një ushtarak i lartë profesional, i cili ka dhënë një kontribut të madh në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.



# Nderohen dëshmorët e Betejës së 8 Marsit 1999

**8 Mars** - Në 11-vjetorin e Betejës së 8 Marsit 1999, në fshatin Ivajë janë bërë nderime dhe u vendosën kurora lulesh pranë lapidarit të ngritur të dëshmorëve: Murat Lika, Qani Luma, Raif Koraçi dhe Osman Luma. Në emër të institucioneve komunale kurora lulesh ka vënë nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku. Lule kanë vënë edhe përfaqësues të OVL-UÇK-së në Kaçanik, bashkëluftëtarë të dëshmorëve, përfaqësues të shkollës së fshatit Ivajë, përfaqësues të fshatit Ivajë, familjarë të dëshmorëve, etj.



# Iniciohet themelimi i SHFPPP-së në Kaçanik

**11 Mars** - Pronarët e pyjeve private të Kaçanikut kanë ndërmend që për shfrytëzimin e pronës së tyre pyjore, kultivimin dhe mbrojtjen e saj, ta bëjnë në mënyrë më të organizuar dhe më institucionale. Në një seminar njëditor të mbajtur nga organizata holandeze për zhvillim-SNV, është formuar një grup nismëtar për themelimin e Shoqatës së familjeve pronare të pyjeve private në Kaçanik. Në këtë seminar është shpjeguar se si duhet të organizohen pronarët e pyjeve private, për zhvillimin e këtij sektori dhe pse duhet të organizohen në shoqatë vepruese. Z. Bashkim Gashi, përfaqësues i Asociacionit të Pronarëve të Pyjeve Private të Kosovës, shoqatë e themeluar para pesë vitesh, ka theksuar se në tërë vendin janë 132 mijë pronarë pyjesh private të cilët kanë në pronësi të tyre 42 për qind të pyjeve në Kosovës. Ndërkaq, duke iu referuar statistikave pyjore në komunën e Kaçanikut, z. Muhamet Çallaku, përgjegjës i APK-së në këtë komunë, ka saktësuar se janë 14.982 hektarë pyje, prej të cilave 5.500 janë në pronësi private. Në të ardhmen do të mbahet Kuvendi i SHPPP-së në degën e Kaçanikut dhe do të zgjidhen strukturat e saj. Ky projekt është mbështetur edhe nga SIDA suedeze dhe MBPZHR-ja.



# Komuna kërkon ndihmën e Qeverisë për lagjen buzë shembjes

**12 Mars** - Nëpërmjet një shkrese zyrtare e cila u është shpërndarë medieve, Komuna e Kaçanikut e ka ftuar ekzekutivin kosovar që t'i dalë asaj në ndihmë financiare për sanimin e gjendjes së krijuar në lagjen "Ramadan Agushi" në qytet dhe për parandalimin e shembjeve të reja. "Kërkojmë nga Qeveria e Kosovës, që me mjete nga fondi rezervë për raste emergjente, të intervenojë në sanimin e gjendjes në këtë lagje të qytetit", apelohet në kërkesën e Drejtorisë së Emergjencës dhe Shërbimeve Publike të Kaçanikut, e cila i është adresuar kryeministrit Thaçi dhe ministrave z. Ahmet Shala (MEF) e z. Zenun Pajaziti (MPB). Në ftesën për ndihmë financiare të nënshkruar nga z. Rushan Ceka, drejtor i DESHP-së, thuhet se: Komuna nuk mund ta përballojë financiarisht përmirësimin e situatës së krijuar, për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore.

# Nis dislokimi i largpërçuesve



**12 Mars** – Dy largpërçuesve të tensionit të lartë të cilët ndodhen mu në mes të trotuarit të shëtitores së vetme në qytetit, kanë filluar të dislokohen. Kompania e

kontraktuar ka nisur themelin e ri, ku edhe do të vendosen këto dy largpërçues, përskaj lumit Neredime. Ky projekt është bashkfinancuar nga Komuna dhe KEK-u. Krahas dislokimit të këtyre dy largpërçuesve, edhe shtyllat e rrjetit shpërndarës të rrymës përgjatë kësaj rruge do të hiqen, pasi rrjeti elektrik ajror do të shndërrohet në rrjet nëntokësor dhe do të përshkoj stazën e shëtitjes përgjatë lumit Neredime.

## QKMF-ja së shpejti edhe me 5 specialistë

**23 mars** - QKMF-ja në Kaçanik ka vendosur për pesë emrat e mjekëve të cilët do të shkojnë në specializim për fusha të ndryshme mjekësore. Komisioni ka përzgjedhur mjekët: z. Sinan Zenelin e znj. Havushe Kaloshin për specializim për mjekësi familjare, z. Mentor Trenën për specialist radiolog, znj. Dashurije Gashin për biokimiste dhe znj. Zoja Gurin për specializim për gjinekologe. QKMF-ja aktualisht ka 17 mjekë të lëmive të ndryshme.



## Komuna dhe MAPL-ja financojnë shkollën e fshatit Vatë

**23 Mars** - Nënkryetari i komunës, z. Heset Loku, në emër të kryetarit z. Xhabir Zharku, dhe Ministri i Ministrisë së Administratës së Pushtetit Lokal, z. Sadri Ferati, kanë nënshkruar një Marrëveshje Mirëkuptimi për bashkëfinancimin e projektit "Ndërtimi i shkollës 4 klasëshe" në fshatin Vatë.
Palët nënshkruese janë dakordua për mënyrën e financimit të projektit, ku MAPL do ta financojë këtë projekt me 100 mijë euro, ndërsa Komuna e Kaçanikut me 30 mijë e 561 euro.

## Tetë filloristë udhëtuan për në Gjermani

**24 Mars** - Në shoqërim të arsimtarit Izet krivanjeva, 8 nxënës (fëmijë të dëshmorëve) të shkollës fillore "Emin Duraku", kanë udhëtuar për në Dortmund të Gjermanisë. Ky grup nxënësish do të qëndrojë një javë te nikoqiri - mësuesi z. Kemajl Çallaku. Gjatë kësaj kohe nxënësve do t'u mundësohet vizita e shkollave shqipe që veprojnë në Dortmund. Qëllimi i vizitës është binjakëzimi i shkollës fillore "Emin Duraku" me shkollën shqipe në Dortmund.

# Përkujtohen të rënët e Kotlinës së Kaçanikut

**24 Mars** - Me një akademi përkujtimore të mbajtur në Pallatin e Kulturës "Xheladin Kurtaj", janë përkujtuar në 11-vjetorin e rënies së 11 dëshmorëve të UÇK-së dhe 15 martirëve të luftës, të cilët ranë ditën kur Aleanca Veri-Atlantike nisi sulmet mbi caqet ushtarake-policore serbe. Fjalën e rastit në këtë akademi e ka mbajtur z. Heset Loku, nënkryetar i Komunës. Jetën dhe veprën e të rënëve të 24 marsit 1999, nënkryetari Loku e ka cilësuar si një kapitull të ndritur për atdheun. Në emër të familjeve të të rënëve, të pranishmit i ka falënderuar z. Mustafë Loku, ndërsa në vazhdim janë shfaqur inserte që i kanë përshkuar momentet e dhimbshme të familjeve kotlinase para 11 viteve. Për ta përkujtuar këtë përvjetor gjatë ditës janë mbajtur edhe aktivitete të tjera memoriale.



# “Kaçanikasja”- pjesë e turneut të futbollit në Shkodër

**26 Mars** - Ekipi i femrave në futboll, “Kaçanikasja” dhe një ekip i meshkujve i grupmoshës deri në 16 vjet, kanë udhëtuar për në Shkodër, për të marrë pjesë në turneun “Lojërat popullore 2010”, të cilat organizohen nga OJQ “The Door Albania” dhe mbështeten nga Bashkia e Shkodrës, Komuna e Qerretit dhe komuniteti i biznesit në Shkodër. Ekipet e futbollit do të zhvillojnë ndeshje miqësore me ekipet shkodrane. Bashkë me këto dy ekipe të shoqëruar nga zyrtarë komunalë. Për në Shkodër kanë udhëtuar edhe grupi i valleve të SHKA “Shqiponja”, e cila do të shfaq një program atje.



## SHKA " Shqiponja" zuri vendin e parë në Shkodër

**29 Mars** - Në lojërat popullore "Fest 2010", të mbajtur në Shkodër, SHKA "Shqiponja" nga Kaçaniku zuri vendin e parë në konkurrencën e valleve. "Vjelja e mollëve" ishte vallja me të cilën kaçanikasit kanë trimfuar në këtë eveniment kulturor.
Në këto lojëra kanë marre pjesë: Shkodra, Kaçaniku, Qerreti, Shkreli, Rubiku, Guri i Zi, Kastrati dhe Tuzi.



# Miratohet raporti i punës së ekzekutivit

**30 Mars** - Raporti i punës së ekzekutivit për vitin e kaluar ishte njëra nga temat e cila nga pozita është cilësuar si raport i realizuar në mënyrën më të mirë të mundshme, ndërkohë që partitë opozitare nuk e kanë ndarë të njëjtin mendim. Këshilltarët e partisë më të madhe opozitare (AAK) dhe ata të AKR-së kanë abstenuar në miratimin e përmbajtjes së punës së dikastereve të ekzekutivit, ndërsa ata të LDK-së kanë qenë kundër vlerësimit që të jetë punuar mirë gjatë vitit të kaluar. Raportit i kanë thënë po vetëm këshilltarët që përbëjnë partinë në pushtet dhe këshilltarja e vetme e LDD-së, znj. Elife Murseli, përderisa AAK e AKR kanë abstenuar, përkatësisht LDK-ja ishte kundër.

Në këtë seancë është caktuar lokacioni për vendosjen e bustit të heroit kombëtar Idriz Seferi. Këshilltarët janë pajtuar me propozimin që busti i këtij patrioti të vendoset në Rr. “Agim Bajrami”, përballë Postës së Vjetër.



# Kaçaniku përfiton nga LOGOS-i

**31 Mars** – Krahas 7 komunave të regjionit të Gjilanit, edhe komuna e Kaçanikut është përzgjedhur për të përfituar nga projekti LOGOS, i cili financohet nga Qeveria Zvicerane. Përfshirja e komunës tonë në këtë projekt është konfirmuar në një takim ndërmjet përfaqësuesve të këtij projekti dhe krerëve komunalë. Projekti Zvicër-Kosovë për përkrahjen e qeverisjes lokale dhe decentralizimit (LOGOS), komunave u jep ndihmë teknike dhe financiare në fushat: planifikim e menaxhim të burimeve si dhe në administratë e shërbime publike. Ky projekt implementohet nga fondacioni zviceran "Intercooperation", ndërsa marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet palëve të sipërpërmendura do të nënshkruhet më 14 prill, në një ceremoni të organizuar në Prishtinë.



*PRILL 2010*

# Për tre muaj arkëtohen 112 mijë euro

**1 Prill** - Gjatë tremujorit të parë të vitit 2010 janë grumbulluar gjithsej 111.744 euro. Gjatë muajit mars janë grumbulluar 36.250 euro, prej tyre 34.205 euro nga të hyrat vetjake komunale dhe 2.315 euro nga gjobat e trafikut. Shuma e grumbulluar paraqet realizimin në shkallë 20.3 % të planit buxhetor të këtij viti, ka theksuar z. Fikri Vërbani, drejtor i FEZH-së. Në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ishin grumbulluar gjithsej 105.899 euro apo 5.845 euro më pak se sivjet.
Konform Ligjit për Menaxhimin e Financave është hartuar Rregullorja e brendshme e cila në operimet buxhetore përcakton detyrat dhe përgjegjësit e zyrtarëve financiar.

# Mesazhi i kryetarit për punonjësit arsimorë

**2 Prill** - Në një takim me drejtorët e shkollave të komunës së Kaçanikut, të ftuar nga drejtoria përkatëse, kryetari z. Xhabir Zharku u ka përcjellë mesazhe atyre për vigjilencë ndaj dukurive negative nëpër



tempujt e diturisë. Kryetari Zharku u ka sugjeruar drejtorëve që të marrin masa ndaj arsimtarëve të cilët krijojnë mungesa në punë, si dhe të shtohet kujdesi më i madh higjenik në objektet shkollore. Ai ka tërhequr vërejtjen se nëpër shkolla po tolerohen veshjet e gjinisë femërore jashtë standardeve të lejuara. Në seancën e kaluar të Kuvendit Komunal janë shprehur vërejtje edhe për vandalizëm të nxënësve, për mbishkrime banale nëpër mure e inventar, për suksesin e dobët të nxënësve dhe për sjellje jo të mira si dhe dukuri të tjera negative nëpër disa shkolla.

## Nëntëdhjetë përfitues potencialë të subvencionit të MBPZHR-së

**3 Prill** - Nëntëdhjetë fermerë nga komuna jonë përfitojnë nga një subvencion i Ministrisë së Bujqësisë. Është përmbyllur afati i aplikimit dhe se 90 aplikacione janë pjesë e përfituesve potencialë. Ky subvencion iu ndahet fermerëve të cilët kanë së paku pesë lopë qumështore dhe mështjerra për reproduksion. Përfituesit e kësaj ndihme do të marrin mjete të gatshme financiare, por ende nuk dihet saktësisht vlera e të hollave. Udhëheqës të Drejtorisë së Bujqësisë... e kanë cilësuar si punë të kryer përfitimin e kësaj ndihme.



## PZHK-PZHU pranohet nga qytetarët

**4 Prill** - Plani zhvillimor komunal dhe ai urban kanë marrë në heshtje miratimin e qytetarëve të komunës tonë. Për dy muaj rresht sa ka qëndruar ky plan në Pallatin e Kulturës “Xheladin Kurtaj”, për t’i shprehur qytetarët vërejtjet apo sugjerimet e mundshme, në fletoren përkatëse nuk është shënuar asnjë syresh. Përkundrazi, këto dy plane kanë marrë dy komplimente të qytetarëve. Në vazhdim pritet të bëhet vlerësimi përfundimtar edhe nga këshilli i ekspertëve, grupet punuese dhe komisioni i vlerësimit, ndërsa drafti final do t’i adresohet KK-së për miratim. PZHK-PZHU është duke u hartuar nga kompania prishtinase “Data Gis Consulting”.

## Eliminohen rreth 200 qenë endacakë

**6 Prill** - Në një aksion të organizuar nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, fundjavën që lamë pas janë eliminuar rreth 182 qenë endacakë. Z. Mustafë Loku, zyrtar i DBPZH-së, ka theksuar se në këtë aksion janë përfshirë qyteti dhe lokalitetet: Bob, Kovaçec, Biçec, Nikaj, Rekë, Dubravë, Doganaj, Koxhaj dhe Kaçanik i Vjetër. Në lokalitet tjera aksioni do të vazhdojë të shtunën dhe të dielën e ardhshme. Për këtë projekt Komuna ka akorduar një shumë prej 3.080 euro, ndërsa ka kontraktuar Shoqatën e Gjuetarëve për punët në terren. Aksioni për eliminimin e qenve endacakë është zhvilluar me kërkesë të qytetarëve.

## Fillon FKPF "Kaçaniku 2010"




**8 Prill** - Për nder të përvjetorit të 11-të të "Betejës së 9 Prillit" dhe rënies së dëshmorëve dhe martirëve në "Lagje të Re" dhe "Rakoc", në Kaçanik ka filluar Festivali IV i këngës popullore për fëmijë "Kaçaniku 2010". Festivalin, i cili do të mbahet tri ditë rresht, e ka shpallur të hapur z. Fatmir Çaka, zyrtar i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës. Në mbrëmjen e parë të këtij evenimenti kulturor për fëmijë janë paraqitur 13 interpretues- nxënës të shkollave fillore, përkatësisht të mesme të ulët nga mbarë komuna. Të përzgjedhurit e kësaj mbrëmje, bashkë me më të mirët të cilët do të shfaqen në skenë në mbrëmjen e dytë të festivalit, do të garojnë në natën finale të premten mbrëma. Ky festival është organizuar nga DAK-ja dhe është tradicional, ndërsa mbahet nën patronazhin e kryetarit të Komunës.

## Vihet gurthemeli i Stadiumit "Besnik Begunca"

**9 Prill** - Për nder të 11-vjetorit të betejave në "Lagje të Re" dhe "Rakoc" të Kaçanikut, është bërë inaugurimi i gurthemelit për ndërtimin e tribinave të stadiumit të futbollit "Besnik Begunca". Inaugurimin e punimeve të këtij projekti e kanë bërë z. Xhabir Zharku, kryetar komune dhe z. Sabit Raka, babai i dëshmores Jehona Raka. Në këtë ceremoni përuruese kryetari Zharku realizimin e këtij projekti e ka cilësuar si modest, por që për simpatizuesit e skuadrës së Lepencit ka vlerësuar se do të jetë një komoditet për përcjelljen e ndeshjeve. Ai u

ka bërë thirrje edhe donatorëve vendës dhe sportdashësve që të japin edhe kontributin e tyre për ta kompletuar këtë objekt sportiv. Vlera e këtij projekti është 33 mije euro, prej të cilave 30 mije euro i ka dhuruar USAID-i amerikan, ndërsa 3 mije euro Komuna.



## Përkujtohen 28 dëshmorë dhe 32 martirë të luftës

**9 Prill** - Me manifestime përkujtimore të mbajtura në “Lagje të Re” dhe “Rakoc” janë përkujtuar në 11-vjetorin e rënies 28 dëshmorë të kombit dhe 32 martirë të luftës së fundit në Kosovë. Në këto tubime kanë marrë pjesë përfaqësues të strukturave komunale dhe shumë qytetarë nga mbarë komuna. Në fjalën e rastit në Rakoc, z. Burim Bajra nga këshilli organizues, ka vlerësuar se përpjekjet për liri dhe të drejta njerëzore e kombëtare janë instikti dhe vetëdija më e



natyrshme e çdo populli, prandaj edhe ne si komb luftuam për këtë ideal. Ndërkaq, Zekirja Loku u ka bërë thirrje institucioneve kompetente që ta shkruajnë denjësisht historinë e luftës çlirimtare të Kosovës, të cilën e bënë dëshmorët dhe të rënët. "Apeloj te institucionet qendrore shkencore e arsimore, Institutin e Historisë, shtresat intelektuale, që këtë pjesë të historisë më të re të Kosovës, luftën e komandantit legjendar Adem Jashari dhe të UÇK-së, ta prezantojë denjësisht në literaturën shkencore dhe në tekstet shkollore", ka bërë thirrje publike z. Loku. Tubimet i kanë përshëndetur në emër të Komunës, z. Xhelal Gashi e z. Nuhi Provoliu, ndërsa në emër të familjeve të dëshmorëve të pranishmit i kanë falënderuar pjesëmarrësit znj. Kosovare Thaçi e znj. Arbnora Çaka. Tubimet janë shoqëruar edhe me pjesë artistike. Ky përvjetor është shënuar edhe me aktivitete të shumta kulturore e sportive.

## Përmbyllet FKPF "Kaçaniku 2010"

**9 Prill** - Kënga e mirëfilltë popullore shqipe e legjendës së gjallë, Nexhmije Pagarushës, vazhdon të pëlqehet edhe më tej dhe të interpretohet edhe nga gjenerata t e reja. Këngët e



"Bylbylit të Kosovës" janë pjesë e pandashme e Festivalit tradicional të këngës popullore për fëmijë "Kaçaniku", i cili mbahet qe katër vjet me radhë. Kënga "E kujtoj atë takim", e interpretuar nga Ermelinda Luzha, është fituese e festivalit të katërt "Kaçaniku 2010", ngjarje kulturore e cila është mbajtur për nder të 11-vjetorit të betejave të 9 Prillit në Rakoc dhe Lagje të Re të Kaçanikut. Çmimin e dytë e ka marrë Fajtona Malsiu, me interpretimin e këngës "S'paske pas një pikë mëshirë", ndërsa vendin e tretë e ka zënë Adelina Guri me këngën "O bilbil me pika-pika". Publiku shpërblimin e vet ia ka dhënë Delvin Shehut, interpretuesit të këngës "Vet më the të dua". Fituesit e FKPF-së janë nderuar me nga një punim artistik. Juria e këtij festivali përbëhej nga z. Tefik Shehu, z. Sylejman Haxhiu dhe z. Ruzhdi Gjini. Ky festival është organizuar nga Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, ndërsa kanë marrë pjesë nxënës të shkollave fillore, përkatësisht të mesme të ulët nga mbarë komuna.

## "Handikos" kërkon qasje fizike në institucione

**14 Prill** - "Një ambient i përshtatshëm- shoqëri për të gjithë", ishte temë kryesore e debatit i organizuar nga "Handikos" në Kaçanik, në të cilin kanë marrë pjesë persona me aftësi të kufizuara , shoqëria civile dhe institucionet lokale. Një grup i anëtarëve të "Handikosit" bashkë me përfaqësues të këtij projekti paraprakisht kanë defiluar nëpër rrugët e qytetit, për t'i identifikuar mungesat e qasjes nëpër trotuaret e rrugëve të qytetit dhe nëpër institucionet publike. Të evitohen dhe të zvogëlohen problemet e qasjes në këto segmente dhe të krijohen kushte të përshtatshme për pjesëmarrje të PAK-së në institucionet vendimmarrëse, ishte kërkesa e përfaqësuesve të kësaj shoqate. Nga ana tjetër, autoritetet komunale kanë shprehur gatishmëri për t'i dalë në ndihmë kërkesave të "Handikosit" dhe kanë premtuar se do të investojnë në ndërtimin e pjerrinave nëpër objekte të institucioneve

publike. Në Kosovë llogaritet se ndërmjet 150 deri në 200 mijë persona janë me aftësi të kufizuara.

## Kremtohet Festa e Abetares

**16 Prill** - Në Shtëpinë e Kulturës, Xheladin Kurtaj" në Kaçanik, nxënësit e klasave të para të shkollës fillore "Emin Duraku" nga Kaçaniku me një program të pasur me këngë, valle e recitime kanë shënua Festën e Abetares. Në Festën e Abetares murrën pjesë mësues, prindër, nxënës, e të tjerë ndërsa ishte i pranishëm edhe kryetari i komunës, z. Xhabir Zharku dhe drejtori i arsimit z, Azem Guri.

Kryetari i komunës, z. Xhabir Zharku me këtë rast para të pranishmëve premtoi se së shpejti do të fillon së ndërtuari shkolla në Dushkajë ndërkaq tha se do të bëjmë rinovimin e shkollës fillore "Emin Duraku" që të krijohen kushte më të mira për mësim cilësor.



Drejtoresha e shkollës, znj. Sevdije Shehu uroi yllkat dhe fatosat për Festën e Abetares ndërkaq ka thënë se më 1908 në Manastir u miratua alfabeti i sotëm i gjuhës shqipe.

# DESHP ndëshkon shkelësit e rregullave të trafikut



**21 Prill** - Një plan operativ i Drejtorisë së Emergjencës dhe Shërbimeve Publike ka bërë që të shtohen mekanizmat e ndëshkimit së shkelësve të rregullave të trafikut në komunën tonë. Në këtë plan është përfshirë kontrolli ndaj shoferëve që tejkalojnë shpejtësinë e lejuar nëpër rrugët lokale, operatorëve të transportit të udhëtarëve të cilët mbingarkojnë autobusët dhe të auto-taksive ilegale. Në këto operime të DESHP-së ka asistuar edhe Policia e Kosovës. Z. Menduh Krasniqi, shef i Shërbimeve Publike, ka thënë se gjatë një operacioni kemi hasur në tre shoferë të automjeteve të cilët ushtronin ilegalisht veprimtarinë e taksive, e të cilëve u janë konfiskuar tabelat e regjistrimit të automjeteve dhe librezat e qarkullimit në kohëzgjatje për 5 ditë. Po ashtu, brenda një ore në lokalitetin Kaçanik i Vjetër, policia ka shqiptuar tri gjoba për tejkalim të shpejtësisë, ndërsa disa shoferëve u është tërhequr vërejtja e fundit. Në një kombi-taksi me 9 ulëse, kemi numëruar deri në 20 persona teksa po transportoheshin në destinacion, ka thënë z. Krasniqi,. Ndërkaq, z. Rushan Ceka, drejtor i DESHP-së, ka shprehur gatishmërinë për vazhdimin e këtij plani. Këtij plani i kanë paraprirë kërkesa të shumta të qytetarëve.

## Kryetari amniston maturantët



**22 Prill** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, i ka falur 29 maturantë të gjimnazit "Skënderbeu", të cilët u patën përjashtuar nga shkolla vetëm një muaj para se ta përfundojnë shkollimin e mesëm. Kryetari Zharku i ka përkujtuar maturantët problematikë se këtë amnisti e bën në shenjë respekti dhe nderimi për jetën dhe veprën atdhetare, sakrificën sublime dhe përvjetorit të 11-të të rënies së dëshmorit Feriz Guri- komandant "Shpatës". Megjithatë, ai i ka përkujtuar nxënësit e rikthyer në shkollë se nëse një maturanti i regjistrohen vetëm edhe 5 mungesa deri në fund të këtij viti shkollor, nuk do ta gëzojë mbrëmjen e maturës dhe rrjedhimisht as pajisjen me diplomë të shkollës së mesme.

## Inspektohen punimet në rrugën e fshatit Kotlinë

**22 Prill** - Zyrtarë nga Ministria e Transportit dhe Poste-Telekomunikacionit, z. Ismet Hoxha, shef i divizionit të projekteve, z. Shaban Latifaj, drejtor teknik në Drejtorinë e rrugëve dhe z. Skender Muçolli, menaxher regjional i rrugëve, të shoqëruar nga nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku dhe drejtori i Urbanizmit, z. Bekim Troni, kanë inspektuar punimet e projektit të asfaltimit të rrugës së fshatit Kotlinë.

Rruga ka gjatësinë 7.500 metra, nga rruga magjistrale deri te shkolla e fshatit, ndërsa aktualisht është duke u bërë gërmimi i dheut për zgjerimin e trupit ekzistues të rrugës. Sipas projektit, do të bëhet asfaltimi i rrugës në gjerësi 5 metra dhe trashësi 8 centimetra.



## Komuna së shpejti i rikthen NP-të

**23 Prill** - Dy ndërmarrjet publike në komunën e Kaçanikut "Pastërtia" dhe "Lypeteni" së shpejti do të monitorohet nga Komuna, pasi kjo e fundit në përputhje me Ligjin për ndërmarrjet publike, ka nisur procedurat për krijimin e mekanizmave të mbikëqyrjes së këtyre dy ndërmarrjeve. Kryetari i Komunës, z.



Xhabir Zharku, ka marrë vendim për themelimin Komisionit komunal të aksionarëve për NKP "Lypeten" dhe KRM "Pastërtia" sh.a. - njësia në Kaçanik. Ky komision përfaqëson Komunën dhe ka për detyrë që t'i emërojë bordet katëranëtarëshe të këtyre ndërmarrjeve, në përbërjen e të cilëve do të jenë ekspert të fushave përkatëse jashtë ndërmarrjeve të sipërpërmendura, ndërkohë që drejtues të bordeve do të jenë nga stafi i ndërmarrjeve. "Komisioni komunal i aksionarëve ka të drejtë të veprojë në emër të Komunës dhe se duhet të vendos se si t'i ushtrojë të drejtat e aksionarit të komunës në çështje të caktuara", thuhet nenin 5.2 të LNP-së. Komuna ka të drejtë në mbikëqyrjen e funksionimit të NP-ve.

## GTZ financon mbajtjen e trajnimeve në arsim

**23 Prill** - Organizata gjermane GTZ është duke e financuar projektin për trajnimin e mësuesve të ciklit të ulët dhe arsimtarët e lëndëve shkencore: matematikë, kimi, fizikë dhe biologji si dhe trajnimin e drejtorëve të shkollave në fushën e menaxhimit. Në një takim të organizuar nga Drejtoria e Arsimit me drejtorët e shkollave fillore, kanë prezantuar edhe zyrtarë



të organizatës gjermane GTZ. Ky projekt do të implementohet nga MASHT-i në bashkëpunim me DKA-në. Projekti përmban organizimin e trajnimeve për mësimdhënësit e lëndëve shkencore, matematikë, fizikë, kimi dhe biologji, pastaj të mësuesve të klasave të ultë dhe drejtorëve të shkollave në fushën e menaxhimit.
Trajnimet do të fillojnë në muajin maj ndërkaq fillimisht do të trajnohen drejtorët e shkollave në fushën e menaxhimit. Projekti i GTZ parasheh trajnime në katër fusha: Ngritja e kapaciteteve në MASHT, trajnimin e mësuesve, menaxhimin e shkollave dhe arsimin joformal.

## Komuna kursen energji

**28 Prill** - Administrata komunale e Kaçanikut ka marrë hapa të kursimit të energjisë elektrike dhe rrjedhimisht edhe të buxhetit komunal, duke përfituar kështu nga dritat e promovuar kohë më parë si drita që shpenzojnë pak energji. Në objektin e Administratës komunale dhe në atë të Shërbimit të Zjarrfikësve janë instaluar drita ofiqente (ekonomike), ka theksuar z. Rushan Ceka, drejtor i Drejtorisë së Emergjencës dhe Shërbimeve Publike. Zëvendësimi i dritave fluroscent e në ato ofiqente pritet të bëhet së shpejti edhe në ndriçimin publik të qytetit.



# Pastrohet ambienti përreth “Gurit të Shpumë”

**29 Prill** - Komuna ka organizuar një aksion për largimin e deponive të egra të mbeturinave. Në një aksion është bërë pastrimi i mbeturinave në pjesën jugore të qytetit si dhe përgjatë magjistrales në drejtim të Grykës së Kaçanikut. Z. Bujar Dullovi, inspektor i ambientit, ka thënë se ky aksion ka për qëllim krijimin e një ambienti sa më të pastër për



qytetin dhe territorin e gjithë komunës së Kaçanikut dhe njëkohësisht edhe të bëhet vetëdijesimi i qytetarëve për mos hedhjen e mbeturinave.

*MAJ 2010*

# Kaçaniku përjetëson Idriz Seferin

**1 Maj** - Heroi kombëtar dhe Kreshniku i Karadakut, i fillimshekullit të kaluar, Idriz Seferi, është përjetësuar në monument historik, mu në afërsi të Grykës së Kaçanikut, aty ku bëri histori për çlirimin e trojeve etnike shqiptare. Kryeheroi i Betejës së Kaçanikut është bërë banor i përhershëm i "Çarshisë" në rrugën që mban emrin e njërit nga heronjtë e historisë më të re të luftës çlirimtare, Agim Bajramit- komandant Zefit. Në 100-vjetorin e arenës së luftës në Grykë të Kaçanikut, Komuna e Kaçanikut ka zbuluar bustin e tribunit popullor- Idriz Seferit, vepër e skulptorit Ismet Jonuzi, ndërsa është financuar nga "Fondi Idriz Seferi" në Gjilan. Në një ceremoni solemne bustin e kanë zbuluar z. Nejazi Idrizi- nip i Idriz Seferit, z. Kudusi Lame- gjeneral i ushtrisë shqiptare, z. Xhabir Zharku- kryetar i Kaçanikut dhe z. Berat Luzha- deputet i Kuvendit të Kosovës. Në një fjalë rasti kreu i Komunës, z. Xhabir Zharku ka vlerësuar se djem e vajza trima të nxitur nga ideali i të parëve tanë e bënë shtetin e Kosovës. E bën këtë shtet që sigurisht bacë Idrizi do të kishte dashur të jetë Shqipni.

Për nder të këtij shekullori, historianë, shkrimtarë e akademikë nga viset shqiptare kanë koontribuar në ndriçimin historik të kryengritjes shqiptare të vitit 1910. Në një simpozium shkencor të mbajtur në Pallatin e Kulturës "Xheladin Kurtaj",në dy sesione kanë prezantuar kumtesat e tyre: z. Jusuf Bajraktari, z.



Fehmi Rexhepi, z. Berat Luzha, znj. Fatmira Musai, z. Isa Bicaj, z. Frashër Demaj, znj. Ledia Dushku, z. Izber Hoti, z. Shefqet Riza, z. Ibrahim Kadriu, z. Zenun Rexhepi dhe z. Hafet Ceka. Këtë jubile e kanë përshëndetur akademik Beqir Meta, drejtor i Institutit të Historisë në Tiranë, z. Xhabir Zharku, kryetar i Kaçanikut dhe z. Islam Lauka, ambasador i Shqipërisë në Kosovë.

Në mbrëmje është mbajtur një akademi solemne, ku përveç përfaqësuesve të institucioneve lokale, atyre nga viset e ndryshme të banuara me shqiptarë dhe familjarë- pasardhës të Idriz Seferit, ka marrë pjesë edhe një delegacion i Kuvendit të Kosovës, i kryesuar nga kryeparlamentari z. Jakup Krasniqi.

Për nder të këtij përvjetori, në hollin e Pallatit të Kulturës është hapur një ekspozitë fotografish me portretin e heroit Idriz Seferi dhe me motive nga Kaçaniku i viteve të para të shekullit të kaluar. Simpoziumi shkencor është organizuar nga Komuna e Kaçanikut dhe Instituti i Historisë në Prishtinë, ndërsa aktivitetet tjera janë organizuar nën patronazhin e kryetarit z. Xhabir Zharku. Komuna e Kaçanikut ka marrë komplimente për organizim dinjitoz të këtij jubileu. Për nder të këtij evenimenti me karakter mbarëkombëtar është shfaqur edhe filmi dokumentar "Trimi i Karadakut", kushtuar heroit Idriz Seferi.

## Asfaltohet rruga e "Çardakut"



**4 Maj** - Rruga e lagjes "Çardak" në Kaçanik të Vjetër, e cila bashkë me lagjen "Hoda" lidhet me magjistralen Ferizaj-Kaçanik në njërën anë dhe me rrugën "Fushë e Pajtimit - Begracë në anën tjetër, ka nisur të

shtresohet me asfalt. Kjo rrugë ka gjatësi 2.817 metra dhe gjerësi 6 metra, ndërsa do të shtrohet me asfalt në trashësi 8 centimetra. Zëdhënësi Dullovi ka sqaruar se këtë projekt e ka financuar MTPT-ja dhe kap vlerën investuese 290.817 euro.

## Nderohet Dita e dëshmorëve dhe 29 vjetori i demonstratave



**5 Maj –** Për nder të 5 Majit – Ditës së Dëshmorëve, kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku me stafin e tij dhe anëtarë të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së kanë vendosur lule të freskëta pranë busteve dhe memorialit të dëshmorëve të kombit. Me rastin e kësaj dite dhe të përvjetorit të 29-të të demonstratave të 5 majit të vitit 1981, kryetari Zharku me bashkëpunëtorë fillimisht kanë bërë homazhe pranë bustit të heroit kombëtarë Idriz Seferi e më pas pranë bustit të dëshmorit Ismajl Raka dhe të komandantit të Brigadës 162 të UÇK-së, Agim Bajramit.



Po ashtu, nderime janë bërë edhe pranë bustit të dëshmorit dhe komandantit Qamil Ilazi - Bardhi, në oborrin e shkollës në Kaçanik të Vjetër.

## Granti i USAID-it destinohet për ambient

**6 Maj -** Komuna e Kaçanikut grantin e USAID-it në shumë prej 20 mijë dollarësh e ka destinuar për themelimin e Zyrës së vullnetarëve për mbrojtjen e ambientit. Kjo zyrë do të merret me fushata sensibilizuese për mbrojtjen e ambientit, pastaj me aksione vullnetare për pastrimin e mjedisit. Z. Bekim Troni, drejtor i Urbanizimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, ka thënë se për aktivitete konkrete do të angazhohen vullnetarët ambientalistë, grup i cili është formuar në fillim të vitit të kaluar. Komuna e Kaçanikut është njëra ndër 14 komunat e Kosovës, e cila është shpërblyer nga fondi stimulues i USAID-it, për performancë komunale, ndërsa është njëra nga dy komunat e vetme e cila në fushën e ambientit ka përfituar nga ky fond. Për themelimin e ZVMA-së Komuna do të participojë me 13.333 dollarë.

## Zgjidhen anëtarët e BD të "Lypetenit"

**7 Maj** - Komisionin Komunal i Aksionarëve për NKP "Lypeteni" ka zgjedhur Bordin e Drejtorëve të kësaj ndërmarrje. Ky komision për anëtar të BD të kësaj ndërmarrje ka zgjedhur z. Vedat Demën, z. Fadil Çallakun, z. Zija Likën dhe z. Fevzi Doganin. Komisioni Komunal i Aksionarëve të NKP "Lypeteni" përbëhet nga: z. Rushan Ceka, znj. Diana Bajrami (PDK) dhe z. Ramadan Osmani (LDK).

## DSHM-ja konkurron me katër projekte

**7 Maj** - Në kuadër të propozimeve të Programit të punëve publike në Kosovë, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka aplikuar për financim në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale me katër projekte. Drejtori i kësaj drejtorie, z. Misim Sopa ka theksuar se si drejtorat ka konkurruar me projektet: pastrimi i përrenjve në

komunën tonë, rregullimi i trotuareve për këmbësorë, ngjyrosjen e objektit të QKMF-së dhe ndërrimin e dyerve e dritareve të kësaj qendre. Projektet të cilat i plotësojnë kushtet do të financohen nga Fondi i punësimit i MPMS-së për vitin 2010, fond i cili kap shumën e përgjithshme 2.150000 euro, ka saktësuar z. Sopa.

## Përkujtohet komandant Bardhi

**14 Maj** - Me një manifestim përkujtimor të mbajtur në oborrin e shkollës në Kaçanik të Vjetër, është përkujtuar në 11-vjetorin e rënies dëshmori Qamil Ilazi, ish-komadant i Brigadës 162 të UÇK-së "Agim Bajrami". Në emër të këshillit organizativ, z. Ahmet Krasniqi, ish-bashkëluftëtar i komandant Bardhit, ka vlerësuar se ngjarjet e mëdha kanë edhe heronjtë e mëdhenj si Qamil Ilazi- komandant Bardhi. "Gjaku i komandant Bardhit u bë një me gjakun e martirëve që ranë në altarin e lirisë, i cili bën dritë për Kosovën e lirë", është shprehur z. Krasniqi. Në emër të institucioneve lokale kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku është shprehur se: "Jemi të vetëdijshëm se amaneti i dëshmorëve dhe i komandant Bardhit ende nuk është plotësuar, sepse



amaneti, lufta dhe betimi i tyre dhe i yni ishte për një Shqipëri”. Tubimin e kanë përshëndetur edhe deputeti i Parlamentit të Kosovës, z. Berat Luzha, pastaj z. Jashar Selimi, në emër të OVL-së, z. Ekrem Jashari- veprimtar, ndërsa në emër të familjes së dëshmorëve i ka falënderuar pjesëmarrësit z. Besim Ilazi, djali i komandant Bardhit. Me këtë rast pran lapidarit të komandantit të përkujtuar dje janë vendosur kurora me lule, ndërsa është shfaqur edhe një program kulturor artistik.

## Formohet Grupi joformal i grave

**17 Maj** - Me qëllim të avancimit të pozitës së tyre në shoqëri dhe bërjes pjesë e proceseve vendimmarrëse, gratë e komunës së Kaçanikut kanë formuar Grupin joformal të grave. Në një takim të organizuar nga OSBE-ja, në bashkëpunim me Zyrën Komunale për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, kryesuese e këtij grupi është zgjedhur znj. Elife Murseli, këshilltare në KK, ndërsa zëvendëse e saj është zgjedhur znj. Bahrije Çaka.



# 3Mbahet Testi Provues i arritshmërisë për nxënësit e klasave të nënta

**19 Maj** - Organizuar nga Drejtoria për Arsim e Kulturë dhe në bashkëpunim me drejtoritë e shkollave fillore, mbahet testi provues i arritshmërisë për nxënësit e klasave të nënta të komunës tonë.

Testi Provues i arritshmërisë mbahet me qëllim të verifikimit të njohurive të fituara dhe njëkohësisht nxënësve do t'u shërbejë nxënësve si një përvojë e mirë në prag të mbajtjes së testit të arritshmërisë, i cili për nxënësit e klasave të nënta mbahet më 29 qershor të këtij viti. Këtë vit shkollor (2009/2010), në 31 paralele të klasave të nënta të 12 shkollave fillore të komunës tonë, janë regjistruar gjithsej 660 nxënës.



## Nisin ndërtimi i QMF-së në Bob

**20 Maj** - Kanë nisur punimet për ndërtimin e objektit të Qendrës së Mjekësisë Familjare në fshatin Bob. Për ndërtimin e këtij objekti, Ministria e Shëndetësisë ka ndarë 48.300 euro. Punimet është duke i kryer kompania "Termomontimi" nga Prishtina. Realizimi i këtij projekti është në funksion të shkarkimit nga numri i madh i pacientëve të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Kaçanik.



# Kryetari Zharku kthehet nga Turqia

21 **Maj -** Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, është kthyer nga Turqia, ku me ftesë të kryetarit të Këshillit Organizues të vilajetit të Adapazarit, ishte pjesëmarrës në shënimin e Ditës së Çlirimit të Turqisë.

Gjatë kësaj vizite kryetari Zharku ka takuar kryetarë të komunave nga vilajeti i Adapazarit, me ç'rast janë pajtuar për vazhdimin e bashkëpunimit.



Kryetari Zharku, po ashtu ka realizuar edhe disa takime me afaristë turq e shqiptarë për mundësinë e investimeve të kapitalit të tyre në komunën tonë.

Për vizitë në Turqi po qëndron edhe SHKA "Shqiponja" nga Kaçaniku, e cila përfaqëson Kosovën në Festivalin Ndërkombëtarë të folklorit, aktivitet i cili mbahet për nderë të Ditës së Çlirimit të Turqisë.



## CHF shqyrton mundësinë e ndërtimit të një aneksi shkolle

**27 Maj** - Drejtori i Arsimit, z. Azem Guri ka takuar znj. Vlora Rizvanolli-Ahmeti, zyrtare e CHF-së për komunikim me komuna. Qëllimi i takimit ishte prezantimi i nevojave dhe prioriteteve të komunës për zgjerimin e hapësirave shkollore, për t'u përfshirë në hapësirë të mjaftueshme shkollore nxënësit në dy turne.
Drejtori Guri është shprehur me këtë rast se është nevojë imediate mundësimi i zhvillimit të procesit mësimor në dy turne, prandaj përkrahim fuqishëm iniciativën e organizatës CHF për investime në anekse dhe renovime të objekteve shkollore.
CHF është organizatë implementuese e projekteve për ndërtimin e anekseve dhe renovimin e objekteve shkollore të cilat i financon fondi i USAID-it në bashkëpunim me komunat. Znj. Vlora Rizvanolli-Ahmeti ka premtuar se si organizatë do ta shqyrtojë mundësinë për bashkëfinancim të një aneksi shkollor në komunën tonë.

## Diskutohet Rregullorja e ambientit

**28 Maj** - Rregullorja për mbrojtjen e mjedisit në komunën e Kaçanikut ka dalë në diskutim publik para më se dy javësh, ndërsa për këtë çështje është diskutuar edhe në një debat të organizuar nga Komuna. Përfaqësues të komunës tonë kanë dhënë sqarimet rreth përmbajtjes së kësaj rregulloreje, ndërsa ambientalistë të rinj dhe qytetarë kanë kërkuar zbatimin e saj. Rregullorja është hartuar për ta mbrojtur ambientin jetësor, sigurimin e kushteve higjienike në qytet dhe në vendet rurale të banuara si dhe përcaktimin e kushteve dhe obligimet që kanë qytetarët, organet e pushtetit lokal, institucionet publike, organizatat joqeveritare dhe ndërmarrjet për mirëmbajtjen e pastërtisë. Hedhja e mbeturinave në vende joadekuate, ndotja akustike, ndotja e lumit Lepenc dhe Neredime nga ujërat e zeza dhe

mbeturina të ngurta, mbeturinat në qytet, mungesa e shportave përveç në bulevardin “Ismail Raka”, mungesa e hapësirave të gjelbëruara afër ndërtesave të banimit kolektiv, ishin disa nga shqetësimet e prezantuara në këtë diskutim publik. Hartimi i kësaj rregulloreje është vlerësuar si një hap shumë pozitiv për përmirësimin e mjedisit në të cilin jetojmë, por si çelës i suksesit për zbatimin e saj në praktikë është vlerësuar të jetë gatishmëria dhe këmbëngulësia e autoriteteve kompetente komunale.

*QERSHOR 2010*

# Kryetari u bën pritje fëmijëve në ditën e tyre

**1 Qershor** – Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 1 Qershorit –Ditës Ndërkombëtare për Fëmijë, ka pritur në zyrën e tij një grup fëmijësh, nxënës nga disa shkolla të komunës. Kryetari Zharku i përshëndeti dhe i përgëzoi fëmijët për ditën e tyre, ndërsa i ka njoftuar ata me funksionimin e Komunës, organeve e saj si dhe për punët, aktivitetet dhe shërbimet ditore që kryhen në shërbim të qytetarëve. Fëmijët janë shoqëruar nga z. Fatmir Çaka, koordinator për Rini dhe të Drejta të Fëmijëve si dhe përfaqësues të Asamblesë Rinore.

Fëmijët kanë kërkuar nga kryetari, përmirësimin e kushteve në shkolla, krijimin e hapësirave shkollore, kabineteve e laboratorëve, etj. Kryetari Zharku, me këtë rast u dhuroi dhurata modeste fëmijëve për nderë të Ditës së tyre.



## 43 mijë euro për pastrimin e përroskave

**2 Qershor** - Komuna e Kaçanikut ka përfituar një donacion prej 43 mijë eurosh nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, para të cilat ka vendosur t'i shpenzojë për pastrimin e përroskave në komunën tonë. Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, z. Misim Sopa, ka thënë se këtë projekt e kemi fituar pasi kemi konkurruar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ndërsa për realizimin e pastrimit të përroskave në qytet dhe fshatra gjatë këtij viti do të punësohen 30 persona me kohëzgjatje sezonale së paku nga tre muaj. Ai ka thënë se njëri nga kushtet e marrëveshjes është që 50 për qind e të punësuarve në këtë projekt duhet të jenë nga lista e punëkërkuesve në Zyrën Komunale të Punësimit.

## Semimatura- ditën

**2 Qershor** - Semimaturantët e shkollave fillore të komunës së Kaçanikut festën e tyre për përfundimin e shkollës së mesme të ulët do ta mbajnë ditën, e jo natën si deri tani. Drejtoria e Arsimit ka marrë vendim që semimatura për nxënësit e klasave të nënta të mbahet nga ora 15:00 deri në orën 20:00. Vendimi për shënimin e maturës në këtë interval është i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës dhe është bërë për t'iu ikur orëve të vona. Këtij vendimi i kanë paraprirë edhe shqetësime e ankesa të prindërve, të cilët kanë kërkuar që semimatura të mbahet ditën.

# Ambasadori Weber merr pjesë në promovimin e një projekti edukativ



**4 Qershor** - Ambasadori i Luksemburgut, Pierre Weber, ka qëndruar në Kaçanik, ku ka marrë pjesë në hapjen e projektit të Rrjetit të Edukatorëve e Bashkëmoshatarë (PEN). Në prezantimin e tij në gjuhën shqipe, ambasadori Weber u ka thënë të rinjve në këtë promovim se nëpërmjet këtij projekti (të mbështetur nga UNICEF-i) dëshirojmë t'ju ofrojmë lojëra që të jeni të qetë. Ai i ka cilësuar fëmijët si me shumë fat që UNICEF-i dhe Komuna i përkrahin projektet e tyre. Ndërkaq, kryetari i Komunës së Kaçanikut, z. Xhabir Zharku, i cili e ka shoqëruar në aktivitete ambasadorin nga Luksemburgu, u ka premtuar të rinjve përkrahje për projektet me karakter edukativ, si ky i PEN-it. Projekti i hapur në Kaçanik ka për qëllim promovimin e konceptit të edukimit e të rinjve me forma të veçanta për parandalimin e HIV-AIDS-it, aftësive të jetës dhe edukimit shëndetësorë, parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore etj. Qeveria e Luksemburgut është njëra ndër përkrahëset e projekteve të UNICEF-it.

## Kryetari takoi zyrtarë të OSBE-së nga Gjilani



**4 Qershor** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, ka pritur në një takim miqësor z. Biffar Ulrich, drejtor i Zyrës regjionale të OSBE-së në Gjilan.
Drejtori i OSBE-së, z. Ulrich i ka thënë kryetarit Zharku se sot jam këtu për të uruar grantin stimulues të fituar nga USAID-i si dhe për të prezantuar dy bashkëpunëtorët e mi z. Nicholas Stamsreld nga ekipi komunal i OSBE-së në Kaçanik dhe z. Ihar Khadasevich, të cilët do të jenë urë lidhëse ndërmjet Kaçanikut dhe Zyrës regjionale në Gjilan.
Kryetari Zharku ka falënderua për vizitë drejtorin Ulrich, ndërsa ka shprehu mirëseardhje përfaqësuesve të OSBE-së duke i ftuar për bashkëpunim të mirë.

## Kaçaniku bëhet me Plan Zhvillimor Urban

**8 Qershor** - Komuna e Kaçanikut është bërë me plan zhvillimor urban. Ky plan e ka marrë formën përfundimtare në seancën e KK të Kaçanikut. Plani zhvillimor urban e ka marrë aprovimin e të gjitha subjekteve politike të përfaqësuara në legjislativin lokal. Ky dokument ka marrë vlerësim edhe nga Këshilli i ekspertëve kaçanikas. "PDK e mbështet këtë plan dhe uroj që së shpejti ta kemi edhe Planin zhvillimor komunal", ka thënë z. Zekirja Loku, shef i grupit parlamentar




të këtij subjekti politik. Edhe Shukri Luta, kryetar i GP të AAK-së, e ka vlerësuar këtë projekt. “Ky plan është i pranueshëm dhe do të na shërbejë për të ecur tutje”, ka vlerësuar z. Luta, duke thirrur për ta aprovuar atë. Edhe LDK-ja e ka pranuar përmbajtjen e planit urbanistik të Kaçanikut, ndërsa shefi i GP të këtij subjekti politik, z. Daut Rudi, ka kërkuar disa sqarime përmbajtjesore. Një shpjegim për punën njëvjeçare, kohën sa ka zgjatur nxjerrja në dritë e këtij plani, e ka bërë edhe z. Agim Vishi, kryetar i Këshillit të ekspertëve kaçanikas. Ai ka vlerësuar se të gjithë të interesuarit kanë pasur mundësi t’i paraqesin propozimet e tyre për përfshirje në këtë plan. “Ka pasur vërejtje, sugjerime e propozime të cilat janë përfshirë në këtë plan dhe mendoj se përmbajtja përfundimtare e tij është e pranueshme”, ka nënvizuar z. Vishi. Edhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e ka konsideruar planin si të kompletuar. “Çdo gjë që i ka munguar komunës së Kaçanikut është përfshirë në Planin urban të saj”, ka

thënë z. Shpend Agaj nga Instituti për Planifikim Hapësinor të Kosovës. Pas aprovimit, përfaqësues të "Data Gis Consulting" i kanë dorëzuar kryetarit të Komunës, z. Xhabir Zharkut, materiale me përmbajtjen e plotë të Planit urban të Kaçanikut.

## Kryetari uron qytetarët për Ditën e Çlirimit

**10 Qershor** - Të nderuar qytetarë të komunës së Kaçanikut!
11 Qershori – Dita e Çlirimit të Kaçanikut është një ditë e krenarisë sonë të madhe por njëkohësisht edhe e dhimbjes dhe kujtimit për të gjithë ata që u sakrifikuan për liri dhe pavarësinë e vendit. Në këtë ditë të shënuar ne nderojmë sakrificën e të gjithë dëshmorëve dhe luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ideali i lirisë për të cilin ata u sakrifikuan, do të ndriçojë gjithmonë dhe do të jetë udhërrëfim për ndërtimin e jetës së re për të gjithë.
Sot, në 11 vjetorin e Ditës së Çlirimit të komunës sonë, ndjehemi krenar, por edhe të obliguar që idealin e dëshmorëve ta bëjmë realitet.

Me respekt,
Xhabir Zharku
Kryetari i Komunës

## Bëhen homazhe te Varrezat e Dëshmorëve

**11 Qershor** - Në 11 vjetorin e Ditës së Çlirimit të Kaçanikut, aktivitetet kanë filluar me homazhe varrezave të dëshmorëve dhe vendosjen e kurorave me lule pranë memorialit të dëshmorëve. Kurora lulesh kanë vendosur kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku dhe OVL-UÇK-së.



## Fjalimi i kryetarit Zharku me rastin e Ditës së Çlirimit të Kaçanikut

**11 Qershor** - Të dashur qytetarë të komunës së Kaçanikut!
Ju uroj të gjithëve këtë ditë të shumëpritur shekuj me radhë. Sigurisht që ne si gjeneratë jemi



një gjeneratë e bekuar pasi që kemi arritur që të gëzojmë ditët e lirisë, ditët kur është kurorëzua liria e shumëpritur e popullit shqiptarë. 133 vjet më parë, më 10 qershor 1878 burrat e mëdhenj shqiptar të asaj kohe krijuan platformën politike të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, një platformë kombëtare që ju kundërvu, platformës së Naçertanijes e cila dëshironte të zhdukte popullin shqiptar nga trojet e veta. Burrat e asaj kohe u lidhen me besa besë dhe kështu populli shqiptar vazhdoi deri në Luftën e Parë Botërore, apo më mirë të themi deri në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë më 1912, për të vazhduar deri në Luftën e Dytë Botërore e prapë nga ata që na thoshin se aty ku bukës i thonë bukë e ujit ujë, do të jetë Shqipëri, na tradhtuan edhe atëherë. Dhe populli shqiptar që nga atëherë nuk i besoj askujt sepse ishte një tradhti e tmerrshme kur të gjithë popujt liridashës luftuan kundër nazifashizmit, ashtu edhe populli shqiptar, por populli ynë u tradhtua dhe u copëtua në shumë shtete për interesa të shteteve të ndryshme por edhe të shteteve dhe fuqive evropiane të asaj kohe. U deshtë një përpjekje e madhe u deshtë të derdhej gjak dhe sakrificë e madhe në këto troje deri në zhvillimin e një lufte titanike, një lufte të pabarabartë por të vendosur e cila nxori nga gjiri i vet luftëtarët më trima. E ndër ata më trima dhe familja që i dha një shkëndijë të madhe atdheut dhe kombit ishte familja e bacë Ademit e cila me pushkën e vet i tregoi botës por edhe i bëri thirrje edhe kombit shqiptar se ne nuk do të qëndrojmë duarkryq para atyre që na vrasin. Kështu djemtë dhe vajzat e Kosovës dhe intelektualët e gjithë kombit shqiptarë dhe të Shqipërisë gjithë të bashkuar, të gjithë duke e ndihmuar njëri tjetrin rrokën armët. Me armë dhe pushkë arritëm deri më 11 qershor 1999, së bashku me aleatin tonë angloamerikan. Ne në këtë Ditë çlirimi i falënderojmë edhe aleatët tanë që na ndihmuan për të arritur këtë ditë të shumëpritur.

# Seminar me tri tema të referimit

**11 Qershor** - Karriera e referimit, parandalimi i dhunës në futboll dhe personaliteti e lidershipi i gjyqtarit, ishin tri tema të cilat janë trajtuar në seminarin e gjyqtarëve të futbollit. Për këto tema, të cilat kanë pasur rastin t'i dëgjojnë rreth 50 referë kosovarë, pjesëmarrës në këtë trajnim, kanë ligjëruar gjermanët z. Oliver Pogrzeba dhe z. Knut Hagenow dhe danezi z. Miches Vachoviak, përkatësisht norvegjezi z. Jan Olaf Knuten. Të gjitha këto tema ishin në funksion të rregullave të futbollit dhe avancimin e profesionit të referimit, përfshirë këtu edhe mënyrën e performansës së referëve dhe sjelljet e tyre.



# Kupat e Çlirimit të Kaçanikut shkuan në Ferizaj




**11 Qershor** - Dy kupat e turneut të futbollit të madh, i cili është mbajtur për nder të Ditës së Çlirimit të Kaçanikut, kanë përfunduar në duart e skuadrave ferizajase. Ekipi "Vizioni S" e ka marrë "Kupën e Çlirimit të Kaçanikut" në konkurrencën e femrave, ndërsa skuadra e kategorisë së pionierëve- Ferizaj e ka ngritur kupën si fitues në stadiumin "Besnik Begunca", në konkurrencën e meshkujve. Drejtoria e Kulturës e Kaçanikut ka shpërblyer më të mirët e këtij turneu. Kupat e më të mirëve i kanë marrë "Vizioni S" dhe Ferizaj. Në këtë turne kanë marrë pjesë tetë skuadra: "Kaçanikasja" (nikoqire), Llapi nga Podujeva, "Vizioni-S" nga Ferizaj, Malisheva (në konkurrencën e femrave) dhe Lepenci e "Diti Sport" nga Kaçaniku, "Sharri" nga Hani Elezit dhe Ferizaj, në konkurrencën e meshkujve. Ky turne është tradicional dhe kjo ishte hera e tretë që është organizuar nga Komuna e Kaçanikut.



## Çmimet shpërndahen në trojet etnike

**11 Qershor** - Ansambli i Këngëve dhe Valleve "Gjilani" nga komuna me të njëjtin emër, e ka rrëmbyer çmimin e parë të Festivalit kombëtar të shoqërive dhe ansambleve kulturore-artistike "Kaçaniku 2010". Vendin e dytë e ka zënë SHKA "Jahi Hasani" nga Çegrani i Gostivarit, ndërsa çmimin e publikut e ka fituar Grupi Folklorik "Erzeni" nga Shijaku i Shqipërisë. Këto tri SHKA kanë marrë me vete nga një pikturë të madhe me motive nga Kaçaniku, ku piktorët vendës z. Zeqir Xhokli dhe z. Arif Mulaku kishin punuar dy piktura me pamje nga "Guri i Shpumë" në Grykë të Kaçanikut, njëra e kohës së Idriz Seferit dhe tjetra e Ditës së Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, si dhe një tjetër me pamje nga Kalaja e Kaçanikut. Juria profesioniste: z. Sami Piraj, z. Ahmet Dërguti dhe z. Milaim Mezini, kanë vlerësuar edhe performansa të veçanta të anëtarëve dhe grupeve brenda SHKA-ve të cilat janë nderuar me mirënjohje. Ky festival është mbajtur në shenjë të përvjetorit të 11-të të Ditës së Çlirimit të Kaçanikut dhe është organizuar nga Drejtoria e Kulturës dhe ndërsa është ndihmuar nga MKRS-ja. Në këtë festival kanë marrë pjesë edhe SHKA "Jonuz Ramadani" nga Smira e Vitisë, SHKA "Rrezet e Sharrit" nga Biçeci i Kaçanikut, SHKA "Gryka e



Kaçanikut" dhe ajo "Shqiponja" nga Kaçaniku si dhe Shoqata e Rapsodëve të Kosovës nga Prishtina. Ky ishte festivali i 22-të kombëtar, festival ky tradicional i cili ka tubuar SHKA nga të gjitha trojet etnike shqiptare.

## Arsimi - në objektivin e Qeverisë Thaçi

**16 Qershor** - Kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi ka qëndruar në një takim darke me mësimdhënës kaçanikas. Kryeministri ka thënë me këtë rast se shteti ynë do të ketë vetëm ecje përpara, do të ketë njohje të reja dhe anëtarësim në mekanizmat ndërkombëtar, në NATO dhe BE. Numri një i ekzekutivit të vendit, z. Thaçi, ka theksuar se Kosova do të ndërtohet si vend demokratik e tolerantë, për të krijuar një ambient të qetë dhe joshës për investime, ndërsa sektorin e arsimit e ka renditur si një nga prioritetet kryesore të Qeverisë të cilën e udhëheq ai. Kryeministri Thaçi u ka premtuar mësimdhënësve rritje gjatë mandatit të tij qeverisës. Në këtë takim tashmë tradicional ishte prezentë edhe ministri i MASHT-it, Enver Hoxhaj, i cili i ka falënderuar arsimtarët për angazhimin e tyre gjatë vitit shkollor 2009/201



0. Ndërkaq, kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, duke bërë krahasimin me vitin e kaluar, ka shprehur inkurajimin për testin e maturës, i cili në nivel komune ka arritur shkallën e suksesit 48 për qind, ndryshe nga një vit më herët ku mesatarja e përgjithshme e këtij testi ishte 30 për qind.

## Subjektet afariste nuk shprehin interesim për çmimin e taksave

**21 Qershor** - Pronarë të subjekteve afariste nuk kanë shprehur interesim për të dhënë propozimet e tyre për taksat dhe ngarkesat administrative. Në debatin e organizuar nga Komuna, ka prezantuar vetëm një numër i vogël afaristësh dhe atë shumica nga kompanitë transportuese të udhëtarëve. Me ndonjë përjashtim të vogël pjesëmarrësit nuk kanë dhënë ndonjë propozim konkret përkitazi me lartësinë e tarifave të bizneseve. Z. Mefail Lika, pronar i një kombibusi i cili bartë nxënës dhe udhëtarë të tjerë në relacionin Gajre-Kaçanik dhe anasjelltas, nuk e ka parë të arsyeshme që pronarëve të kombibusëve nga 30 euro sa ishte ishte lartësia e taksës vjetore, t'u bëhet nga 75 euro. Ai ka propozuar që lartësia e taksës të mbetet 30 euro. Ndryshe nga Lika, ankesa nuk kanë pasur pronarët e kompanive të transportit të udhëtarëve me autobusë, të cilëve nuk i ishin ndryshuar tartifat. "Nuk kam arsye të ankohem, sepse 100 euro nuk janë shumë për kompaninë time", ka vlerësuar z. Xhelal Selimi, pronar i kompanisë transportuese "Elita Tours" me seli në Kaçanik të Vjetër.

## QKMF-ja bëhet me drejtor të ri

**24 Qershor** - Specialisti i mjekësisë familjare, z. Ekrem Dullovi, është zgjedhur për drejtor të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare "Dëshmoret e Lirisë"në Kaçanik. Për këtë post kanë konkurruar edhe dy kandidatë të tjerë, njëri mjek i praktikës së përgjithshme dhe tjetri stomatolog. Drejtori i sapozgjedhur, z. Ekrem Dullovi do të fillojë punën në këtë post më 1 korrik të këtij viti. Që nga viti 2003 e këtej, drejtor i kësaj QKMF-je ishte z. Nejazi Luma, specialist i mjekësisë familjare.



## Lapidar për Avdyl Dyrën e Ramë Bekën

**28 Qershor** - Gjashtëdhjetë e një vjet pas rënies për çlirim dhe bashkim të trojeve etnike, heronjtë e kombit Avdyl Dura e Ramë Beka vihen në monument të përjetshëm historik. Në një manifestim të mbajtur në fshatin Duraj të Kaçanikut, është vënë gurthemeli i lapidarit të këtyre dy trimave, të cilët ranë heroikisht më 28 qershor të vitit 1949. Në një lokacion afër xhamisë së fshatit Duraj, gurthemelin e

lapidarit të Avdyl Durës dhe Ramë Bekës e kanë vendosur znj. Rufije Sallahu- mbesa e Avdyl Durës, z. Shaban Vogliqi- djali i Ramë Bekës dhe z. Xhabir Zharku, kryetar i Kaçanikut. Në një fjalë përshëndetëse kryetari i Kaçanikut, Xhabir Zharku i ka vlerësuar lartë këto dy figura kombëtare. “Në këtë ditë kemi ardhur në saje të sakrificës sublime edhe të Avdyl Durës e Ramë Bekës. Ata ishin dy nga ushtarët e mëdhenj për çlirimin e Kosovës. Pa luftën e tyre dhe më pas edhe të UÇK-së nuk do të çlirohej Kosova. Jam optimist se ideali për bashkimin kombëtar, për të cilën ranë Avdyl Dura e Ramë Beka, do të realizohet”, është shprehur ndër të tjera kryetari Zharku.. Në një fjalë rasti, Metush Zenuni nga këshilli organizues, ka rikujtuar se eshtrat e Avdyl Durës dhe Ramë Bekës vazhdojnë të prehen në një varr të përbashkët në



varrezat e serbëve në Ferizaj, ndërsa ka bërë ftesë publike që institucionet të bëjnë të mundurën që eshtrat e këtyre dy dëshmorëve të sillen pranë këtij lapidari, gurthemeli i të cilit është inauguruar solemnisht. Z. Zenuni ka bërë të ditur se iniciativa për ngritjen e këtij

monumenti është e familjarëve dhe e banorëve të kësaj ane, ndërsa ka konfirmuar se Komuna e Kaçanikut ka shprehur gatishmërinë për mbështetjen financiare për realizimin e kësaj vepre historike. Në përkujtim të këtyre dy figurave kombëtare, është mbajtur edhe një akademi përkujtimore.

## Miratohet rregullorja për gjuhët zyrtare

**30 Qershor** - KK i Kaçanikut ka aprovuar Rregulloren për përdorimin e gjuhëve në këtë komunë, ndërsa si gjuhë zyrtare janë gjuha shqipe dhe ajo serbe si dhe alfabetet e tyre. Sipas rregullorës e cila e ka marrë vizën e legjislativit, çdo qytetar e ka të drejtën lirshëm të shprehet pranë organeve përfaqësuese dhe ekzekutive në gjuhën dhe alfabetin gjuhës së etnitetit përkatës. Rregullorja e miratuar është në harmoni me Ligjin për vetëqeverisje lokale, Ligjit për përdorimin e gjuhëve zyrtare si dhe me nenin 73 të Statutit të Komunës së Kaçanikut.



# Kaçaniku ia dorëzon materialin kadastral Hanit të Elezit

**30 Qershor** - Materiali kadastral i cili përfshin të dhënat kadastrale të Hanit të Elezit i është dorëzuar kësaj komune. Në një solemnitet rasti, drejtori i Urbanizmit dhe Kadastrës, z. Bekim Troni, nëpërmjet z. Avbdurrahman Kuletës, drejtor i Sistemit të Informimit Gjeografik (AKK) ia ka dorëzuar certifikatën e këtij materiali kadastral nënkryetarit të Hanit të Elezit, z. Muzafer Dërnjanit. Nënkryetari i Hanit të Elezit, z. Muzafer Dërnjani ia ka dhuruar një mirënjohje Komunës së Kaçanikut për shërbimet që i janë bërë që nga koha e themelimit të pilotnjësisë komunale, përkatësisht themelimit të Komunës së Hanit të Elezit e deri tani.



*KORRIK 2010*

# Komuna dhe USAID-i nënshkruajnë marrëveshjen për zyrën e ambientalistëve

**2 korrik** - Kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku, dhe z.Randy Repola, drejtor i programit Iniciativa për Komuna Efektive (IKE) i USAID-it, e kanë nënshkruar marrëveshjen për zbatimin e projektit: "Themelimi i Zyrës së vullnetarëve ambientalistë". Z. Zharku e ka falënderuar z. Repola për donacionin dhe përkrahjen e USAID-it. "Ne kemi konkurruar me këtë projekt, sepse dëshirojmë të nxisim dhe përkrahim iniciativat e të rinjve në fushën e mbrojtjes së mjedisit", ka theksuar kryetari Zharku. Ndërkaq, z. Repola e ka uruar kryetarin Zharku për idenë inovative në fushën e ambientit dhe projektin që do të prodhojë rezultate. Projekti e obligon IKE-në të bëjë përgatitjen e dokumentacionit të prokurimit në bashkëpunim me Komunën e Kaçanikut dhe furnizimin me pajisje të nevojshme të zyrës së



vullnetarëve ambientalistë, ndërsa Komuna do të ofrojë kopje të specifikacioneve për blerjen e pajisjeve të nevojshme për zyrën dhe do të ofrojë orarin për zbatimin e projektit. Komuna e Kaçanikut është shpërblyer me 20 mijë dollarë amerikanë nga fondi stimulues i USAID-it për performansë komunale në fushën e mjedisit, ndërsa në programin IKE pati aplikuar me projektin: "Menaxhimi me risi, hapja e zyrës për vullnetarët e rinj ambientalistë".

## Nis fushata e korrjes së grurit

**7 korrik** – Ka nisur fushata e korrjes së grurit në territorin e Komunës së Kaçanikut. Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Nuhi Provoliu, ka thënë se janë gjithsej 580 hektarë të mbjellur me grurë. Për fushatën e sivjetme të korrjeve janë angazhuar



16 autokombajna, ndërsa çmimi për korrjen e një hektari është 90 euro (i caktuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural). Pronarët e autokombajnave do të subvencionohen nga MBPZHR-ja me blerjen 35% më lirë të derivateve që harxhohen për korrjen e një hektari. Kjo ministri vjet i pati subvencionuar bujqit kaçanikas me nga 90 euro për një hektar të mbjellur me grurë, ndërsa patën përfituar 62 sish me gjithsej 200 hektarë të mbjell. Për përcjelljen e fushatës së korrjes është formuar komisioni komunal në përbërje: Zekirja Koxha, kryetar, Naser Kuka e Mustafë Loku, anëtarë.

## "Caritasi" i Luksemburgut ndihmon shkollat e komunës

**8 korrik** - "Caritasi" i Luksemburgut do të financojë realizmin e nga një projekti në secilën nga shkollat fillore dhe të mesme të Komunës së Kaçanikut. "Është 3 mijë euro vlera e projekteve të planifikuara për realizim", ka theksuar z.Hajrush Dullovi, zëdhënës i Komunës. Ndërkaq, z.Azem Guri, drejtor i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, ka thënë se disa shkolla janë përcaktuar ndërkohë për projektet që planifikojnë t'i realizojnë. "Projektet e përzgjedhura kanë të bëjnë me pasurim bibliotekash me tituj të rinj, furnizim shkollash me mjete mësimore konkretizimi etj", ka theksuar z.Guri. Ai i ka nënvizuar se përzgjedhjen përfundimtare të projekteve që do të realizohen do ta bëjë një komision me përfaqësues të "Caritasit" të Luksemburgut, DAK-ut dhe drejtorive të shkollave.

# Inspektorët në terren edhe pas përfundimit të orarit të punës



**9 korrik** - Autoritetet komunale kanë nisur së zbatuari edhe dispozitat ndëshkimore të Rregullores komunale për mbrojtjen e mjedisit, e miratuar para pak ditësh nga legjislativi komunal. Më 3 korrik, në orën 19:15, qytetari M.V. është kapur në flagrancë nga inspektori komunal mjedisor, z.Bujar Dullovi, derisa po shkarkonte traktorin e tij me mbeturina në bregun e lumit Lepenc. Atij i është konfiskuar traktori, ndërsa e ka marrë atë vetëm pasi e ka paguar gjobën e shqiptuar mandatore prej 100 eurosh. "Dy inspektorë janë urdhëruar që të jenë në detyrë gjatë 24 orëve për kapjen në flagrancë dhe gjobitjen e personave që hedhin mbeturina në hapësirat publike", ka theksuar z.Bekim Troni, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Ai ka pohuar paraprakisht është zhvilluar një fushatë njoftuese e qytetarëve lidhur me Rregulloren e re komunale të mjedisit, ndërsa publikut i është përcjell disponimi i Komunës për t'i zbatuar edhe dispozitat ndëshkimore të saj.

# Ministri Stavileci ia dorëzon Komunës kompetencat për pyjet

**12 korrik** - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ia ka dorëzuar Komunës së Kaçanikut kompetencat për mbrojtjen dhe menaxhimin e sipërfaqeve pyjore publike në territorin e komunës. Protokolli i dorëzim pranimit të kompetencave është firmosur nga kreu i MBPZHR-së, z.Blerand Stavileci dhe kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku, në zyrën e kryetarit. Ministri Stavileci ka vlerësuar se delegimi i kompetencave nga pushteti qendror në atë lokal do t'i kontribuojë zhvillimit të sektorit të pylltarisë i cili ka trashëguar shumë probleme nga e kaluara. Ndërkaq, z.Zharku, ka artikuluar disponimin e Komunës për t'i pranuar kompetencat sa i përket mbrojtjes dhe menaxhimit të pyjeve. "Këto kompetenca të bartura na i shtojnë përgjegjësitë, mirëpo besoj se punët në këtë rrafsh do të shkojnë mbarë e mirë tashti e tutje", ka thënë kryetari Zharku. MBPZHR-ja ia ka transferuar



Komunës së Kaçanikut edhe buxhetin për 6-mujorin e dytë të këtij viti për sektorin e pylltarisë në shumë prej 15.204 eurosh, i destinuar për pagat e stafit prej 8 vetash dhe për mallra e shërbime. Komuna e Kaçanikut i ka rreth 13.830 hektarë me pyje që mbulojnë 62 për qind të territorit të saj.

## Ofiqarëve në terren u dorëzohen vulat dhe autorizimet për firmosje dokumentesh

**12 korrik** - Pesë zyra të vendit në terren janë mëvetësuar nga Shërbimi i ofiqarisë në Kaçanik sa i përket lëshuarjes së dokumenteve të gjendjes civile. Kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku, ua ka dorëzuar vulat dhe autorizimin për nënshkrim dokumentesh ofiqarëve të zyrave të vendit. "Kërkoj nga ju që të jeni shumë të kujdesshëm gjatë lëshuarjes së dokumenteve, sepse vetëm në këtë mënyrë krijohet besueshmëria", u ka thënë kryetari ofiqarëve. Ai i ka përgëzuar ata për punën e suksesshme që po e bëjnë, por u ka sugjeruar që të mos bien në vetëkënaqësi. Bartja e kompetencave për nënshkrim dhe vulosje dokumentesh t e ofiqarët e zyrave të vendit është bërë pas pëlqimit të dhënë nga Ministria e Punëve të Brendshme. Autorizimi i



ofiqarëve në terren për firmosje dhe vulosje dokumentesh është akt në funksion të lehtësimit të punës së tyre dhe lëshimit pa vonesa të dokumenteve të kërkuara nga palët. Zyrat e vendit ekzistojnë në fshatrat: Glloboçicë, Doganaj, Kaçanik i Vjetër, Dubravë dhe Ivajë.

## Kryetari kërkon angazhim maksimal për mbrojtjen e pyjeve

**14 korrik** - Kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku, bashkë me drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z.Nuhi Provoliu, janë takuar me të punësuarit e sektorit të pylltarisë, ndërsa nga ata është kërkuar angazhim maksimal për mbrojtjen e pyjeve. “Ne na janë shtuar obligimet dhe përgjegjësitë tashti që kompetencat për menaxhimin e pyjeve i janë bartur nivelit komunal, prandaj nga ju kërkoj angazhim maksimal për përmirësimin e gjendjes sa i përket



mbrojtjes së pyjeve nga prerësit pa leje", u ka thënë të pranishmëve kryetari Zharku. Ai ka nënvizuar se do të hartohet një plan veprimi në këtë rrafsh, sikundër edhe një strategji për prerjen e masës drusore. "Nga sot do të ndryshojnë gjërat. Nuk do të tolerohet asnjë lloj shkelje sa i përket obligimeve dhe përgjegjësive në punë", ka nënvizuar kryetari Zharku. Ndërkaq, Muhamet Qallaku, teknik, dhe Ferat Dullovi, rojtar pylli, kanë thënë të jenë të pakënaqur me caktimin e numrit të të punësuarve në këtë sektor në komunën tonë. Sipas tyre, komunat fqinje kanë numër shumë më të madh të të punësuarve, edhe pse Kaçaniku ka sipërfaqe më të madhe me pyje. Kryetari Zharku u ka thënë atyre se do të veprohet në drejtim të rritjes së stafit të sektorit të pylltarisë, sikundër edhe në atë të krijimit të kushteve optimale për punë.

## CHF International investon në shkollat e komunës



**15 korrik** – CHF International do të investojë në shkollat e Komunës së Kaçanikut. Nënkryetari i Komunës, z.Heset Loku, e ka firmosur memorandumin e mirëkuptimit ndërmjet Komunës së Kaçanikut dhe organizatës CHF International, të cilën e përfaqësonte znj. Vlora

Rizvanolli-Ahmeti, zyrtare për komunikim me komuna. Kjo organizatë do të investojë në arsim mjete të programit: ”Infrastruktura e vogël për arsimin në Kosovë”, i financuar nga USAID-i. Memoranumi i nënshkruar parasheh zbatim të projekteve për zgjerim dhe përmirësim të hapësirave të shkollave ekzistuese nëpërmjet ndërtimit të anekseve, pastaj përfundimin e hapësirave të papërfunduara dhe renovime të përgjithshme të infrastrukturës shkollore. Zbatimi i projekteve të parapara në memorandum do të bëhet më 2011.

## Mbyllet për qarkullim automjetesh rruga kryesore e qytetit

**16 korrik** - Autoritetet komunale kanë marrë vendim për ta mbyllur për qarkullim automjetesh rrugën kryesore të qytetit gjatë orëve të para të mbrëmjeve. "Vendimi për ta mbyllur për qarkullim automjetesh rrugën 'Ismail Raka' është marrë sot, ndërsa në fuqi do të jetë në periudhën 20 korrik-31 gusht", ka theksuar z.Rushan Ceka, drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencës. Ai ka sqaruar se asfalti i rrugës së sipërpërmendur do të shndërrohet në shëtitore nga ora 19:00 - 22:00. "Ky vendimi i Komunës do të zbatohet nga policia", ka nënvizuar z.Ceka. Është thënë se vendimi për shndërrimin në shëtitore të rrugës kryesore në Kaçanik është marrë për shkak se në korrik e gusht ndodh shtim enorm i numrit të qytetarëve që dalin për t'u shëtitur në mbrëmje. "Është edhe një nder për mërgimtarët që vijnë për pushime në vendlindje", ka theksuar z.Ceka. Ai ka thënë se gjatë orëve kur do të jetë e mbyllur rruga "I.Raka" shoferët e automjeteve do të orientohen për shfrytëzim të rrugës "Emin Duraku". Mbyllja për qarkullim automjetesh e rrugës kryesore në Kaçanik gjatë verës është bërë edhe në vitet pararendëse.

## Shpenzohet 37 për qind e buxhetit në gjysmë vjetorin e parë të vitit

**19 korrik** – Komuna e Kaçanikut e ka shpenzuar 37 për qind të buxhetit të sivjetmë gjatë periudhës 1 janar - 30 qershor. "Gjatë kësaj periudhe janë shpenzuar 1.666.035 euro ose 37 për qind e buxhetit aktual (4.507.581 euro)", ka thënë z.Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit. Duke folur për shpenzimet sipas sektorëve buxhetorë, drejtori Vërbani ka theksuar se arsimi vazhdon ta ruajë primatin në këtë rrafsh. "Sektori i arsimit i ka shpenzuar 1.026.276 euro ose 61,6 për qind të totalit të mjeteve të realizuara", ka saktësuar ai. Administrata komunale i ka shpenzuar 384.044 euro (23,1%), ndërsa shëndetësia 255.717 euro (15,3%). Ndërsa, sa i përket kategorive ekonomike, z.Vërbani ka thënë se për paga dhe mëditje janë shpenzuar 1.332.915 euro, për mallra dhe shërbime 154.538, për investime kapitale 78.909, për subvencione dhe transfere 54.133 dhe për shërbime komunale 45.537 euro.

## Ministria e Bujqësisë subvencionon 82 blegtorë kaçanikas

**20 korrik** - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural i ka subvencionuar 82 blegtorë kaçanikas me nga 150 euro. "Përfitues janë fermerët pronarë të nga 5 lopëve qumështore", ka thënë z.Nuhi Provoliu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Ai ka sqaruar se blegtorët përfitues janë subvencionuar me nga 30 euro për kokë lope.

# "Mirë se vini mërgimtarë!" me NRG Bend

**23 korrik** – I organizuar nga Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës dhe nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës, z. Xhabir Zharku, me moton "Mirë se vini mërgimtarë!", në ambientin e hapur para pallatit të kulturës "Xheladin Kurtaj" u mbajt koncert në të cilin performoi grupi i njohur kosovar NRG Bend dhe grupe e ansamble nga Kaçaniku. Në emër të kryetarit, z.Zharku, të pranishmëve me një fjalë rasti iu drejtua z.Azem Guri, drejtor i DAK-ut . "Përmes këtij koncerti jemi munduar që të shprehim mirëseardhjen tone për ju, mërgimtarë të nderuar", u ka thënë të pranishmëve z. Guri. Ai ka folur edhe për angazhimin e Komunës për shërbime të shpejta administrative për lëshim dokumentesh të kërkuara nga palët kurbetçinj. "Edhe pse shumicën e kohës e kaloni larg nesh, ne çmojmë punën tuaj dhe asnjëherë nuk do ta harrojmë kontributin tuaj sidomos gjatë luftës së UÇK-së dhe tashti në Kosovën e lire", u ka thënë z.Guri mërgimtarëve që kishin ardhur për ta përcjell koncertin.



## Mërgimtarët i marrin brenda ditës dokumentet e kërkuara

**24 korrik** - Palët mërgimtarë janë duke i marrë brenda ditës dokumentet për të cilat aplikojnë në Shërbimin e ofiqarisë në Kaçanik. Personeli i këtij shërbimi dhe ai i zyrës pritëse janë duke punuar edhe të shtunave për t'ua mundësuar kurbetçinjve marrjen pa vonesa të dokumenteve të kërkuara. “Sot i kemi pranuar 22 aplikacione për dokumente të ndryshme të gjendjes civile, ndërsa të gjitha janë finalizuar deri në këto çaste", ka theksuar z. Hetem Krasniqi, nëpunës në zyrën pritëse, i kontaktuar në mesditë. Ndërkaq, z.Jeton Topalli, drejtor i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, ka rikujtuar se nga 15 qershori personeli i SHO-së dhe ai i zyrës pritëse janë duke punuar me orar të zgjatur gjatë ditëve të punës (8:00 - 18:00), ndërsa të shtunave nga ora 9:00 - 13:00.

## Legjislativi miratoi një rregullore, një raport dhe një vendim

**27 korrik** - Në mbledhjen VII të legjislativit komunal, të cilën e ka udhëhequr z. Xhelal Gashi, kryesues i KK-së, është miratuar Rregullorja e tarifave dhe ngarkesave administrative dhe shërbimeve të tjera komunale. Z.Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, ka thënë se draftrregullorja i ka kaluar të gjitha procedurat, duke përfshirë edhe organizimin e debatit publik me qytetarë dhe miratimin në parim nga KK-ja, më 8 qershor. Sipas tij, në disa segmente ka ngritje tarifash nga 30 – 70 %, ndërsa të hyrat që do të realizohen nga këto tarifa të ngritura do të destinohen për mbështetjen e investimeve kapitale. Rregullorja do të nisë së zbatuari më 1 shtator 2010. Këshilltarët e pranishëm në séancë e kanë miratuar edhe raportin e realizimit të mjeteve buxhetore për periudhën 1 janar – 30 qershor 2010. Drejtori Vërbani ka thënë se buxheti fillestar i

aprovuar për vitin 2010 ka qenë në shumë prej 4.334.771 eurosh, ndërsa ai aktual është në shumë prej 4.507.581 eurosh apo për 172.870 euro (4%) me i lartë se fillestari. Rritja e buxhetit është bërë nga bartja e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2009 (118.839 euro nga të hyrat vetjake, 14.502 euro nga participimet e komuniteteve dhe 8.009 euro nga donacionet e pashpenzuara). Për shkak të ngritjes së pagave të punëtorëve shëndetësorë, buxheti është rritur edhe për 44.905 euro. Ndërkohë është bërë një shkurtim i buxhetit në shumë prej 13.386 eurosh për financimin e përkohshëm të RTK-së. Sipas raportit, shpenzimet janë realizuar në shumë prej 1.666.035 eurosh ose 37% e buxhetit aktual. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, shpenzimet sivjet janë rritur për 4,1% apo për 65.273 euro. Në gjashtëmujorin e parë të këtij viti janë realizuar 245.470 euro nga të hyrat vetjake kundrejt 549.341 eurove të planifikuara për vitin 2010. Në këtë rrafsh, gjatë periudhës së sipërpërmendur plani vjetor është përmbushur në shkallën prej 44,7%, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar realizimi i sivjetmë është për 4% apo për 9.424 euro më i lartë. Është miratuar edhe propozimvendimi për lirimin nga pagesa e taksave për marrjen e lejes së ndërtimit për objektin e xhamisë në fshatin Kovaçec.



# Nënkryetari takon pilotin shqiptaroamerikan që lobon për njohjen e pavarësisë

**29 korrik** - Nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku, është takuar me pilotin e njohur shqiptaroamerikan, z. James Berisha, i cili po udhëton nëpër botë me aeroplanin e tij me mision lobimi për njohjen e pavarësisë së Kosovës. Z. Loku e ka përgëzuar z.Berisha për angazhimin e tij patriotik rreth çështjes së njohjes së shtetit të Kosovës, ndërsa i ka premtuar mbështetje financiare. Ndërkaq, piloti Berisha ka thënë se në kuadër të misionit të tij do të vizitojë edhe shtetet afrikane. Deri tashti ai i ka vizituar 34 shtete të botës. Duke folur për angazhimin e tij, z.Berisha ka thënë se populli po e vlerëson këtë mision, prandaj edhe iu kam drejtuar me kërkesë për mbështetje financiare. Ai i ka bërë thirrje edhe komunitetit të biznesit që ta mbështes me mjete financiare misionin Flying for Kosova.



*GUSHT 2010*

# Objekti i QMF-së në Bob para përfundimit

**5 gusht** - Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, z.Misim Sopa, i ka inspektuar punimet për ndërtimin e objektit të Qendrës së Mjekësisë Familjare në fshatin Bob, ndërsa është shprehur të jetë i kënaqur me dinamikën e deritanishme të punimeve. Ndërkaq, z.Fatos Koxha, mbikëqyrës i projektit, ka thënë se punimet janë në fazën përfundimtare. "Është bërë suvatimi i objektit, pastaj janë kryer punët e dyshemesë dhe disa të tjera", ka thënë Koxha. Për ndërtimin e QMF-së në Bob, Ministria e Shëndetësis ë i ka alokuar 48.300 euro.



# Nisin punët për pastrimin e Neredimes dhe përrenjve

**5 gusht** - Kanë nisur punët për realizimin e projektit të përbashkët të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Komunës së Kaçanikut dhe Zyrës Komunale të Punësimit në Kaçanik për pastrimin e shtretërve të përrenjve. Tridhjetë punëtorë, të kontraktuar për 3 muaj, kanë nisur punët për pastrimin e shtratit të lumit Neredime. Nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku, ka kërkuar nga punëtorët e

kontraktuar angazhim me përkushtim për realizimin e këtij projekti. Më 1 qershor, Komuna e Kaçanikut e pati nënshkruar



marrëveshjen e mirëkuptimit me MPMS-në për realizimin e projektit: ”Pastrimi i përrenjve”. Për zbatimin e tij, kjo ministri i ka alokuar 43.092 euro nga programi i punëve publike për gjenerim punësimi dhe zvogëlim të varfërisë. Projekti duhet të përfundoj para 31 dhjetorit, ndërsa 50 për qind e punëtorëve të kontraktuar janë punëkërkues me gjendje të rëndë sociale të evidencuar në regjistrat e ZKP-së. MPMS-ja edhe vjet e pati financuar projektin për pastrimin e përrenjve në lagjet “Ramadan Agushi” dhe “Rakoci”.

## HIK-u dhe Komuna u dhurojnë nga 1 lopë race 22 fermerëve

**7 gusht** - Organizata Heifer International Kosova dhe Komuna e Kaçanikut u kanë dhuruar nga 1 lopë race 22 fermerëve të fshatrave Dubravë dhe Doganaj. Edon Baftiu, biri i dëshmorit Avdulla Baftiu, ishte i pari që e pranoi lopën e dhuruar të racës “Simental”. Për blerjen e lopëve të dhuruara, Heifer International Kosova i ka dhënë 40 mijë euro, ndërsa Komuna e Kaçanikut 15 mijë e 500 euro. Dorëzimi i lopëve fermerëve të përzgjedhur u bë në oborrin e shkollës fillore të



lagjes "Provoliu" të Soponicës. Z.Nuhi Provoliu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka theksuar se ky projekt do të monitorohet 4 vjet nga drejtoria që ai e udhëheq, ndërsa në të ardhmen përfitues do të jenë edhe fermerë tjerë. Ndërkaq, kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, e ka falënderuar HIK-n për donacionin, ndërsa drejtorin Provoliu për angazhimin e tij në këtë projekt. "Ne e kemi mbështetur me 15.500 euro këtë projekt, edhe pse nuk ishte paraparë në buxhetin e sivjetmë", ka theksuar z.Zharku. Ai ka nënivzuar se buxheti i Drejtorisë së Bujqësisë mot do të jetë 100 mijë euro. Kryetari Zharku ka shtuar se do të kërkohet edhe nga Qeveria e Kosovës që ta mbështes me grante zhvillimin e bujqësisë në komunën tonë. Folësi i radhës, z.Arsim Ademi, përfaqësues i Heifer International Kosova, ka thënë se pa mbështetjen e Komunës nuk do të mund të realizohej ky projekt. Ai ka rikujtuar se mëshqerrat e para të lopëve të dhuruara do t'u shpërndahen fermerëve tjerë.

# Kurora lulesh dëshmorëve në ditën e tyre

**10 gusht** - Në 12-vjetorin e rënies së komandantit Agim Bajrami dhe dy bashkëluftëtarëve të tij, Besnik Begunca e Xheladin Kurtaj, e në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 10 Gushtit – Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Kaçanikut, kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, ka vendosur kurora lulesh te përmendorja në fshatin Gabrricë. Kurora lulesh te përmendorja e komandantit Agim Bajrami dhe dy bashkëluftëtarëve të tij kanë vendosur edhe përfaqësuesit e OVL-së të UÇK–së, sikundër edhe shumë bashkëluftëtarë të të rënëve e qytetarë. Më pas kryetari i Komunës ka vendosur kurora lulesh edhe te Varrezat e Dëshmorëve dhe te shtatorja e komandantit Agim Bajrami në parkun e qytetit.



# Përurohet rruga e asfaltuar në Elezaj

**10 gusht** – Është përuruar rruga e asfaltuar në fshatin Elezaj, ndërsa për realizimin e këtij projekti Komuna i ka investuar 100 mijë euro. Shiritin përurues e kanë prerë kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, dhe nëna e dëshmorit Nazmi Osmani, zonja Bedrije. "Është kënaqësi e veçantë, besoj jo vetëm për mua, që sot, në Ditën e Dëshmorëve të komunës sonë, po e përurojmë këtë rrugë. Dëshmorët luftuan që Kosovës t'i sjellin lirinë, ndërsa liria ne po na sjell gjëra të mira, siç është edhe kjo rrugë", ka theksuar kryetari Zharku. Ai u ka thënë të pranishmëve në ceremoninë përuruese se ne jemi brezi më me fat, sepse e kurorëzuam lirinë dhe pavarësinë e vendit. Ndërkaq, administratori i fshatit Elezaj, z.Ramadush Osmani, e ka falënderuar pushtetin lokal për financim e këtij projekti shumë të rëndësishëm për 500 banorët e fshatit. Rruga e përuruar i ka dy krahë. Krahu kryesor është i gjatë 1.316 metra dhe i gjerë 5 metra, ndërsa i dyti është i gjatë 456 metra dhe i gjerë 3 metra. Në këtë fazë të realizimit të projektit është hapur tërë traseja e rrugës dhe janë asfaltuar 750 m të krahut kryesor dhe 174 m të krahut të dytë në drejtim të lagjes Osmani. Trashësia e asfaltit të shtrirë është 8 cm. Realizimi në tërësi i projektit është përllogaritur të kushtojë 150 mije euro, ndërsa në këtë fazë janë investuar 100 mijë euro të buxhetit komunal.



# Ministri Limaj e kryetari Zharku përurojnë rrugën në "Çardak"

**10 gusht** - Kreu i Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit, z. Fatmir Limaj, dhe kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, e kanë prerë shiritin përurues të rrugës së asfaltuar në lagjen "Çardak" të fshatit Kaçanik i Vjetër. Kryetari Zharku e ka falënderuar Qeverinë Thaçi për mbështetjen e projekteve në Komunën e Kaçanikut. "Projektet tona do të mbështeten edhe në të ardhmen nga Qeveria e Kosovës, ndërsa nuk do të mungojë as kontributi i Komunës për realizimin e atyre që janë me interes për qytetarët tanë", ka theksuar z.Zharku. Ndërkaq, ministri Limaj ka thënë se sot është



një moment i veçantë për arsye se po e bëjmë përurimin e një rruge të re në Ditën e Dëshmorëve të Komunës së Kaçanikut, në ditën kur një njeri i madh, jo vetëm i Kaçanikut, por edhe i Kosovës, komandant Agim Bajrami, e dha jetën për lirinë e Kosovës. "Agimi ishte njëri nga bashkëluftëtarët tanë, kushtrimi i të cilit e ngriti në këmbë jo vetëm Kaçanikun, por tëre zonën", ka theksuar në vazhdim z.Limaj. Ai ka nënvizuar se si popull dhe si Qeveri e Kosovës po vazhdojmë të bëjmë

atë që ka qenë ëndërr e atyre që u flijuan për lirinë e vendit. “Ëndërr e tyre ka qenë liria e Kosovës, por edhe ndërtimi i atdheut”, ka shtuar ministri Limaj. Rruga e asfaltuar në lagjen “Çardak” është e gjatë 2.817 metra dhe e gjerë 6 metra (5 m asfalti dhe nga 1 m bankinat në të dyja anët e rrugës). Për realizimin e këtij projekti MTPT-ja i ka investuar 260.817 euro, kurse Komuna e Kaçanikut 30 mijë euro.

## Limaj u bëri homazhe kaçanikasve të rënë për liri

**10 gusht** - Në Ditën e Dëshmorëve të Komunës së Kaçanikut, ministri i Transportit dhe Postë-telekomunikacionit, z. Fatmir Limaj, u ka bërë homazhe të rënëve për liri në Varrezat e Dëshmorëve, ndërsa shoqërohej nga bashkëpunëtorë të tij dhe nga kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku.



# E përjetshme do të jetë mirënjohja për dëshmorët

**10 gusht** – "Jam krenar që i takoj gjeneratës e cila përgjatë historisë do të quhet gjenerata e UÇK-së, gjeneratës që i takojnë edhe ata që e dhanë jetën për lirinë e Kosovës", ka theksuar kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku, në manifestimin përmbyllës të aktiviteteve për shënimin e 10 Gushtit - Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Kaçanikut, i mbajtur brenda mureve të kalasë mesjetare të qytetit. Në vazhdim, z.Zharku ka nënvizuar se pa sakrificën e atyre që e dhanë jetën për liri ne sot nuk do të ishim këtu. "Dëshmorëve do t'u jemi përjetë mirënjohës", ka theksuar kryetari Zharku. Ai i ka ftuar qytetarët që të japin kontributin e tyre për ndërtimin e shtetit, për të cilin u flijuan të rënët, duke i paguar tatimet dhe përmbushur obligimet tjera në funksion të një jete më të mirë për të gjithë. Me pietet për dëshmorët ka folur edhe z.Ejup Runjeva, kryetar i OVL-së së UÇK-së. "Në mesin e atyre që u flijuan për liri janë edhe Agim Bajrami – Komandant Zefi, tok me bashkëluftëtarët e tij, Xheladin Kurtaj e Besnik Begunca, të cilët e bënë të pamundurën për lirinë e Kosovës dhe për çështjen e madhe kombët are", ka thënë z.Runjev a. Manifes timi u përmbyl l me program artistik nga SHKA-të



"Gryka e Kaçanikut" dhe "Shqiponja", pastaj nga këngëtarët Milaim Mezini e Kerim Palloshi, ndërsa vargje për dëshmorët ka deklamuar Lulzim Bunjaku.

## Komuna ndihmon fermerët që kultivojnë perime

**12 gusht** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, nënkryetari, z. Heset Loku dhe zyrtarë të Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillim Rural, i kanë vizituar 2 nga 4 fushat provuese të mbjellura me perime (domate dhe speca), ndërsa fermerët Vebi Provoliu dhe Bekim Dema janë përgëzuar për përcaktimin e tyre për t'u marrë me perimtari. Projekti për mbjelljen me perime të 4 fushave provuese, secila me sipërfaqe prej 10 arësh, është financuar nga Komuna e Kaçanikut. Për blerjen e farërave, plehut artificial dhe fungicideve, 4 fermerët e përzgjedhur janë ndihmuar me 884 euro. "Në funksion të zhvillimit të bujqësisë, vitin e ardhshëm do të alokohen më shumë mjete për subvencionimin e fermerëve", ka theksuar kryetari Zharku.



## Përmbyllet procesi i zgjidhjes së drejtorëve të 10 shkollave fillore

**12 gusht** – Në përputhje me ligjet në fuqi, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës e ka përmbyllur procesin e zgjidhjes së drejtorëve të 10 shkollave fillore në territorin e komunës. Në postet e drejtorëve janë zgjidhur: z.Daut Shehu – "Emin Duraku" (Kaçanik); z. Zeqir Xhokli – "Ali Asllani" (Doganaj); z. Muzafer Gashi - "7 Shtatori" (Begracë); znj. Hanife Shorra - "Nazmi Osmani" (Elezaj); znj. Florije Zeneli – "Idriz Seferi" (Bob); z. Xhelal Mani - "Agim Bajrami" (Stagovë); z. Ekrem Vishi – "Kadri Zeka" (Dubravë); z.Fadil Krasniqi – "Qamil Ilazi" (Kaçanik i Vjetër); z.Qazim Livoreka – "Dituria" (Ivajë) dhe z.Avni Kuçi – "Naim Frashëri" (Kotlinë).

## Për të dytën herë organizohet panairi i gjedhit "Kaçaniku 2010"

**15 gusht** - Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në oborrin e shkollës në fshatin Koxhaj, e ka organizuar panairin e dytë të gjedhit "Kaçaniku 2010". Panairin e ka shpallur të hapur z.Nuhi Provoliu, drejtor i DBPZHR-së, ndërsa z.Heset Loku, nënkryetar i Komunës, ka thënë se ky panair do të jetë një inkurajim që në të ardhmen edhe më shumë fermerë me kafshët e tyre të marrin pjesë në këtë garë, duke kontribuar në zhvillimin e blegtorisë në komunën tonë. Ndërkaq, z.Xhabir Morina, zëvendësministër i MBZHR-së, ka theksuar se këto panaire ndikojnë në ngritjen e cilësisë, promovojnë punën e fermerëve dhe rezultatet e tyre, ndërsa ndodhë edhe shkëmbimi i përvojave mes fermerëve, shoqatave të tyre dhe ekspertëve. Z.Morina ka nënvizuar se MBRZH-ja sivjet do ta subvencionojë sektorin e blegtorisë me 2 milionë e 200 mijë euro. Prof. dr. Hajrip Mehmeti, profesor në Fakultetin e Bujqësisë dhe



Veterinarisë të Universitetit të Prishtinës, Bujar Ymeri, drejtor i Departamentit të Blegtorisë të MBZHR-së dhe Florim Shabani, zyrtar në MBZHR, në cilësinë e anëtarëve të komisionit vlerësues, i kanë shpallur fituesit e panairit. Nga raca produktive, vendi i parë i takoi lopës me nr.4, e pronarit Ibush Vishi, kurse nga ajo vendëse "Metisët", vendi i parë i takoi lopës me nr.5, e pronarit Xhevahir Berisha. Mëshqerra më e mirë u vlerësua ajo me nr.2, e pronarit Nejazi Sopa. Demi më i mire u shpall ai me nr.1, i pronarit Imri Fazliu. Vendet e para u shpërblyen me nga 200 euro, vendet e dyta me nga 150, kurse vendet e treta me nga 50 euro. Tufa më e mirë e deleve u shpall ajo me nr.2, e pronarit Vehbi Koxha. Ndërsa, dashi më i mirë u vlerësua ai me nr.1, i pronarit Naser Asaj. Vendet e para në këto kategori garuese u shpërblyen me nga 100 euro, vendet e dyta me nga 75, kurse vendet e treta me nga 50 euro.

## Nuk do të lejohet dëmtimi i rrugëve

**19 Gusht** - Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike i ka njoftuar qytetarët se do të merren masa ndëshkimore, në përputhje me Ligjin e rrugëve nr.2003/11, ndaj atyre që i dëmtojnë rrugët duke e prerë asfaltin. "Do të ndëshkohet edhe vendosja e pengesave të

ndryshme në rrugë, sikundër edhe veprimet tjera që i dëmtojnë ato", thuhet në paralajmërimin e DESHP-it. Çdo person që dëmton rrugët apo hapësirat publike do të ndëshkohet me gjoba që arrijnë shumën deri në 2.500 euro. DESHP-i u bën apel qytetarëve që t'i raportojnë rastet e dëmtimit të rrugëve te organet përgjegjëse komunale, apo edhe në polici.

## Rruga "Ismail Raka" bëhet me rrjet nëntokësor elektrik, Komuna i investon 47 mijë euro



**23 gusht** - Komuna dhe KEK-u janë bashkëfinancues të projektit për shtrirjen nën tokë të kabllove elektrike të tensionit të lartë në rrugën "Ismail Raka" të qytetit. Z.Fatos Koxha, zyrtar i Urbanizmit, ka thënë se për realizmin e këtij projekti janë alokuar 46.594 euro mjete të buxhetit të Komunës së Kaçanikut. "Komuna e ka marrë përsipër hapjen e kanalit në gjatësi prej rreth 1.300 metrash, pastaj instalimin e gypave në të cilët do të shtrihen kabllot elektrike dhe ndërtimin e pusetave", ka sqaruar z.Koxha. Ndërkaq, punëtorë të kontaktuar të KEK-ut, Njësia në Kaçanik, kanë thënë se kjo korporatë do t'i sigurojë kabllot elektrike dhe kyçjen e tyre në rrjetin elektroenergjetik.

## Nis ndërtimi i shkollës së re në "Dushkajë", investim i Ministrisë së Arsimit

**27 gusht** – Kanë nisur punët për ndërtimin e shkollës së re në lokalitetin "Dushkaja" të qytetit. "Për realizimin e këtij projekti MASHT-i do t'i investojë rreth 1 milion e gjysmë euro", ka theksuar z,Azem Guri, drejtor i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës. Ai ka sqaruar se shkolla e re do t'i ketë 14 dhoma mësimi, sallën e edukatës fizike dhe hapësirat tjera përcjellëse. Përurimi i shkollës së dytë fillore në qytetin Kaçanik pritet të ndodhë mot, ndërsa deri atëherë procesi mësimor në shkollën e vetme fillore në këtë qytet do të zhvillohet në 3 ndërresa. "Edhe këtë vit shkollor mësimi do të zhvillohet në 3 ndërresa me orë mësimore të reduktuara prej 30 minutash", ka pohuar z.Daut Shehu, drejtor i SHF"Emin Duraku". Ai ka rikujtuar se në këtë shkollë mësimet i ndjekin më se 1.800 nxënës, përfshirë edhe ata të paraleleve të ndara fizike.



# Komuna dhe KFOR-i do të bashkëpunojnë edhe në të ardhmen

**30 gusht** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, është takuar me kolonelin amerikan Francisco J. Neuman, komandant i Grupit Shumëkombëshe të Betejës – Lindja, ndërsa mysafirin e ka uruar për emërimin në krye të këtij grupi të KFOR-it. "Bashkëpunimi ynë i plotë dhe i sinqertë me KFOR-in për çështje me interes të përbashkët nuk do të mungojë as në të ardhmen", i ka thënë kryetari kolonelit Neuman. Z.Zharku e ka njoftuar mysafirin për punën dhe angazhimet e tij dhe të administratës komunale në funksion të shërbimeve sa më cilësore për qytetarët, ndërsa e ka vlerësuar të kënaqshme gjendjen e sigurisë në komunë. "Brengë jona mbetet mbrojtja e pyjeve nga prerësit pa leje", ka theksuar kryetari Zharku. Koloneli Neuman është zotuar se do ta ndihmojë Komunën e Kaçanikut sa i përket mbrojtjes së pyjeve publike. Zhvillimet në Komunën e Kaçanikut ai i ka cilësuar ndryshime pozitive.



## Kaçaniku bëhet me Zyrë të alarmit dhe koordinimit emergjent

**31 gusht** - Komuna ka marrë vendim për themelimin e Zyrës së munguar të alarmit dhe koordinimit emergjent (ZAKE). "Hapi i parë që e kemi ndërmarrë në këtë drejtim është punësimi i përgjegjësit të kësaj zyreje", ka theksuar z.Rushan Ceka, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës. Ai ka sqaruar se detyrë e ZAKE-s do të jetë identifikimi i rreziqeve për jetët dhe pasuritë e qytetarëve dhe koordinimi i operacioneve të mekanizmave përgjegjës për intervenime në situata emergjente (policia, zjarrfikësit dhe shërbimi i ndihmës së parë mjekësore). Ndërkaq, i përzgjedhuri në detyrën e sipërpërmendur, z.Bujar Bajra, ka thënë se ZAKE-ja do të bëhet funksionale me t'u bërë me zyrë dhe numër telefoni. "Në numrin e telefonit të kësaj zyreje qytetarët do të ftohen t'i raportojnë të gjitha aksidentet, incidentet dhe rastet tjera emergjente, ndërsa ne do t'i njoftojmë dhe koordinojmë intervenimet e mekanizmave përgjegjës", ka thënë ai. Z.Bajra ka pohuar se deri në funksionalizmin e ZAKE-s, qytetarët kaçanikas do të vazhdojnë t'i raportojnë rastet emergjente në numrin 112 në të cilin me "alo" do t'u përgjigjen zyrtarët e Qendrës rajonale operative emergjente në Gjilan.

*SHTATOR 2010*

# Urimi i kryetarit të Komunës me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor

**1 shtator** – "Të dashur nxënës, të nderuar arsimtarë dhe prindër,
Kam nderin dhe kënaqësinë që në emrin tim dhe të të gjithë qytetarëve të Komunës së Kaçanikut të ju uroj për fillimin e vitit të ri shkollor 2010/2011.
Sot, një armatë e tërë, pas pushimeve verore, po fillon një betejë të re, shumë me rendësi, betejë për te nxënë njohuri të reja në institucionet tona arsimore. Sistemi i arsimit në komunën tonë është një shembull i mirë në proceset e reformimit në arsim, duke dëshmuar një performansë të lartë dhe duke qenë model edhe për të tjerët, prandaj këtë vit e kemi shpallur vit të avancimit të cilësisë në arsim. Jam i bindur se me përkrahjen e institucioneve komunale dhe qendrore, së bashku do të arrijmë synimet tona.
Uroj të jetë një vit i mbarë shkollor dhe i sukseseve të përbashkëta".

Me respekt,
kryetari i Komunës së Kaçanikut,
Xhabir Zharku

# Kryetari akordon shpërblime për më të mirët në arsim

**1 shtator** - Kryetari i Komunës së Kaçanikut, z.Xhabir Zharku, ka akorduar "pagën e trembëdhjetë" për mësimdhënësin më të mirë të vitit shkollor 2010-2011, sikundër edhe një të tillë për njërin nga drejtorët më të mirë të shkollave. "Këtë vit shkollor e kemi shpallur vit të cilësisë dhe disiplinës", ka theksuar kryetari Zharku, duke iu referuar shpërblimeve të promovuara në takimin me drejtorët e shkollave. "Mësimdhënësi dhe mësimdhënësja më e mirë e vitit shkollor në vijim do të shpërblehen me nga 250 euro dhe me po aq euro edhe drejtori më i mirë i shkollave të komunës", ka theksuar z. Zharku. Përveçse "ka

nxitur" garën te këto dy kategori, kryetari i Komunës ka vendosur që të stimulojë edhe nxënësit. "Nxënësi më i mirë nga secila shkollë (12 fillore dhe 2 të mesme), do të përfitojë pushim veror falas në bregdetin shqiptar", ka thënë kryetari Zharku. Ndërkaq, z.Azem Guri, drejtor i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, ka thënë se një stimulim të tillë financiar nuk e kanë pasur drejtorët dhe mësimdhënësit deri tashti. "U kemi dhënë mirënjohje dhe ndonjë dhuratë modeste, por jo edhe të holla", ka thënë drejtori Guri.

## Zvogëlohen përmasat e dëmtimit të pyjeve publike nga prerësit pa leje

**2 shtator** – Zyrtarët përgjegjës komunalë kanë deklaruar se ka një trend të zvogëlimit të prerjeve pa leje të pyjeve publike pas bartjes së kompetencave për menaxhim të tyre nga niveli qendror në atë komunal, sivjet, më 12 korrik. "Gjendja tashti është më e mirë", ka thënë z.Agim Luzha, koordinator i sektorit komunal të pylltarisë. Me vlerësimin e z.Luzha është pajtuar z.Nuhi Provoliu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. "Kemi konstatuar se ka një trend të zvogëlimit të prerjeve pa leje në pyjet publike, ndonëse ende nuk jemi të kënaqur me gjendjen në këtë rrafsh", ka theksuar ai. Është thënë se për rritjen e efektshmërisë sa i përket mbrojtjes dhe menaxhimit cilësor të pyjeve publike duhet shtim i stafit teknik dhe numrit të rojtarëve të pyjeve. "Me gjithsej 6 rojtarë pyjesh, sa i kemi aktualisht, nuk mund të pretendojmë efektshmëri të kënaqshme në mbrojtjen e 13.800 hektarëve pyje publike dhe rreth 4.000 hektarëve të tjerë në pronësi private", ka nënvizuar drejtori Provoliu. Ai ka pohuar se mot do të ketë shtim të numrit të rojtarëve të pyjeve. Ndërkaq, z.Hajrush Dullovi, zëdhënës i Komunës, ka rikujtuar se KFOR-i ka artikuluar gatishmërinë për ta mbështetur sektorin komunal të pylltarisë sa i përket mbrojtjes së pyjeve nga prerësit pa leje. "Këtë gatishmëri e ka artikuluar koloneli amerikan Francisco Neuman,

komandant i Grupit Shumëkombësh të Betejës - Lindja, në takimin e fundit me kryetarin e Komunës, z.Xhabir Zharku", ka thënë zëdhënësi Dullovi.

## Gushti me shumë rekorde mjetesh të arkëtuara nga tatimi në pronë

**3 shtator** - Gushti ka rezultuar të jetë muaji me shumë rekorde mjetesh të arkëtuara nga pagesa e tatimit në prone. "Gushti është përmbyllur me shumë rekorde prej 31.151 eurosh të arkëtuara, ndërsa është vlerësim yni se kësaj shume i kanë kontribuar pagesat e bëra nga mërgimtarët dhe arsimtarët", ka theksuar z.Xhelal Dema, menaxher i Zyrës së Përhershme të Tatimit në Pronë. Ai ka nënvizuar se për 8 muaj është arkëtuar 86 për qind e shumës së planifikuar vjetore nga tatimi në pronë. "Gjatë periudhës 1 janar-31 gusht janë arkëtuar 142.467 euro ose 86,34 për qind e shumës së planifikuar me buxhetin e sivjetmë të Komunës", ka theksuar z.Dema. Ndërkaq, z.Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, ka deklaruar të jetë i kënaqur me shumën e arkëtuar. "Me këtë trend të pagesave besojmë se do ta kapërcejmë shumën e planifikuar vjetore të arkëtimit të mjeteve nga tatimi në pronë", është shprehur z.Vërbani.

## Mjekë anglezë dhe ushtarakë amerikanë e kanë trajnuar stafin e QKMF-së

**8 shtator** – Stafi i qendrës kryesore të mjekësisë familjare "Dëshmoret e Lirisë" në Kaçanik është trajnuar lidhur me aspekte të parandalimit të sëmundjes së kancerit të gjirit. Gjinekologia angleze, dr. Mary Packer, sot e ka mbajtur një ligjëratë profesionale me temë: "Parandalimi i kancerit të gjirit". Mjeku Ekrem Dullovi, drejtor i QKMF-së, e ka çmuar lart kontributin e znj. Packer për këtë institucion shëndetësor. "Pos që na ka ndihmuar në aspektin profesional, ajo e ka




pajisur edhe me inventar dhe aparatura mjekësore repartin e maternitetit", ka theksuar z.Dullovi. Ai ka thënë se më herët stafi i QKMF-së është trajnuar edhe nga mjekë të KFOR-it amerikan. "Në korrik, 12 mjekë dhe 8 infermierë janë certifikuar për reanimim të avancuar kardio-pulmonar", ka rikujtuar z.Dullovi. Me certifikata ata ishin pajisur pas trajnimit 1-mujor të realizuar nga një ekip profesional i Task Force 13 Medicine Falcon të KFOR-it amerikan. Spas z.Dullovi, udhëheqja e këtij trajnimi, nënkolonelja Lien Adams, anesteziologe, kishte deklaruar se vijuesit kanë qenë shumë aktiv në interesimin e tyre për të përfituar njohuri të reja nga kjo fushë e mjekësisë.

## Asfaltohet segmenti rrugor në lagjen "Vishaj" të Dubravës

**8 shtator** - Zyrtarë të Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit i kanë inspektuar punimet për shtrimin me asfalt të segmentit rrugor në lagjen "Vishaj" të fshatit Dubravë. Rruga në këtë lagje është e gjatë 240 metra dhe e gjerë 3 metra. Asfalti është

duke u shtruar në trashësi prej 7 cm, ndërsa në të dy krahët e rrugës janë shtruar me zhavorr bankinat e gjera 0,5 metra. Për realizimin e këtij projekti janë investuar 10.350 euro të fondit për meremetimin e rrugëve lokale të buxhetit komunal.



## "Logosi" "shpërblen" Kaçanikun me një projekt

**9 shtator** – Qeveria zvicerane do ta financojë realizmin e një projekti infrastrukturor në Kaçanik. Projekti i përzgjedhur do të financohet nga fondi për përkrahjen e qeverisjes lokale dhe decentralizimit "Logos", që menaxhohet nga agjencia zvicerane për bashkëpunim (SDC) dhe zbatohet nga fondacioni zviceran “Intercooperation”. "'Logosi' dhe Komuna e Kaçanikut e kanë nënshkruar marrëveshjen për bashkëfinancimin e projektit: 'Ndërtimi i trotuarit në rrugën 'Vëllezërit Çaka' në Kaçanik", ka theksuar z.Hajrush Dullovi, zëdhënës i Komunës. Rruga e sipërpërmendur do të bëhet me trotuare në të dyja anët e saj. "Realizmi i këtij projekti është përllogaritur të kushtojë rreth 10 mijë euro, ndërsa Komuna e ka marrë përsipër të participojë me 10 për qind të mjeteve", ka thënë z.Dullovi. Është sqaruar se projekti i përzgjedhur për realizim do të financohet nga fondi i "Logosit" prej 1 milion e gjysmë eurosh që synon të përmirësojë qasjen dhe cilësinë e shërbimeve publike për qytetarët e komuniteteve të ndryshme, sikundër edhe të rrisë aftësitë e menaxhimit të projekteve nga komunat partnere.

## Kaçaniku mot me buxhet 9 për qind "më të rëndë" se i sivjetmi

**10 shtator** - Është hartuar versioni parafinal i buxhetit të Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2011, ndërsa është projektuar të jetë "më i rëndë" se i sivjetmi për rreth 9 për qind. "Buxheti i vitit të ardhshëm është projektuar në lartësi prej 4.754.340 eurosh, ndërsa për 8,9 për qind është më i lartë se i sivjetmi (4.366.230 euro)", ka theksuar z.Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë të Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit. Në shumën e projektuar të buxhetit të vitit të ardhshëm, 4.187.559 euro (88,1%) ishte planifikuar të sigurohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, ndërsa 566.781 euro (11,9%) nga hyrjet prej burimeve vetjake komunale. "Hyrjet vetjake mot është paraparë të rriten për 3,2 për qind në raport me shumën e buxhetit të sivjetmë të hyrjeve nga këto burime (549.341 euro)", ka thënë drejtori Vërbani. Sa i përket kategorive ekonomike të shpenzimeve, për paga dhe mëditje do të shpenzohen 2.795.300 euro ose 58,8 për qind e buxhetit, për mallra dhe shërbime 364.476 euro (7,7%), për shërbimet komunale 81.904 euro (1,7%), për subvencione dhe transfere 42.286 euro (0,9%), kurse 1.470.374 euro (30,9%) për investime kapitale.

## Vetëm 24 maturantë kaçanikas nuk e kanë kaluar provimin e maturës

**13 shtator** – Vetëm 24 maturantë kaçanikas nuk e kanë kaluar provimin shtetëror të maturës. Zyrtarë komunalë të sektorit të arsimit kanë thënë se nga ulja e kriterit të kalueshmërisë për provimin e maturës kanë përfituar 5 për qind e maturantëve kaçanikas që nuk e kishin kaluar atë në afatet e qershorit dhe gushtit. "Gjithsej 626 maturantë iu kanë nënshtruar provimit të maturës në afatet e qershorit dhe gushtit, ndërsa e kanë kaluar 569 ose 91 për qind", ka rikujtuar z.Avni Krasniqi, zyrtar i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës,

përgjegjës për arsimin e mesëm. Ai ka theksuar se nga ulja e kriterit të kalueshmërisë kanë përfituar edhe 5 për qind e maturantëve të cilët në afatet e sipërpërmendura janë vlerësuar me 45-49 pikë. "Nga të gjithë maturantët që iu kanë nënshtruar provimit shtetëror të maturës sivjet, 626 sish, tashti rezulton se vetëm 24 ose 4 për qind nuk e kanë kaluar atë", ka nënvizuar z.Krasniqi.

## Kryetari e kundërshton propozimin për rritjen e tatimit në pronë



**17 shtator** - Ndonëse zyrtarë të Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit patën paralajmëruar ngritjen e tarifave të tatimit në pronë për vitin e ardhshëm, kjo nuk do të ndodhë. Rritja është kundërshtuar nga kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku. "Është e vërtetë se patëm planifikuar rritje të tatimit për vitin 2011, mirëpo propozimi ynë nuk është miratuar nga kryetari Zharku", ka theksuar z.Fikri Vërbani, drejtor i DFEZH-së. Pohimet e tij i ka konfirmuar kreu i Komunës. "Kam vlerësuar se rritja e tarifave të tatimit në pronë do t'i rëndonte buxhetet e familjeve dhe do të kishte efekt negativ në trendin pozitiv të arkëtimit të mjeteve nga ky lloj tatimi", është shprehur kryetari Zharku. Tarifat aktuale të tatimit në pronë janë në fuqi që nga viti 2004, kurse tatimpaguesit janë të ndarë

në 4 zona tatimore. Z.Xhelal Dema, menaxher i Zyrës së Përhershme të Tatimit në Pronë, ka rikujtuar se pronari i një objekti të banimit me 100 metra katrorë hapësirë në zonën e katërt edhe mot do të ngarkohet me vetëm 5 euro tatim. "Objektet e banimit me hapësirë të njëjtë në zonën e tretë do të tatimohen me 10 euro, ato në zonën e dytë me 15, ndërsa objektet në zonën e parë 20 euro", ka saktësuar z.Dema.

## Të rinjtë kanë debatuar për trashëgiminë

**19 shtator** - Z.Ilaz Ramajli, nënkryetar i përbërjes së Kuvendit të Kosovës që e ka miratuar kushtetutën e Republikës së panjohur ndërkombëtarisht të Kosovës, në Kaçanik, më 7.9.1990, në debatin e organizuar në kuadër të aktiviteteve për shënimin e Ditës së Rinisë së Kaçanikut, me temë trashëgiminë, ka theksuar se 7 shtatori i 1990-s është datë që Kaçanikun e bëri protagonist të historisë më të re të Kosovës. Duke folur në sallën në të cilën e kishte kryesuar mbledhjen e Kuvendit të Kosovës para 20 vjetësh, Ramajli ka thënë se kaçanikasit duhet të ndjehen krenarë për kontributin e dhënë rreth organizimit dhe mbajtjes së mbledhjes në konfidencë të plotë. "Ka qenë një provim i dhënë me sukses të plotë nga kaçanikasit për çështjen kombëtare", është shprehur ai. Në këtë



rrafsh, Z.Ramajli ka theksuar se tërë historia është trashëgimi, ndërsa datat vlera kulmore të saj. E reja Fatlume Guri ka thënë se ngjarjet që lidhen me datën e miratimit të Kushtetutës së Kaçanikut duhet të trajtohen në të gjitha rrafshet. Ndërkaq, Jusuf Musa, udhëheqës i sektorit të arkeologjisë të Ministrisë së Kulturës, të pranishmit i ka njoftuar me angazhimet e kësaj ministrie sa i përket ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore. Me moton: ”Rinia – forcë që ndryshon të ardhmen”, e nën patronazhin e Kryetarit të Komunës, z.Xhabir Zharku, Dita e Rinisë u shënua edhe me shumë aktivitete të tjera. Hapjen solemne të këtyre aktiviteteve, në emër të kryetarit të Komunës, e ka bërë z. Azem Guri, drejtor i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës. Të rinjtë kanë zhvilluar gara në sporte të ndryshme dhe kanë marrë pjesë në aktivitete argëtuese e kulturore.

## Përurohen Zyra e ambientalistëve të rinj

**19 shtator**-Në kuadër të aktivitetet për shënimin e Ditës së Rinisë së Kaçanikut, është bërë përurimi i zyrave të ambientalistëve të rinj që



gjenden në objektin e Pallatit të Kulturës. Përurimin e këtyre zyrave të pajisura me kompjuterë, fotokopjues, televizor etj., sikundër edhe me inventar të nevojshëm, e kanë bërë z. Bekim Troni, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe z.Muharrem Ahmetaj, drejtor i pallatit të kulturës "Xheladin Kurtaj". Paisjet me vlerë rreth 20 mijë dollarë amerikan janë donacion i USAID-it. Komuna e Kaçanikut është njëra nga 14 komunat e Kosovës të shpërblyera nga USAID-i për performansë të dalluar. Komuna jonë pati aplikuar me projektin për themelimin e Zyrës së vullnetarëve për mbrojtjen e mjedisit, ndërsa ky projekt nga USAID-i qe vlerësuar në përputhje me kriteret për menaxhim inovativ të donacionit.

## Pyjet s'mund të mbrohen pa funksionimin e trekëndëshit komunë-polici-gjykatë

**22 shtator** - Komuna e Kaçanikut, Policia e Kosovës dhe Gjykata Komunale janë marrë vesh për të bashkëvepruar në drejtim të uljes në



minimum të përmasave të dëmtimit të pyjeve nga prerësit pa leje. Marrëveshja për këtë çështje është arritur në takimin e përfaqësuesve të institucioneve të sipërpërmendura. "Nuk mund të ketë mbrojtje të efektshme të pyjeve pa funksionim të trekëndëshit komunë-polici-gjykatë", ka vlerësuar nikoqiri i takimit, z.Heset Loku, nënkryetar i Komunës. Ndërkaq, togeri Jaser Jaha, u.d. i komandantit të Stacionit Policor në Kaçanik, ka theksuar se policia do të vazhdojë ta kryejë pjesën e vet të punës sa i përket mbrojtjes së pyjeve. Ideja për bashkëveprim në mbrojtje të pyjeve publike është mbështetur edhe nga z.Hebib Livoreka, kryetar i Gjykatës Komunale në Kaçanik. "Do t'u japim prioritet për zgjidhje lëndëve penale që kanë të bëjnë me prerje pa leje drush në pyjet publike", ka premtuar z.Livoreka. Zyrtarë përgjegjës komunalë kanë rikujtuar se nga muaji korrik Komunës së Kaçanikut i janë bartur kompetencat për menaxhimin e pyjeve publike. "Ndërkohë kemi konstatuar se ka një rënie të përmasave të dëmtimit të pyjeve, mirëpo ende nuk mund të themi se gjendja është e kënaqshme", është shprehur z.Nuhi Provoliu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

## Legjislativi miraton buxhetin e Komunës të vitit fiskal 2011

**24 shtator** - Është miratuar buxheti i Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2011, në seancën e radhës të legjislativit komunal. Buxheti i vitit të ardhshëm është aprovuar në lartësi prej 4.754.340 eurosh, ndërsa për 8,9 për qind është më i lartë se i sivjetmi (4.366.230 euro). Është votuar edhe propozimvendimi për ridestinimin e 127.807 eurove të pashpenzuara të fondit të investimeve kapitale. Këshilltarët ia kanë vazhduar “mandatin” edhe për 1 vit rregullores së vjetër të taimit në pronë, ashtu siç kishte kërkuar kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku.

## Komuna përcaktohet për shitjen e mbetjeve drusore

**26 shtator** - Komuna e Kaçanikut është përcaktuar për shitjen e mbetjeve të lisave të prerë pa leje në pyjet publike, ndërsa ky hap është vlerësuar të jetë në funksion të zvogëlimit të përmasave të dëmtimit të tyre. Në vendimin e hartuar nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, i miratuar njëzëri në seancën e fundit të legjislativit komunal, thuhet se një kamion me mbetje lisash të diametrit nën 7 cm do të shitet 30 euro. "Ngarkesa e një qerreje kuajsh do të shitet 10 euro, ndërsa ajo e një traktori 25 euro", saktësohet aty. Është thënë se furnizimi me dru për djegie i qytetarëve nëpërmjet shitjes së mbetjeve të lisave do të rezultojë me ulje kërkesash për blerje drush nga prerësit pa leje. "Në pyje ka mbetje të shumta lisash", ka theksuar z.Nuhi Provoliu, drejtor i DBPZHR-së.

## Vërejtje kompanive për transport udhëtarësh në linjat komunale

**27 shtator** - Firmat e licencuara për bartje udhëtarësh në linjat komunale nuk janë duke operuar konform ligjeve në fuqi. "Është konstatuar se të gjitha kompanitë e licencuara për transport udhëtarësh në linjat komunale nuk janë duke operuar në përputhje me Ligjin e transportit publik nr.2004/1 dhe Ligjin e sigurisë në transportin rrugor nr.02/L-70", ka theksuar z.Hajrush Dullovi, zëdhënës i Komunës. Ndërkaq, z.Rushan Ceka, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, ka thënë se të gjitha kompanive u është dërguar vërejtje me shkrim për mosoperim në përputhje me ligjin. "Të gjitha këto kompani janë duke bartur më shumë udhëtarë sesa kanë ulëse autobusët dhe kombibusët e tyre", ka theksuar z.Ceka. Është konstatuar të ketë edhe mosrespektim të orarit të qarkullimit, sikundër edhe mosmbajtje linjash në periudha të caktuara. "Kompanitë që do të vazhdojnë të mos e përfillin ligjin do të

ndëshkohen konform ligjeve në fuqi, ndërsa nuk do t'u vazhdohet leja për operim mot", ka theksuar z.Ceka.

## Kryetari inspekton punimet për asfaltimin e rrugës "Dëshmorët e Lirisë"

**28 shtator** - Kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku, i ka inspektuar punimet e nisura për asfaltimin e rrugës "Dëshmorët e Lirisë". Ai u ka dhënë notë pozitive punimeve të deritanishme aty. Në kuadër të projektit për asfaltimin e rrugës së sipërpërmendur është përfshirë edhe instalimi i rrjetit të kanalizimit fekal në gjatësi prej 371,5 metrash dhe ndërtimi i 3 tombinave (ura të vogla). Me projekt është paraparë edhe ndërtimi i 4 mureve mbajtëse për përforcimin e trupit të rrugës, sikundër edhe përgatitja e trasesë për asfaltimin e saj. Për realizimin e këtij projekti Komuna i ka alokuar 39.856 euro.



## MAPL-i ndërton shkollë në Vataj

**29 shtator** - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Komuna e Kaçanikut e kanë firmosur marrëveshjen për bashkëfinancimin e projektit për ndërtimin e shkollës 4-klasëshe në fshatin Vataj. Z.Bekim Troni, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, ka theksuar se për realizimin e projektit të sipërpërmendur MAPL-i i ka alokuar 91 mijë euro. Mjetet që eventualisht do të mungojnë, pas kontraktimit të kompanisë punëkryese, do të sigurohen nga buxheti komunal.

## Komuna dhe "Carlux"-i riasfaltojnë rrugën e Biçecit

**29 shtator** - Kanë nisur punimet për zgjerimin dhe riasfaltimin e rrugës kryesore të fshatit Biçec, ndërsa projekti është duke u realizuar me para të Komunës së Kaçanikut dhe të "Caritasit" të Luksemburgut. "Për realizimin e këtij projekti 'Carlux'-i i ka alokuar 20 mijë euro, ndërsa Komuna 40 mijë", ka theksuar z.Kjani Sallahu, koordinator i Këshillit të Zhvillimit të Komunitetit të Biçecit.. Ndërkaq, z.Hajrush Dullovi, zëdhënës i Komunës, ka thënë se projekti parasheh zgjerimin dhe riasfaltimin e segmentit rrugor në gjatësi prej 622 metrash. "Asfalti do të shtrihet në gjerësi prej 5 metrash dhe trashësi prej 8 centimetrash", ka saktësuar ai. Është thënë se segmenti i sipërpërmendur për herë të parë është asfaltuar para 20 vjetësh me vetëkontribut të fshatarëve. "Atëbotë rruga qe asfaltuar në gjerësi prej 3 metrash", ka rikujtuar koordinatori i KZHK-së të Biçecit, z.Kjani Sallahu.

# Kryetari inspekton punimet në rrugën "2 Korriku"

**30 shtator** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, i ka inspektuar punimet që janë duke u bërë për realizimin e projektit: "Instalimi i kanalizimit fekal dhe asfaltimi i krahut në rrugën "2 Korriku"". Z. Zharku u ka thënë banorëve të lagjes se po mundohemi që të krijojmë kushte më të mira për të gjithë qytetarët e komunës sonë. Ndërkaq, përfaqësuesi i komunitetit të lagjes, z. Afrim Fuga, ka thënë të jetë i kënaqur me cilësinë e punëve të kryera ndërkohë. Projekti përfshinë instalimin e rrjetit të kanalizimit fekal në gjatësi prej 295 metrash, asfaltimin e rrugës në gjatësi prej 175 metrash dhe gjerësi 3-5 metra. Asfalti do të shtrohet në trashësi prej 12 centimetrash (8 cm + 4 cm). Për realizimin e këtij projekti janë alokuar 39.970 euro të buxhetit komunal.



*TETOR 2010*

# Themelohet Ekipi komunal për grante shkollore

**1 tetor** – Është themeluar Ekipi komunal për grante shkollore (EKGSH), ndërsa në përbërje të tij janë emëruar: z.Azem Guri, drejtor i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, z.Bahri Avdiu, përfaqësues i MASHT-it, z.Zeqir Selmani, kryetar i Këshillit të prindërve dhe z.Mallzum Qajani, bashkëpunëtor profesional i terrenit për grante. Vëzhgues të ekipit janë emëruar z.Bajrush Bunjaku, zyrtar i Qendrës së Punës Sociale në Kaçanik dhe znj.Sebahate Elezi, zyrtare e “Handikosit” në Kaçanik. Detyrë e EKGSH-së do të jetë realizimi i projekteve dhe menaxhimi i granteve konform kritereve dhe udhëzimeve të MASHT-it. EKGSH-ja do të bëjë ndarjen e granteve të cilat i dhuron Banka Botërore për shkollat fillore dhe ato të mesme. Shkollat pritet të përfitojnë grante në shumë deri në 10 mijë euro, ndërsa shuma e tyre për shkollat e mesme profesionale do të shkojë deri në 15 mijë euro. EKGSH-ja do ta bëjë edhe përzgjedhjen e shkollave përfituese në përputhje me kriteret e hartuara nga Këshilli qendror për aprovimin e granteve.



# Kryetari inspekton punimet për riasfaltimin e rrugës në Biçec

**1 tetor** - Kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku, i ka inspektuar punimet për riasfaltimin e rrugës në fshatin Biçec. “Komuna do të vazhdojë të realizojë projekte të cilat krijojnë kushte për jetë më të mirë për të gjithë qytetarët e komunës sonë”, u ka thënë kryetari Zharku biçecasve. Ndërkaq, administratori i fshatit Biçec, z. Shabi Dullovi, e ka falënderuar kryetarin Zharku për investimet e bëra nga Komuna në këtë mjedis. Ai ka thënë të jetë i kënaqur me cilësinë e punëve të kryera deri sot nga kompania e kontraktuar për realizimin e projektit. Në këtë rrafsh, z.Bekim Troni, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, ka theksuar se në vazhdimësi do t’i përcjellim punimet dhe nuk do të tolerojmë as më të voglin lëshim. Projektin për riasfaltimin e rrugës në Biçec e bashkëfinancojnë Komuna e Kaçanikut dhe “Caritasit” të Luksemburgut, ndërsa realizimi e tij është kontraktuar në shumë prej 47.957 eurosh.



## Sektori i pylltarisë i shet rreth 4 mijë kubikë dru

**7 tetor** – Komuna e Kaçanikut i ka shitur 3.810 kubikë dru të pyjeve publike. "Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka lidhur kontratë me 4 operatorë të licencuar për prerjen e 2.234 kubikëve dru zjarri dhe 1.576 kubikëve dru teknik në rajonin 'Ahishta'", ka theksuar z.Hajrush Dullovi, zëdhënës i Komunës. Kubikët e kontraktuar janë shitur në shumë prej 73.259 eurosh. Ndërkaq, z.Nuhi Provoliu, drejtor i DBPZHR-së, ka sqaruar se operatorëve ekonomikë të kontraktuar 1 kubik dru zjarri u është shitur me çmim prej 12 euro, ndërsa 1 kubik dru teknik 30 euro. Drejtori Provoliu ka thënë të ketë marrë premtime nga operatorët e kontraktuar se do t'i furnizojnë institucionet publike me dru për djegie me çmim të volitshëm. "Nuk kemi të drejtë t'i kushtëzojmë blerësit se ku apo kujt duhet t'ia shesin drutë e blerë, por nga këta operatorë të kontraktuar kam marrë premtime se së paku shkollave dhe institucioneve tjera komunale do t'ua shesin me çmim të volitshëm", ka theksuar z.Provoliu.

## Përurohet shkolla e re në Begracë



**9 tetor** – Është përuruar objekti i ri i shkollës fillore "7 Shtatori" në fshatin Begracë. Shiritin përurues e kanë prerë z.Enver Hoxhaj, ministër i MASHT-it, z.Xhabir Zharku, kryetar i Komunës, z.Berat Luzha, deputet i

Kuvendit të Kosovës dhe z.Qemajl Mustafa, kryetar i Komunës së Gjilanit. Është thënë se projekt është realizuar me rreth 700 mijë euro të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.
Kreu i kësaj ministrie, z.Hoxhaj, pasi i ka uruar nxënësit, arsimtarët dhe prindërit e pranishëm për shkollën e re, ka theksuar se qëllim yni është që çdo nxënës të jetë pjesë e sistemit arsimor. Ndërkaq, z.Xhabir Zharku e ka falënderuar MASHT-in për investimet në infrastrukturën shkollore të komunës sonë. Për investimin në ndërtimin e shkollës së re në Begracë ministri Hoxhaj është falënderuar edhe nga z.Muzafer Gashi, drejtor i "7 Shtatorit". "Objekti i ri i ka 10 dhoma mësimi, 4 kabinete dhe hapësirat e personelit arsimor", ka theksuar ai. Z.Gashi ka thënë se në shkollën që ai udhëheq mësimet i vijojnë 425 nxënës.

## Francezët i dhurojnë SHZSH-së një zjarrfikëse

**10 tetor** – Zjarrfikësit francezë të Komunës Meythet, prefektura Haute Savoie, u kanë dhuruar kolegëve kaçanikas një kamion për fikje zjarresh. "Kamioni i markës 'Renault' nuk është i ri, por teknikisht është në gjendje të rregullt për intervenime", ka theksuar z.Rushan Ceka, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës. Ndërkaq, z.Ylber Shehu, shef i Shërbimit të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, ka nënvizuar se tashti ky shërbim i ka në dispozicion 3 kamionë për fikje zjarresh.



# Nis zbatimi i plani operativ të transportit publik

**11 tetor** – Ka nisur zbatimi i planit operativ të transportit publik. Zbatimi i këtij plani nga sektori i trafikut rrugor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës është në funksion të largimit nga trafiku të taksistëve pa leje operimi, mbylljes së vendparkimeve ilegale në rrugët e qytetit, parandalimit të lëvizjes së automjeteve me shpejtësi të mëdha dhe moslejimit të operatorëve të licencuar për bartje të më shumë udhëtarëve sesa kanë ulëse automjetet e tyre. Inspektori i trafikut, z. Besim Sallahu, ka thënë se nga sot ka nisur zbatimi i planit të sipërpërmendur. Ndërkaq, z.Mendu Krasniqi, shef i sektorit të shërbimeve publike të DSHPE-së, ka thënë se policia është duke e asistuar planin.



# MAP-i e vlerëson Komunën e Kaçanikut për arkivim elektronik dokumentesh

**12 tetor** – Sektori i arkivit i Komunës është vlerësuar të jetë më i miri në vend sa i përket arkivimit elektronik të dokumenteve. "Ministria e Administratës Publike e ka vlerësuar Komunën e Kaçanikut si institucionin me përdorim më të madh të sistemit elektronik të dokumenteve", ka theksuar z.Hajrush Dullovi, zëdhënës i Komunës. Ndërkaq, z.Jeton Topalli, drejtor i Admnistratës së Përgjithshme, ka sqaruar se vlerësimi për arkivin e Komunës së Kaçanikut është bërë nga Fakije Zejnullahu, udhëheqëse e divizionit për menaxhim dhe integrim të sistemeve në MAP. Në këtë rrafsh, znj.Afide Kuka, shefe e

sektorit komunal të arkivit, ka theksuar se deri sot (12 tetor), është bërë arkivimi elektronik i 2.870 dokumenteve.

## Themelohet Këshilli rinor i veprimit lokal në Kaçanik

**12 tetor** – Është themeluar Këshilli i veprimit rinor lokal në Kaçanik (KVRLKAÇ). Në përbërjen e Kuvendit të KVRLKAÇ-it janë emëruar 21 veta, përfaqësues të 16 organizatave. Kryetar i Këshillit... është zgjidhur z.Arlind Hysa. ndërsa zonjusha Mirlinda Axhami nënkryetare. Është miratuar edhe Statuti i KVRLKAÇ-it. Në përputhje me statutin e miratuar, anëtarë të bordit të KVRLKAÇ-it u zgjidhën: Arlind Hysa, Mirlinda Axhami, Argjenda Axhami, Marigona Çaka, Arbenita Koka, Visar Mulaku, Adrian Bajrami, Ilirjana Berisha dhe Teuta Malsiu. Akti i themelimit të Këshillit... është përshëndetur nga z.Azem Guri, drejtor i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës dhe nga përfaqësuesi i GTZ-së, z. Albion Zeka.



## Realizohet plani vjetor i të hyrave nga tatimi në pronë

**13 tetor** – Komuna e Kaçanikut e ka realizuar planin vjetor të të hyrave nga tatimi në prone 2 muaj e gjysmë para afatit të planifikuar. "Nga 1 janari e deri sot (13 tetor), janë arkëtuar 165.113 euro, ndërsa shuma e paraparë për arkëtim me buxhetin e sivjetmë është 165.000 euro", ka theksuar z.Xhelal Dema, menaxher i Zyrës së Përhershme të Tatimit

në Pronë. Ai ka thënë se rezultatit të arritur i ka kontribuar edhe vetëdijesimi në rritje i qytetarëve për kryerjen e obligimeve ndaj shtetit. Ndërkaq, z,Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvilimit, ka thënë se nga ky lloj tatimi vjet janë arkëtuar 150.290 euro. “Nga aplikimi i tatimit në pronë, më 2002, e deri më 30.9.2010 janë arkëtuar 898.796 euro”, ka theksuar z.Vërbani.



## BB-ja dhe MPMS-ja vlerësojnë lart realizimin e projektit për pastrimin e përrenjve

**19 tetor** – Banka Botërore dhe MPMS-ja e kanë vlerësuar lart rrjedhën e realizmit të projektit për pastrimin e përrenjve në Kaçanik. Nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku, është takuar me z.Ihsan Ajward, përfaqësues i Bankës Botërore me seli në Washington, i cili shoqërohej nga z.Hafiz Leka, kryesues i divizionit të punës të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. “Kam ardhur këtu që të shoh nga afër



realizimin e projektit nga programi i punëve publike për gjenerim punësimi dhe zvogëlim të varfërisë, që financohet nga BB-ja nëpërmjet Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Zyrës Komunale të Punësimit në Kaçanik", ka thënë z.Ajward. Nënkryetari Loku i ka thënë mysafirit se nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes me MPMS-në për realizimin e projektit: "Pastrimi i përrenjve", Komuna iu ka qasur me seriozitet të plotë realizimit të tij. "Projekti është mirëpritur edhe nga qytetarët", ka nënvizuar z.Loku. Ndërkaq, drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, z. Rushan Ceka, ka thënë se në vazhdimësi e kemi përcjellur nga afër realizimin e projektit. Mysafirët kanë deklaruar të jenë shumë të kënaqur me dinamikën dhe cilësinë e realizimit të projektit. "Jam i fascinuar me tërë ecurinë e realizimit të këtij projekti në Komunën e Kaçanikut", ka theksuar z.Leka. Ai ka pohuar se nga janari i vitit të ardhshëm, nëpërmjet MPMS-së, do të realizohen edhe projekte të tjera me afat më të gjatë kohor. Më 1 qershor, Komuna e Kaçanikut e pati nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi me MPMS-në për realizimin e projektit: "Pastrimi i përrenjve" në shumë prej 43.092 eurosh. Projekti është në fazën e realizimit. Ka nisur me pastrimin e shtratit të lumit Nerodime, ndërsa ka vazhduar me pastrimin e përrenjve.

## DAK-u ndryshon Rregulloren e punës të shkollave të mesme

**21 tetor** – Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës e ka ndërmarrë hapin e parë për ndryshimin e Rregullores së punës të shkollave të mesme. Në funksion të avancimit të disiplinës në punë, është themeluar Komisioni për hartimin e propozimndryshimeve në Rregulloren e punës të shkollave të mesme. Kryetari i Komisionit, z. Afet Ceka, zyrtar për arsimin fillor dhe parafillor, ka thënë se në përbërjen e komisionit 9-anëtarësh janë përfshirë zyrtarë të DAK-ut, profesorë të shkollave të mesme dhe përfaqësues të Këshillit të prindërve. Z.Ceka ka pohuar se



Komisioni e ka nisur punën, ndërsa ndryshimet e propozuara fillimisht do të nxjerrën në diskutim publik e më pas do t'i dorëzohen Kuvendit të Komunës për miratim. Vitin shkollor 2010/2011 Komuna e ka shpallur vit të cilësisë në arsim.

## Kaçaniku dhe Ferizaj për një projekti të përbashkët për ujërat e zeza që derdhen në Neredime

**21 tetor** – Komuna e Kaçanikut dhe ajo e Ferizajt janë pajtuar se duhet të ndërpritet derdhja e ujërave të zeza në lumin Neredime. Z.Bekim Troni, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, ka zhvilluar një takim pune me z.Ardian Ferizi, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të KK të Ferizajt. Dy drejtorët janë pajtuar se është e patolerueshme derdhja e ujërave të zeza të Ferizajt dhe Kaçanikut në lumin Neredime. Nikoqiri dhe mysafiri janë pajtuar edhe për nevojën e hartimit të një projekti ndërkomunal për zgjidhjen e problemit të ujërave të zeza. Në takim kanë marrë pjesë edhe z.Kemal Murseli, administrator i fshatit Doganaj dhe z.Ramadush Osmani, administrator i fshatit Elezaj, ndërsa është biseduar edhe për mundësinë e kyçjes në rrjetin e kanalizimin fekal të fshatit Rakaj të Ferizajt të 6 fshatrave të Kaçanikut (Doganaj, Duraj, Elezaj, Gabrricë, Gërlicë dhe Koxhaj). Instalimi i rrjetit të kanalizimit fekal në Rakaj është në fazën përgatitore.

## "LOGOS"-it dhe Komuna pritet ta ndërtojnë urën mbi Neredime

**26 tetor** – Komuna e Kaçanikut dhe "LOGOS"-i pritet ta bashkëfinancojnë projektin për ndërtimin e urës mbi lumin Neredime në Kaçanik. Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit ia ka dorëzuar zyrës së "LOGOS"-it në Gjilan konceptprojektin e urës. Z.Fikri Vërbani, drejtor i DFEZH-së, ka thënë se sot kemi aplikuar në zyrën e "LOGOS"-it në Gjilan me projektin: "Ndërtimi i urës mbi lumin Neredime". Për këtë projekt "LOGOS"-i ka alokuar 50 mijë euro, ndërsa Komuna e Kaçanikut do t'i investojë 30 mijë euro. Drejtori Vërbani ka theksuar se ura pritet të ndërtohet mot, ndërsa i takon fazës së dytë të programit: "Përkrahja e Qeverisjes Lokale dhe Decentralizimit-LOGOS", që financohet nga Qeveria zvicerane. Në fazën e parë "LOGOS"-i i kanë dhënë 9 mijë euro për realizimin e projektit: "Ndërtimi i trotuarit në rrugën 'Vëllezërit Çaka'". Në këtë projekt Komuna ka participuar me 1 mijë euro.

## Legjislativi miratoi 2 rregullore dhe 1 vendim, shqyrtoi edhe disa raporte

**29 tetor** - Kuvendi i Komunës e ka miratuar Rregulloren për ndalimin e zënies së hapësirave publike dhe ekspozimit të mallrave jashtë lokaleve afariste. Është miratuar edhe propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për caktimin e orarit të punës të subjekteve afariste në territorin e Komunës së Kaçanikut, sikundër edhe vendimi për mënyrën e llogaritjes dhe lartësinë e kompensimit për pranimin teknik të objekteve. Në agjendën e seancës së sotme ka qenë edhe shqyrtimi i raportit lidhur me realizmin e mjeteve buxhetore për periudhën 1 janar-30 shtator dhe raporti i punës i ekzekutivit komunal për këtë periudhë. Përbërja e legjislativit është njoftuar edhe me raportin e Zyrës së auditorit gjeneral lidhur me pasqyrat financiare të

Komunës së Kaçanikut për vitin 2009. Z.Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, duke folur për raportin 9-mujor të realizimit të buxhetit komunal, ka sqaruar se 71,4 për qind e mjeteve kanë shkuar për pagat dhe mëditjet e të punësuarve në sektorin publik. Për paga dhe mëditje janë shpenzuar 2.046.350 euro, për mallra dhe shërbime 219.143 (7,6%), për investime kapitale 480.987 (16,8%), për subvencione dhe transfere 57.292 (2%) dhe për shërbime komunale 62.394 euro (2,2%). Sa i përket shpenzimeve sipas programeve buxhetore, drejtori Vërbani ka thënë se sektori i arsimit i ka shpenzuar 1.545.502 euro ose 53,9 për qind të totalit të mjeteve të realizuara. Administrata komunale i ka shpenzuar 920.119 euro (32,1%), ndërsa shëndetësia 400.478 euro (14%).



Këshilltarëve të pranishëm në seancë me një fjalë u është drejtuar z.Ulrich Biffar, drejtor i Zyrës rajonale të OSBE-së në Gjilan, i cili për bashkëpunim të sinqertë dhe të suksesshëm i ka dhënë mirënjohje Kuvendit të Komunës së Kaçanikut. Në emër të Kuvendit, mirënjohjen e ka pranuar kryesuesi i legjislativit, z. Xhelal Gashi.

*NËNTOR 2010*

## Kryetari kërkon vendosjen e “policëve të shtrirë” në rrugët lokale

**1 nëntor** – Kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku, ka kërkuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës vendosjen e “policëve të shtrirë” në rrugët e asfaltuara lokale brenda territorit të komunës. Këtë kërkesë ai e ka artikuluar në takimin e fillimjavës të ekzekutivit komunal. “Tani janë shtuar kilometrat e asfaltuara në rrugët lokale, ndërsa automjetet po lëvizin me shpejtësi të mëdha”, ka theksuar kryetari Zharku. Në funksion të parandalimit të aksidenteve, z.Zharku ka kërkuar nga drejtori i DSHPE-së, z.Rushan Ceka, që përveç masave të tjera, të bëhet edhe vendosja e pengesave në rrugët e asfaltuara lokale. “Përparësi në këtë rrafsh t’i jepet segmentit Bob-Doganaj”, ka nënvizuar kryetari Zharku.

## GTZ-ja dorëzoi pajisjet elektronike për ZZHKSA-në

**2 nëntor** – GTZ-ja gjermane i ka dorëzuar pajisjet elektronike për Zyrën e zhvillimit të kapaciteteve në sektorin e arsimit (ZZHKSA) të Komunës së Kaçanikut. Protokollin e dorëzimpranimit e kanë firmosur z. Horst Steel, menaxher i projektit për arsimin fillor dhe drejtori i Drejtorisë së Arsimit e



Kulturës, z. Azem Guri. Zyra e sipërpërmendur është furnizuar më laptopë, videoprojektorë, printerë etj. dhe me inventarin e nevojshëm. Pajisja e ZZHKSA-së është bërë në kuadër të zbatimit të projektit: "Zhvillimi i kapaciteteve në arsimin fillor dhe atë të mesëm". Drejtori i DAK-ut, z. Guri, ka sqaruar se ky projekt është duke u zbatuar edhe në 4 komuna të tjera të Kosovës. Zyra e zhvillimit të kapaciteteve në sektorin e arsimit do të jetë në funksion të trajnimit të personelit arsimor të komunës, ndërsa është hapur në shkollën fillore "Qamil Ilazi" në Kaçanik të Vjetër, për shkak të hapësirës së lirë.

## Kryetari takoi zv.komandantin e GSHBQ-së

**4 nëntor** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, është takuar me kolonelin suedez Mats Strom, zëvendëskomandant i Grupit Shumëkombësh të Betejës - Qendra të KFOR-it, ndërsa nikoqiri dhe mysafiri e kanë vlerësuar të qetë dhe stabile gjendjen e sigurisë në Komunën e Kaçanikut. Z.Strom është njoftuar me sfidat me të cilat përballet Komuna e Kaçanikut, sikundër edhe me vizionin e kryetarit



Zharku për zhvillimin e saj në të gjitha rrafshet. Kryetari Zharku i ka thënë kolonelit Strom se zhvillimet e fundit në institucionet qendrore të vendit, të cilat rezultuan me shpalljen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare, nuk kanë pasur asnjë efekt negativ sa i përket funksionimit normal të pushtetit lokal. ”Ne duhet të mësohemi edhe me situata krizash. Ky është një test për Kosovën dhe do të kapërcehet me sukses”, ka nënvizuar z.Zharku.

## Përfaqësuesi i gjimnazit të Stromstadit vizitoi Kaçanikun

**4 nëntor –** Përfaqësuesi i gjimnazit të Stromstadit të Suedisë e ka vizituar Kaçanikun. Kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku, është takuar me z.Paul Karlson, përgjegjës për marrëdhënie me jashtë i gjimnazit të Stromstadit, i cili shoqërohej nga z.Elez Neziraj, profesor i këtij gjimnazi. Kryetari e ka falënderuar mysafirin për vizitën, ndërsa është shprehur i bindur se gjimnazi i Stromstadit do të vizitohet edhe nga përfaqësues të komunës sonë. Z.Zharku e ka njoftuar z.Karlson me sistemin e arsimit në vendin tonë. Mysafiri ia ka dhuruar kryetarit Zharku emblemën e qytetit Stromstad. Z.Karlson e ka vizituar edhe gjimnazin



”Skënderbeu” me ç’rast është miratuar iniciativa për bashkëpunim ndërmjet dy gjimnazeve. Për nder të mysafirit, në gjimnazin “Skënderbeu” është shfaqur edhe një program kulturor-artistik dhe është hapur një ekspozitë me punime nga arti figurativ. Drejtori i “Skënderbeu”, z.Ibush Vishi, ka thënë se bashkë më miqtë nga Suedia e kanë vizituar Zyrën suedeze në Prishtinë ku është diskutuar dhe është dhënë shpresë për realizim projektesh në dobi të gjimnazit të Kaçanikut.

## Nis asfaltimi i rrugës së Kotlinës



**10 nëntor** - Kanë nisur punët për shtrimin e asfaltit në trasenë e segmentit rrugor të gjatë 7.500 metra që e lidhë fshatin Kotlinë me magjistralen Prishtinë-Shkup. Kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku, dhe nëkryetari, z.Heset Loku, e kanë vizituar këtë rrugë për të parë nga afër zhvillimin e punimeve për asfaltimin e saj.

“Tashti banorët e Kotlinës do të qarkullojnë me lehtësi. Ne do të vazhdojmë të realizojmë projekte që krijojnë kushte më të mira për të gjithë qytetarët e komunës”, ka theksuar kryetari Zharku. Ai ka thënë të jetë i kënaqur me cilësinë e punëve të kryera deri tashti. Rruga është duke u asfaltuar në gjerësi prej 5 metrash dhe trashësi prej 8 centimetrash. Në të dyja anët e saj janë ndërtuar bankina me zhavorr dhe lëshesa të ujit në disa pozicione. Për realizimin e këtij projekti

Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit i ka dhënë 700 mijë euro, kurse Komuna e Kaçanikut 164.500 euro.

## Skanohen librat e gjendjes civile

**10 nëntor** - Ministria e Punëve të Brendshme ka nisur skanimin e të gjitha librave të gjendjes civile të Shërbimit të ofiqarisë të Komunës së Kaçanikut. Do të skanohen librat amë të të lindurve (LAL), librat amë të të martuarve (LAM) dhe librat amë të të vdekurve (LAV). Z.Jeton Topalli, drejtor i Drejtorisë të Administratës së Përgjithshme, ka theksuar se do të skanohen të gjitha librat e gjendjes civile që nga viti 1900 e deri tashti. Skanimi i librave të sipërpërmendura është duke u bërë në kuadër të projektit për e-qeverisje, ndërsa skanimi i tyre është edhe njëri nga kushtet e parashtruara nga Bashkimi Evropian për liberalizim vizash.




## Përurohet Zyra për zhvillimin e kapaciteteve në sektorin e arsimit

**12 nëntor** – GTZ-ja gjermane e ka bërë Komunën e Kaçanikut me Zyrë për zhvillimin e kapaciteteve në sektorin e arsimit (ZZHKSA). Ajo është hapur në SHF "Qamil Ilazi" të Kaçanikut të Vjetër, ndërsa përurimin e saj e kanë bërë z.Azem Guri, drejtor i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, znj.Myrvete Aziri (GTZ), z.Ejup Zariqi (MASHT) dhe z.Fadil



Krasniqi, drejtor i shkollës “Q.Ilazi”. Zyra është promovuar si pjesë e projektit: "Zhvillimi i kapaciteteve në arsimin fillor". Në ceremoninë përuruese është thënë se Deutsche Gesellschaft fur Technische Zusammenarbeit (GTZ), e ka hartuar një program trajnimi për personelin arsimor të Kaçanikut dhe të 4 komunave të tjera të Kosovës. "Trajnimi i ka tetë module të cilat përfshijnë aspekte lidhur me planet zhvillimore të shkollave, menaxhimin e projekteve, bashkëpunimin, personelin, delegimin, aftësimin, financat e prokurimin", ka sqaruar drejtori Guri. GTZ-ja e ka pajisur zyrën me laptopë, videoprojektor, printer etj. dhe inventar, ndërsa do t'i financojë edhe trajnimet. Modulin e parë të trajnimit e kanë ndjekur drejtorët e të gjitha shkollave në territorin e komunës.

## Ultimatumi i Komunës rihap rrugëhyrjen për në Kaçanik

**15 nëntor** – Është rihapur për qarkullim automjetesh rrugëhyrja për në qytetin Kaçanik, e bllokuar para gati një viti. Më 2 dhjetor 2009 ajo qe mbyllur për qarkullim automjetesh nga kompania e kontraktuar nga Bashkimi Evropian për përforcimin e urave mbi të cilat kalon segmenti Kaçanik-Han i Elezit i magjistrales Prishtinë-Shkup. Pas

konstatimit se aty po punohej me ritëm tepër të ngadalshëm, sivjet, në shtator, Komuna i pati dërguar ultimatum punëkryesit për përmbylljen e punimeve para dimrit. Z.Bekim Troni, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, ka theksuar se 15 nëntori ka qenë afati i fundit i vendosur nga Komuna e Kaçanikut për zhbllokimin e rrugës. "Ky afat qe pranuar edhe nga punëkryesi", ka rikujtuar ai. Punimet për riparimin e urës nën të cilën shtrihet rrugëhyrja për në Kaçanik është dashur të përfundojnë në mes të korrikut. Zhbllokimi i rrugës është kërkuar me ngulm edhe nga qytetarët, për shkak se aksi alternativ që është shfrytëzuar për hyrje në Kaçanik ka qenë krejtësisht joadekuat.

## Komuna aplikon në projektin IKDE të USAID-it

**15 nëntor** - Komuna e Kaçanikut ka aplikuar në programin për partneritet të USAID-it, saktësisht në projektin: “Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive-IKDE (Democratic Effective Municipalities Initiative-DEMI)”. Në emër të kryetarit të Komunës, z.Xhabir Zharku, letërzotimin për aplikim e ka nënshkruar z,Heset Loku, nënkryetar i Komunës. IKDE (DEMI) është projekt që u dedikohet komunave për promovim, zbatim dhe inkurajim të qeverisjes së mirë lokale. Objektiv i tij është ndihma komunave për ndërtimin e kapaciteteve komunale në funksion të ngritjes së aftësive për shërbime ndaj qytetarëve dhe zbatimit të decentralizimit në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Përforcimi i administratave komunale, fuqizimi i asambleve komunale, mbështetja për pjesëmarrjen e qytetarëve, përmirësimi i shërbimeve publike dhe promovimi i zhvillimit ekonomik lokal janë 5 komponentët e projektit. Komunat partnere do të përzgjidhen sipas kritereve të aprovuara nga USAID-i.

# Afaltohet segmenti i mbetur i aksit Bob-Doganaj

**22 nëntor** - Është asfaltuar segmenti i mbetur 200 metërsh i aksit Bob-Doganaj te ura mbi lumin Lepenc në fshatin Dubravë. Asfalti është shtuar në gjerësi prej 4 metrash dhe trashësi prej 7 centimetrash. Z.Rushan Ceka, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, ka thënë se asfaltimi i këtij segmenti është realizuar në kuadër të projektit: “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve”, ndërsa ka kushtuar rreth 10 mijë euro.



# Përurohet rruga e asfaltuar Dubravë-Sepetin

**24 nëntor** – Është përuruar rruga e asfaltuar Bubravë-Sepetin. Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku dhe z.Ramadan Vishi, baba i dëshmorit Bashkim Vishi, e kanë prerë shiritin përurues. “Ne jemi munduar dhe do të mundohemi që premtimet e dhëna t’i bëjmë realitet. Të gjitha rrugët nuk kryhen brenda një dite, por kjo është një nismë e mbarë që do ta vazhdojmë edhe më tutje për t’u dhënë të gjithë qytetarëve mundësi për lëvizje më të lirë”, ka theksuar z.Zharku në ceremoninë përuruese. Ai ka shtuar se të gjitha arritjet u atribuohen atyre që e derdhën gjakun për lirinë e këtij vendit. Ndërkaq, z. Zekirja Baftiu, administrator i fshatit Dubravë, e ka falënderuar kryetarin dhe udhëheqjen komunale për financimin e këtij projekti. Rruga e asfaltuar Dubravë - Sepetin është 2.304 metra e gjatë dhe 4–5 metra e gjerë, ndërsa asfalti dyshtresor është shtruar në trashësi prej 12 centimetrash (7 + 5). Për realizmin e këtij projekti Komuna i ka investuar 152.078 euro. Kryetari i ka vizituar edhe dy segmente të asfaltuara në lagjet “Baftiu” dhe “Vishaj”. Segmenti në lagjen “Baftiu” është 250 metra i gjatë dhe 5 metra i gjerë, ndërsa është realizuar në kuadër të projektit për asfaltimin e rrugës Dubravë – Sepetin. Segmenti i rrugës në lagjen “Vishaj” është i gjatë 240 metra dhe 3 metra i gjerë, ndërsa për asfaltimin e tij janë investuar 10.350 euro.



# Nis ndërtimi i shkollës në Vataj

**24 nëntor** – Kanë nisur punimet për ndërtimin e shkollës në fshatin Vataj. Kryetari i Komunës z. Xhabir Zharku, z.Ekrem Vishi, drejtor i SHF"Kadri Zeka", z.Mustafë Neziraj, arsimtar, dhe z.Zekirja Baftiu, vëlla i dëshmorit Avdulla Baftiu, e kanë bërë përurimin e nisjes së punimeve për ndërtimin e shkollës fillore 5-klasëshe. Kryetari Zharku u ka thënë të pranishmëve në ceremoninë përuruese se ndërtimi i kësaj shkolle ishte kërkesë e kamotshme e juaja, prandaj edhe po e realizojmë këtë projekt. "Ne nuk do të ndalemi vetëm më këtë projekt, por do të realizojmë edhe të tjerë në funksion të përmirësimit të kushteve të jetës së qytetarëve", ka shtuar z.Zharku. Objekti i shkollës fillore në fshatin Vataj do t'i ketë 5 dhoma mësimi, ndërsa është i tipit "P + 1", me bazë prej 300 metrash katrorë. Për realizimin e këtij projekti Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal i ka alokuar 100 mijë euro, ndërsa Komuna e Kaçanikut 30.561 euro.



# Kryetari shtron drekë pune për mësimdhënësit kaçanikas

**24 nëntor** - Kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku, ka shtruar drekë pune për mësimdhënësit e Komunës së Kaçanikut, ndërsa i pranishëm ishte edhe z.Enver Hoxhaj, ministër i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. "Komuna e Kaçanikut vitin shkollor 2010/2011 e ka shpallur vit të cilësisë në arsim, prandaj përkushtimi ynë është shtuar në këtë drejtim”, ka theksuar kryetari Zharku. Ai e ka falënderuar kryeministrin Hashim Thaçi dhe ministrin Hoxhaj për realizimin e premtimeve të dhëna më herët për avancimin e arsimit në Komunën e Kaçanikut.




“Besojmë se edhe në të ardhmen do ta kemi mbështetjen e institucioneve shtetërore për zhvillimin e arsimit në komunën tonë”, ka thënë z.Zharku. Ndërkaq, ministri Hoxhaj i ka falënderuar mësimdhënësit kaçanikas për punën e madhe të tyre. "Nuk ka profesion më të shenjtë se profesioni i mësimdhënësit. Nëse ka shtresë e cila në zemër, mendje dhe shpirt e ka bartur idenë e

Republikës së Kosovës, atëherë ata janë mësimdhënësit, nxënësit, studentët, akademikët", ka nënvizuar ministri Hoxhaj. "Misioni i mësimdhënësit në Kosovë ka qenë iluminist, liridashës dhe çlirimtar. Edhe në kohën kur Republika e Kosovës ka qenë vetëm ide, ju keni qenë ata që keni bërë përpjekje që në kushte shumë të rënda atë ta bëni realitet. Ky mision juaji, ne, si Qeveri e Kosovës. na obligon që të mendojmë jo vetëm se kush jeni ju sot, por edhe kush ishit në të kaluarën. Në asnjë rrethanë ne nuk do ta harrojmë kontributin tuaj për shtetin dhe lirinë e Kosovës që po e gëzojmë çdo ditë", ka thënë ministri Hoxhaj. Ai ka nënvizuar se gjatë 3 vjetëve të qeverisjes sonë kemi bë përpjekje maksimale për ndërtimin e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, duke i rritur hapësirat shkollore, pastaj duke i eliminuar tri-katër ndërresat nëpër shkolla, duke i siguruar tekstet falas, me qëllim që çdo nxënës i Republikës së Kosovës të jetë i përfshirë dhe i barabartë në sistemin arsimor. Z.Hoxhaj ua komunikoi të pranishmëve vendimin e kryeministrit Thaçi për rritjen 50 për qind të pagave të mësimdhënësve të cikleve parauniversitare nga 1 janari 2011.

## Përurohet rruga e asfaltuar e Biçecit

**25 nëntor** - Është përuruar rruga e asfaltuar në fshatin Biçec. Shiritin e kanë prerë nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku, përfaqësuesi i "Caritasit" të Luksemburgut, z.Rifat Krasniqi dhe z.Shabi Dullovi, administrator i Biçecit. "Realizimi i këtyre projekteve është dëshmi e bashkëpunimit të shkëlqyer mes komunitetit të Biçecit, Komunës dhe organizatave humanitare", ka theksuar z.Loku në ceremoninë përuruese. Ai u ka thënë të pranishmëve se Komuna edhe në të ardhmen do të alokojë mjete për projektet që do të realizohen bashkë me donatorë qeveritarë dhe joqeveritarë. Ndërkaq, z.Kjani Sallahu, kryetar i Këshillit të zhvillimit të komunitetit të Biçecit, ka theksuar se vitin e kaluar nisëm realizimin e disa projekteve të nevojshme e të domosdoshme për komunitetin e fshatit Biçec, me ç'rast qenë

investuar rreth 200 mijë euro. "Realizimi i projekteve ka vazhduar me efikasitet dhe përkushtim të lartë edhe sivjet, ndërsa deri tani janë realizuar projekte në vlerë rreth 90 mijë euro", ka nënvizuar ai. Për mbështetjen e projekteve të realizuara, z.Sallahu e ka falënderuar "Caritasin" e Luksemburgut, Qeverinë dhe popullin e këtij shteti mik, institucionet komunale në krye me kryetarin e Komunës, z. Xhabir Zharku, dhe KFOR-in. Folësi i radhës, përfaqësuesi i "Caritasit" të Luksemburgut, z. Rifat Krasniqi, e ka falënderuar Këshillin e zhvillimit të komunitetit të Biçecit për bashkëpunim, ndërsa e ka cilësuar si më të mirin nga të gjithë këshillat ku vepron "Caritasi". Ai është zotuar se



do të mbështes edhe projekte tjera në interes të komunitetit. Rruga e asfaltuar është e gjatë 622 metra, ndërsa e gjerë 5 metra. Asfalti është shtruar në trashësi prej 8 centimetrash. Për realizimin e këtij projekti Komuna i ka investuar 40 mijë euro, kurse "Caritasi" i Luksemburgut 7.957 euro. Janë përuruar edhe kompleksi sportiv, i cili përfshinë fushën e basketbollit dhe atë të volejbollit, investim i "Caritasit" të Luksemburgut në shumë prej 10 mijë euro, pastaj një pjesë e rrethojave të oborrit të shkollës, ndërtimi i të cilave ka kushtuar 4 mijë

euro, dhe Zyra joformale e fshatit Biçec që do të shfrytëzohet për takimet e KZHK-së, kryesisë së fshatit dhe të gjitha strukturave të organizuara të këtij lokaliteti.

## Kryetari ua uron qytetarëve festat e nëntorit

**26 nëntor** – "Qytetarë të nderuar,
Ju shpreh urimet e mia më të sinqerta, Ju dhe familjeve tuaja, me rastin e festave të nëntorit, 28 Nëntorit – Ditës së Flamurit Kombëtar, Ditëlindjes së komandantit legjendar Adem Jashari dhe Paraqitjes publike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në këtë ditë të shënuar, me pietet përkulemi për të gjithë ata të cilët luftuan dhe flijuan veten e tyre për lirinë dhe pavarësinë e atdheut. Ky është përvjetori i tretë që festat e nëntorit po i kremtojmë në Kosovën e pavarur, ideal për të cilin luftuan shumë breza të shqiptarëve, ndërsa u finalizua me luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
Përzemërsisht ju uroj shëndet, mirëqenie, paqe dhe harmoni."

Kryetari i Komunës,
Xhabir Zharku

## Shënohen festat e nëntorit

**27 nëntor** – Aktivitetet e shumta për shënimin e festave të nëntorit kanë nisur me vënie lulesh te Memoriali i Dëshmorëve dhe parakalim të fëmijëve e të rinjve në bulevardin "Ismail Raka". Aktivitetet shënuese i ka organizuar Komuna e Kaçanikut, ndërsa janë mbajtur nën patronazhin e kryetarit, z.Xhabir Zharku. Aktiviteti kryesor për shënimin e 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit, Ditëlindjes së komandantit legjendar Adem Jashari dhe Paraqitjes publike të UÇK-së, është mbajtur në pallatin e kulturës "Xheladin Kurtaj". "Sot po e shënojmë

një datë sa të dhimbshme, po aq edhe krenare. Kaçaniku në veçanti ndjehet krenar sot, sepse në këtë datë janë bërë shumë beteja. Më 28 nëntor ra dëshmori ynë Ismail Raka, për të cilin kemi kujtimet më të mira dhe krenohemi me trimërinë e tij. Më 28 nëntor u shfaq UÇK-ja, ajo që solli një rreze drite me shpresë se Kosova më në fund do të çlirohet, gjë që edhe ndodhi", ka theksuar kryetari Zharku. Ai në vijim tha se kjo datë për të gjithë shqiptarët simbolizon bashkimin e tokave shqiptare. "Më 17 shkurt 2008 e shpallëm Kosovën shtet të pavarur dhe sovran, me shpresë që një ditë Kosova, patjetër dhe padyshim, do të jetë Shqipëri, ashtu siç e ëndërruan dëshmorët nëpër breza", tha kryetari Zharku. Ndërkaq, Muharrem Ahmetaj, drejtor i Pallatit të Kulturës, në rrafsh kronologjik ka përmendur *ngjarjet* historike që rezultuan me shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë, më 28 nëntor 1912, dhe pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008. Për nder të festave të nëntorit janë zhvilluar edhe aktivitete të tjera kulturore e sportive.




## Në Ditën e Flamurit homazhe para përmendoreve të dëshmorëve e heronjve

**28 nëntor** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, dhe bashkëpunëtorët e tij, bashkë me përfaqësues të OVL-së së UÇK-së, për nder të 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit, Ditëlindjes së komandantit legjendar Adem Jashari dhe Daljes publike të UÇK-së, kanë vendosur kurora lulesh dhe

flamuj kombëtar te lapidarët e dy komandantëve, Agim Bajrami dhe Qamil Ilazi, sikundër edhe te bustet e dëshmorit Ismail Raka dhe heroit të kombit Idriz Seferi. Homazhe kanë bërë edhe te Varrezat e Dëshmorëve. Kryetari Zharku dhe shoqëruesit e tij fillimisht kanë vënë kurora lulesh te lapidari i komandantit Agim Bajrami, i ngritur në vendin e rënies së tij, në fshatin Gabrricë. Agimi ra heroikisht në përballje me forcat pushtuese serbe, më 10 gusht 1998, bashkë me dy bashkëluftëtarët e tij, Xheladin Kurtaj e Besnik Begunca. Në shenjë nderimi për heroizmin e tij, Brigada 162 e UÇK-së u emërtua “Agim Bajrami”. Për të nderuar veprën heroike të komandantit Agim Bajrami, ushtruesi i detyrës së presidentit të Kosovës, z. Jakup Krasniqi, në prag të 28 Nëntorit, atë e dekoroi me medaljen “Adem Jashari”.



*DHJETOR 2010*

## Përurohet objekti i riparuar i Shtëpisë së Kulturës në Glloboçicë

**1 dhjetor** – Është përuruar objekti i riparuar i shtëpisë së kulturës "Arif Kapetani" në fshatin Glloboçicë. Shiritin përurues e kanë prerë nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku dhe administratori i Glloboçicës, z. Zimer Luma. Ndërkaq, kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, i ka përgëzuar glloboçicasit për objektin e riparuar. "Ne e përuruam këtë objekt, ndërsa projekti i ujësjellësit është në fazën finale. Ne nuk do të ndalemi së realizuari edhe projekte të tjera në lokalitetin tuaj në funksion të krijimit të kushteve për një jetë më të mirë", u ka thënë kryetari Zharku të pranishmëve. Ai ka theksuar se nga sot Shtëpia e Kulturës në Glloboçicë do të mbajë emrin e heroit nacionalist të Ballit Kombëtar, Arif Kapetani. "Emri i Arif Kapetanit do të jetë mesazh edhe për brezat e ardhshëm se si luftoi populli ynë për liri", ka thënë kryetari Zharku. Riparimi i shtëpisë së kulturës "Arif Kapetani" është bërë me 18.923 euro të buxhetit komunal.



## Nisin punimet për lapidarin e Arif Dragomacit

**1 dhjetor** – Në fshatin Glloboçicë kanë nisur punimet për ngritjen e lapidarit që i kushtohet Arif Dragomacit – Kapetanit. Përurimin e nisjes së punimeve e kanë bërë kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku dhe

z.Isen Dragomaci, biri i Arif Dragomacit-Kapetanit, hero nacionalist i Ballit Kombëtar. Në ceremoninë e organizuar, kryetari Zharku ka thënë se sot i vumë themelet e lapidarit të dëshmorit Arif Kapetani, nacionalistit të Ballit Kombëtar, i cili luftoi për çlirimin e tokave shqiptare nga komunistët jugosllavë, luftoi për një Shqipëri. Ndërkaq, biri i heroit Dragomaci, Iseni, i ka falënderuar të pranishmit dhe e ka përshëndetur iniciativën për ngritjen e lapidarit. “Trimat nuk vdesin atëherë kur varrosen, por atëherë kur harrohen”, ka theksuar ai.. Arif Dragomaci – Kapetani ka lindur në vitin 1900 në lagjen “Dragomac” të Glloboçicës, ndërsa është vrarë nga komunistët jugosllavë në Zhelinë të Tetovës, më 1948.



## Komuna e Kaçanikut e para në Kosovë për shërbime administrative

**2 dhjetor** – Komuna e Kaçanikut është e para në Kosovë sa i përket shërbimeve administrative. Kështu thuhet në raportin “Vlerësimi i performansës së komunave…”, i hartuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Komuna e Kaçanikut është renditur e para për shërbimet administrative, për numrin e lëndëve, kërkesave

administrative dhe ankesave të pranuara, me gjithsej 35.394 lëndë të shqyrtuara brenda afatit të paraparë ligjor. Pas Kaçanikut renditen Prishtina, Vushtrria… Z.Jeton Topalli, drejtor i Drejtorisë të Administratës së Përgjithshme, ka thënë se MAP-li në bashkëpunim me USAID-in, nëpërmjet projektit “Iniciativa për Komuna Efektive (IKE - EMI)”, ka krijuar një sistem të menaxhimit të performansës. “Ky është një sistem i qëndrueshëm për matje, vlerësim dhe monitorim të performansave të komunave, por edhe ndikues sa i përket përmirësimit të performansës dhe rritjes të cilësisë së shërbimeve komunale”, ka theksuar drejtori Topalli. Hartimi i raportit “Menaxhimi i performansës komunale dhe krijimi i sistemit për menaxhimin e performansës komunale” është në funksion të përcjelljes së saktë të shërbimeve ndaj qytetarëve nga komunat.

## Trotuaret dhe shëtitoret e Kaçanikut bëhen me pjerrina

**2 dhjetor** – Trotuaret e rrugëve dhe shëtitoret e qytetit Kaçanik janë bërë me pjerrina. Në vigjilje të 3 Dhjetorit , Ditës ndërkombëtare të personave me aftësi të Kufizuara, në një ceremoni të organizuar nga Komuna e Kaçanikut dhe “Handakosi”, është bërë përurimi i pjerrinave për personat



me aftësi të kufizuara në rrugën "Ismail Raka". Shiritin përurues e kanë prerë znj. Xhemile Murseli, koordinatore e "Handakos"-it për rajonin e Ferizajt dhe z. Misim Sopa, drejtor Drejtorisë së Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale. Drejtori Sopa, duke folur edhe në emër të kryetarit të Komunës, z.Xhabir Zharku, ka theksuar se ky projekt I finalizuar do t'u mundësojë lëvizje më të lehtë personave me aftësi të kufizuara nëpër rrugët e qytetit. "Komuna do ta mbështes këtë kategori të shoqërisë edhe në të ardhmen", ka nënvizuar drejtori Sopa. Ndërkaq, znj. Lumturie Koka, koordinatore e "Handakos"-it në Kaçanik, e ka falënderuar Komunën për këtë investim që u dedikohet ekskluzivisht personave me aftësi të kufizuara. Pjerrina janë ndërtuar në rrugët e qytetit dhe në hyrje të objektit të Komunës. Ky projekt është realizuar me 7.036 euro të buxhetit komunal.

## Komuna ndihmon familjet në nevojë me dru për ngrohje

**7 dhjetor** - Ekzekutivi i Komunës e ka miratuar propozimin e Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për të ndihmuar një numër familjesh në nevojë me dru për ngrohje. Tridhjetë familje do të ndihmohen me nga 3 kubikë dru zjarri. Drutë që do t'u dhurohen familjeve të përzgjedhura u janë konfiskuar prerësve pa leje në pyjet publike. Përfituese të kësaj ndihme janë familje dëshmorësh, invalidësh të luftës dhe aso skamnore.

# CHF-ja dhe Komuna përcaktohen për dizajnin e shkollës në Nikaj

**14 dhjetor** - CHF-ja dhe Komuna janë përcaktuar për dizajnin e shkollës në fshatin Nikaj. Përzgjedhjen e njërit nga 4 dizajnet e propozuara nga CHF-ja e kanë bërë znj. Vlora Rizvanolli-Ahmeti, arkitekte, zyrtare e CHF-së për komunikim me komuna, z.Azem Guri, drejtor i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës dhe z.Bekim Troni, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Në përzgjedhjen e variantit të dizajnit kanë prezantuar edhe z.Dukagjin Dyla, zyrtar i CHF-së, z.Xhevat Guri, përgjegjës i shkollës dhe z.Fadil Guri, përfaqësues I Këshilli i prindërve të shkollës në Nikaj..Sipas variantit të përzgjedhur, shkollës do t'i shtohen edhe 3 dhoma mësimi, toaletet dhe ngrohja qendrore. Për realizimin e këtij projekti organizata CHF International do t'i investojë 80 mijë euro, ndërsa Komuna e Kaçanikut 60 mijë euro. Shkolla do të ndërtohet më 2011. Më herët është nënshkruar memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Komunës së Kaçanikut dhe CHF-së në të cilin thuhet se kjo organizatë do të ndihmojë në ofrimin e investimeve në arsim përmes programit:"Infrastruktura e vogël për arsimin në Kosovë", që financohet nga USAID-i.



# LOGOS-i lavdëron Komunën e Kaçanikut për bashkëpunim korrekt

**16 dhjetor** - Zyrtarë të LOGOS-it e kanë lavdëruar Komunën e Kaçanikut për bashkëpunim korrekt. Lëvdatat për azhuritet, saktësi dhe korrektësi i ka artikuluar z.Norbert Pijls, koordinator i projektit të LOGOS-it, pas vizitës që i është bërë trotuareve të ndërtuara në rrugën "Vëllezërit Çaka". "Komuna e Kaçanikut është më e mira në mesin e komunave ku vepron LOGOS-i", ka theksuar z.Pijls. Ai dhe z.Samuel Waelty, përfaqësues i Zyrës zvicerane për bashkëpunim në Kosovë, janë takuar edhe me kryetarin e Komunës, z.Xhabir Zharku. Kryetari Zharku i ka falënderuar miqtë nga Zvicra për realizimin e këtij projekti, ndërsa e ka vlerësuar orientimin e donacioneve të LOGOS-it në komunat e vogla. Ndërkaq, z.Waelty ka pohuar se Komuna e Kaçanikut është përfshirë edhe në fazën e dytë të projekteve. Ai ka nënvizuar se në fazën e dytë do të mbështetet financiarisht projekti: "Hartimi i



planit rregullativ të qytetit Kaçanik”. Projekti: “Ndërtimi i trotuareve në rrugën ‘Vëllezërit Çaka’ në Kaçanik” është bashkëfinancuar nga LOGOS-i dhe Komuna e Kaçanikut. Për realizimin e tij, LOGOS-i i ka investuar 9 mijë euro, ndërsa Komuna 956 euro. Programi “Zvicër-Kosovë - Përkrahja për qeverisje lokale dhe decentralizim - LOGOS”, financohet nga Qeveria zvicerane nëpërmjet Zyrës zvicerane për bashkëpunim në Kosovë (SCO), ndërsa zbatohet nga fondacioni zviceran “Intercooperation”.

## LOGOS-i dhe Komuna e bëjnë Kaçanikun me plan rregullativ urbanistik

**19 dhjetor** – Më 2011, Qeveria zvicerane do ta bëjë qytetin Kaçanik me plan rregullativ urbanistik. "Ky projekt do të realizohet me mjete të programit 'Zvicër-Kosovë - Përkrahja e qeverisjes lokale dhe e decentralizimit - LOGOS', që financohet nga Qeveria zvicerane", ka theksuar z.Hajrush Dullovi, zëdhënës i Komunës. Ai ka pohuar se edhe Komuna e Kaçanikut do të participojë me një shumë mjetesh për realizimin e projektit. Ndërkaq, z.Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, ka thënë se LOGOS-i i ka lejuar 50 mijë euro për hartimin e Planit rregullativ të Kaçanikut, ndërsa Komuna 20 mijë euro.

# USAID-i e përzgjedh për partnere Komunën e Kaçanikut



**21 dhjetor** – USAID-i e ka përzgjedhur për partnere Komunën e Kaçanikut. Znj. Danielle Spinard, shefe e Zyrës së USAID-it të programit "Iniciativa për komuna demokratike dhe efektive (DEMI)", e ka njoftuar kryetarin e Komunës, z. Xhabir Zharku, se Komuna e Kaçanikut është përfshirë në mesin e 15 komunave të Kosovës partnere të USAID-it. Sipas saj, do të përfitojnë edhe 10 komuna me shumicë serbe të përzgjedhura sipas Planit Ahtsaari. Ndërkaq, z.Bujar Hoxha, zëvendësdrejtor i kompanisë "Urban Institut", e kontraktuar nga USAID-i, ka thënë se fillimisht do të përzgjidhet ekipi vlerësues me ekspertë vendës e ndërkombëtarë për identifikimin e nevojave të komunës, ndërsa në vijim do të hartohet Plani veprues aksional. Kryetari Zharku e ka falënderuar USAID-in për përfshirjen e Komunës së Kaçanikut në programin DEMI. "Ne vazhdimisht po mundohemi të promovojmë një qeverisje të mirë. Qeverisja e mirë e rritë besimin te qytetarët dhe ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e shërbimeve lokale dhe zhvillimin ekonomik", ka theksuar z. Zharku.

Programi për partneritet "Iniciativa për komuna demokratike dhe efektive (IKDE) / Democratic Effective Municipalities Initiative (DEMI)" i USAID-it u dedikohet komunave, ndërsa është në funksion të promovimit, zbatimit dhe inkurajimit të qeverisjes së mirë lokale.

Programi synon të ndihmojë në ndërtimin e kapaciteteve komunale në mënyrë që të ngritet aftësia për shërbime cilësore ndaj qytetarëve. Programi është i përbërë nga 5 komponente kryesore: fuqizimi i administratës komunale, fuqizimi i kuvendeve komunale, mbështetja e pjesëmarrjes së qytetarëve në organet vendimmarrëse, përmirësimi i shërbimeve publike dhe promovimi i zhvillimit ekonomik lokal. USAID-i ofron dy lloje grantesh nëpërmjet Fondit stimulues për 38 komunat e Kosovës dhe Fondi mbështetës për komunat partnere. “Iniciativa për komuna demokratike dhe efektive” është program 3-vjeçar, i dizajnuar t’i mbështesë komunat e Kosovës, ndërsa zbatohet nga “Urban Institut”.

## Legjislativi miratoi Planin zhvillimor komunal

**28 dhjetor** – Me vetëm 1 abstenim legjislativi e ka miratuar Planin zhvillimor komunal (PZHK), i hartuar për periudhën 2010-2020. Aspekte të këtij plani ka shpalosur z.Tomor Çela, përfaqësues i firmës “Data Gis-Consulting”, e kontraktuar nga Komuna për hartimin e planeve zhvillimore komunale. Ndërkaq, z.Bekim Troni, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, ka thënë se drafti final i PZHK-së e ka marrë pëlqimin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësino



r për miratim nga KK i Kaçanikut. Më herët KK-ja e ka miratuar edhe Planin zhvillimor urban (PZHU). Këshilltarët e pranishëm në seancë e kanë miratuar edhe statutin e ri të qendrës kryesore të mjekësisë familjare "Dëshmoret e Lirisë", sikundër edhe propozimin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së tarifave dhe ngarkesave dhe propozimvendimin për lejimin e mjeteve financiare për kompensimin e shujtave për 212 shërbyes civilë. Në fund të mbledhjes, kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, i ka falënderuar anëtarët e Kuvendit të Komunës për bashkëpunim gjatë vitit 2010. "Ishte një vit i suksesshëm" ka thënë kryetari Zharku. Ai ka uruar që 2011-a të jetë vit edhe më i suksesshëm, ndërsa ka kërkuar nga anëtarët e KK-së bashkëpunim edhe më të madh për të mirën e të gjithë qytetarëve të komunës sonë.

## Kryetari uron qytetarët me rastin e Vitit të Ri 2011

Bashkëqytetarë,
Në këto çaste të ndërrimit të moteve, në emër të Komunës së Kaçanikut iu shpreh urimet më të sinqerta për shëndet, lumturi dhe suksese edhe në vitin 2011.
Besoj që bashkë do ti kapërcejmë edhe sfidat që na presin ne, si komunë, dhe ju, si qytetarë.

Gëzuar 2011 !

Kaçanik, 31.12.2010

Xhabir Zharku
Kryetar i Komunës

*DOKUMENTE 2010*

22 **KULTURA**

# "Shota", do ta kall Kaçanikun

Në shënimin e dy vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, ansambli "Shota", ka përzgjedhë komunën e Kaçanikut për të prezantuar koncertin festiv



shqiptare. /A.Paçarizi/

# Përkujtohet veprimtari Baki Dullovi



**Kaçanik, 17 shkurt**

**Në dyvjetorin e e vdekjes së Baki Dullovit, veprimtar i shquar i çështjes kombëtare, të martën, në fshatin Biçec, është mbajtur një tubim përkujtimor. Kjani Sallahu, kryetar i Këshillit Organizues të tubimit përkujtimor, ka thënë se qysh në vitet e rinisë, Baki Dullovi nuk ishte pajtuar me represionin serb. "Torturat që i bëheshin**

**itetit dhe luftës për të drejtat e shqiptarëve. Baki Dullovi që atëherë iu bashkua Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare, e cila angazhohej për të drejtat dhe bashkimin e të gjithë shqiptarëve", ka thënë Sallahu duke shtuar se me daljen në skenë të UÇK-së, Dullovit së bashku me djemtë e tij u bë pjesë e pandashme e saj. Ndërkaq, kryetari i Komunës së Kaçanikut, Xhabir Zharku, tha se Lëvizja Nacional Demokra-**

18 **INTERVISTA**

# Mandati i ri, mundësi për përmbushjen e agjendës

Do të vazhdojmë me investime në infrastrukturën rrugore, kanalizime, shkolla, etj. të sjellim investitorë nga vendet e rajonit, në mënyrë që të krijojmë vende të reja p... munës së Kaçanikut, Xhabir Zharku

Kjani Sallahu

**Zëri: Z. kryetar, çfarë keni ndryshuar në qeverisjen e kaluar nga ajo që e keni trashëguar?**

**Zharku:** Me ardhjen time në mandatin e kaluar dyvjeçar kam ndryshuar qasjen dhe metodën e punës dhe kam krijuar disiplinë tek stafi i administratës komunale, ndërsa këto ndryshime kanë reflektuar dukshëm edhe në trajtimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Ndryshe nga mandatet paraprendëse, gjatë të cilave nuk ka pasur kryetar komune, por vetëm kryeshef ekzekutiv, posti dhe kompetencat e kryetarit të komunës gjatë mandatit tim kanë mundësuar zbatimin e formave të veprimit që i përmenda më lart.

**Zëri: Me cilat të arritura duhet të krenoheni, e çfarë ju bën të ndiheni keq për mandatin që e latë pas?**

**Zharku:** Ndër të tjera, vlerësoj shërbimet ekspeditive në pajisjen me dokumente personale dhe të udhëtimit të qytetarëve, sidomos në periudhën e pushimeve verore të mërgimtarëve. Si rezultat i përkushtimit tim dhe stafit komunal, por edhe vetëdijesimit të qytetarëve dhe seriozitetit të tyre për kryerjen e obligimeve financiare ndaj Komunës, kemi realizuar për shkak të kufizimeve buxhetore nuk kemi arritur të bëjmë më shumë është i natyrshëm kudo në Kosovë, e edhe në komunën të cilën unë e udhëheq.

**Zëri: Mandatin e kaluar e ka përshkuar edhe arrestimi juaj për akuza tashmë të njohura për opinionin. Sa ka qenë e vështirë për ju që në të njëjtën kohë të menaxhoni me komunën dhe të përballeni me organet e drejtësisë?**

**Zharku:** Akuzat të cilat janë ngritur ndaj meje janë fabrikim i shërbimeve sekrete serbe, të cilat për mua dhe opinionin në Kosovë janë të njohura. Gjatë kohës së zgjedhjeve të vitit 2007 janë gjetur individë të caktuar të cilët me prapavijë politike dhe qëllime komprometuese kanë hedhur akuza kundër meje dhe PDK-së. Natyrisht se këto akuza më kanë penguar në ushtrimin e detyrës sime, por edhe kanë shkaktuar shqetësime tek qytetarët e komunës së Kaçanikut. Duke e ditur adresën e këtyre akuzave dhe qëllimin e tyre, i jam përgjigjur drejtësisë, edhe atëherë kur ajo është e brishtë dhe nën nivelin e kompetencave të saj. Fakti se me verdiktin e votës së lirë qytetarët kanë vlerësuar se unë duhet t'u prijë atyre edhe për katër vjetët e ardhshëm,



Edhe kontributi i opozitës dhe i qytetarëve do të mirëpriten: Xhabir Z...

**kryesore të qeverisjes katërvjeçare "Zharku 2" dhe a do të përmbushet oferta juaj me më shumë se 1.2 milionë euro të planifikuara me buxhet për investime kapitale gjatë këtij viti?**

**Zharku:** Besoj që këtë mandat 4-vjeçar prioritet i parë sërish do të mbetet përkushtimi që të punojmë si ekip, në mënyrë që qytetarëve t'u mundësojmë një qasje të re për një jetë më të mirë. Do të vazhdo-

Komunës do të përpiqemi që ... mënyrë racionale t'i ndajmë ... banesa për familje të dëshmorë... të cilat nuk kanë strehim të sigur... ar, por edhe për familjet eventua... që kanë nevojë emergjente për b... nim. Jam i vetëdijshëm se kjo n... mund t'i përmbushë kërkesat e ... gjithë qytetarëve që kanë nevoj... për strehim, por me përpjekje p... alternativa të reja brenda mund...

e premte • 19 shkurt 2010 — Kosovë

### Kaçaniku me vetëm një specialist sëmundjesh të fëmijëve

# Mjekëve kaçanikas u pamundësohet specializimi për pediatrinë

EKREM RAKA

KAÇANIK, 18 SHKURT - Ndonëse Kaçaniku e ka vetëm një mjek specialist sëmundjesh të fëmijëve, Ministria e Shëndetësisë ua ka mbyllur dyert e aplikimit mjekëve kaçanikas të interesuar për të specializuar në pediatri. Sinan Zeneli, mjek në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Kaçanik, i ka thënë KD-së të mos i jetë plotësuar dëshira për të specializuar pediatrinë. "Kam qenë shumë i interesuar të aplikojë për specializim në pediatri, mirëpo në Ministrinë e Shëndetësisë më kanë thënë se ky profil nuk është paraparë për mjekët nga Komuna e Kaçanikut", ka theksuar Zeneli. Ai ka deklaruar të jetë befasuar me këtë vendim të MSH-së sidomos kur kihet parasysh fakti se Kaçaniku e ka vetëm një pediatër. "Edhe ky pediatër nuk punon në QKMF", ka shtuar ai. Se mjekëve kaçanikas të punësuar në sektorin publik të shëndetësisë u është pamundësuar aplikimi për specializim në pediatri e ka pohuar edhe Misim Sopa, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ndërsa Komunën e ka përjashtuar nga ky mëkat. "MSH-së ia kemi dërguar nevojat tona për specialistë të 7 profileve mjekësore, ndërsa kjo ministri i ka miratuar vetëm 4 sosh", ka theksuar ai. Drejtori Sopa ka thënë se nga MSH-ja është kërkuar që mjekëve kaçanikas t'u mundësohet aplikimi për specializim në profilet: mjekësi familjare (2), biokimi klinike (1), radiologji (1), gjinekologji (1), pediatri (1), psikiatri (1) dhe stomatologji preventive (1). Ai ia ka treguar KD-së shkresën zyrtare të MSH-së nëpërmjet së cilës autoritetet komunale njoftoheshin se mjekëve nga Kaçaniku u është lejuar



aplikimi për specializim vetëm në drejtimet: mjekësi familjare (2), biokimi klinike (1), gjinekologji (1) dhe radiologji (1). "Personalisht kam qenë shumë i interesuar që në këtë listë të figurojnë edhe pediatria e psikiatria, mirëpo kjo nuk ka ndodhur", është shprehur Sopa. Ai ka sqaruar se vendimin lidhur me drejtimet e lejuara për specializim i merr MSH-ja, ndërsa nga komunat kërkohet vetëm që t'i adresojnë nevojat në këtë rrafsh.

Sali Salliteku: Akuzat e LDK-së, të paqëndrueshme

cila është 8.5%. Lidhur me punën e Kuvendit Komunal për punën mesatares së Kosovës, e cila është 33.1 %, ndërsa plotësisht pajtohen jo aq të kënaqur dhe 23.3% shumë të kënaqurve.

# Zharku kërkon të ndërpriten ndërtimet pa leje

Kaçanik, 6 prill

Daut Shehu

**Kryetari i komunës së Kaçanikut, Xhabir Zharku, ka kërkuar ndërprerjen e ndërtimeve pa leje dhe eksploatimin e rërës si dhe largimin e tërësisht të shitësve ambulantë nga rruga**

Kryetari i komunës së Kaçanikut, Xhabir Zharku, ka kërkuar nga drejtorët në mbledhjen e ekzekutivit, të mbajtur të martën, një mobilizim më të shtuar, bënë të ditur zyra për informim e kësaj komune. Sipas Hajrush Dullovit, zëdhënës i kësaj zyre, Zharku ka kërkuar nga drejtoria e Urbanizmit që pronarët të bëjnë bartjen dhe t'i regjistrojnë në emër të tyre pronat dhe shtëpitë e tyre. "Për këtë qëllim, Zharku ka urdhëruar sektorin e pronësisë të hartojë një projekt për të sensibilizuar pronarët. Ndërkaq, nga inspektorët komunal ka kërkuar angazhim maksimal për të larguar tërësisht shitësit ambulant nga rruga, pastaj të ndërpresin ndërtimet pa leje, si dhe eksploatimin ilegal të rërës", ka theksuar Dullovi.

Nuhi Provoliu, drejtor i Bujqësisë e ka informuar ekzekutivin se nga 12-30 mars, në zyrën regjionale në Gjilan kanë aplikuar 90 fermerë kaçanikas që posedojnë 5 e më shumë lopë qumështore për grante që i dhuron Ministria e Bujqësisë për subvencionimin e fermerëve. Sipas Dullovit, Nuhi Provoliu ka nënvizuar në këtë mbledhje se gjatë fundjavës që shkoi, gjatë një aksion të organizuar, janë eliminuar 182 qen endacak, ndërsa aksioni do të vazhdojë edhe fundjavën që vjen.



Xhabir Zharku, kryetar i komunës së Kaçanikut

# Shekullori rikthehet në Grykë të Kaçanikut

**Portreti i heroit kombëtar, Idriz Seferi, i skalitur në bust është vendosur dhe do të z Kaçanik. Për nder të 100-vjetorit të Betejës së Kaçanikut do të mbahet edhe një s një akademi solemne dhe do të hapet një ekspozitë me fotografi**

Kjani Sallahu



Heroi kombëtar dhe drejtuesi i Betejës në Grykë të Kaçanikut, Idriz Seferi, të premten do të "rizbres", në qytetin të cilin e mbrojti me bashkëluftëtar pikërisht para një shekulli, në luftën kundër ushtrisë osmane. Por, ndryshe nga para një shekulli, kësaj radhe heroi, me emrin e të cilit identifikohet Kaçaniku, Kosova dhe mbarë kombi, do t'i mbetet besnik qytetit me grykën e njohur në dalje të tij. Portreti i luftëtarit të përmasave jo vetëm kombëtare, Idriz Seferi, është skalitur në bust të derdhur në bronz dhe do të qëndrojë përherë në Kaçanik. Komuna e Kaçanikut, për nder të 100-vjetorit të fillimit të Betejës së udhëhequr nga Idriz Seferi në Grykë të Kaçanikut ka organi-

**Kaçaniku harton draftin e rregullores së re të tarifave dhe ngarkesave komunale**

# Fatura "më të rënda" për disa lloje biznesesh



*Ekrem Raka*

Kaçanik, 17 maj - Sivjet, pronarët

nga 150 euro në 500, për ndërmarrjet industriale (fabrikat) nga

Agjencia Kadastrale e Kosovës, ndërsa do të mbeten pothuajse të

# Par ethe Mal

Malisheve, 17 ma ethe hemorragjike është konfirmua Infektive të Prishtinë, ndërsa edhe për një ra Rahaveci. "Po siv janë konfirmuar 2 hemorragjike, njër nga Malisheva nc Rahaveci", ka th infektologu dr. Sa Klinika Infektive. jeguar se rasti i është i gjinisë fem liruar nga klinika sideruar se e ka ka rrezikut. Ndërkoh gjinisë mashkullor është në trajtim Klinikën Infekti

Firmoset protokolli i dorëzimpranimit të kompetencave për mbrojtje e licencim pyjesh

# Ministri Stavileci ia dorëzon Kaçanikut "tapitë" e pyjeve

**Zyrtarë përgjegjës komunalë janë shprehur të jenë skeptikë sa i përket promovimit të një mbrojtjeje cilësore të pyjeve në të ardhmen, për shkak të numrit të vogël të rojtarëve, ndërsa kanë rikujtuar se 13.830 hektarë me pyje aktualisht mbrohen nga 6 sish**

KOHA Ditore — *Ekrem Raka*

KAÇANIK, 12 KORRIK - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ia ka dorëzuar Komunës së Kaçanikut kompetencat për mbrojtjen dhe licencimin e sipërfaqeve pyjore publike në territorin e kësaj komune. Protokolli i dorëzimpranimit të kompetencave është firmosur nga kreu i MBPZHR-së, ministri Blerand Stavileci, dhe nga kryetari i Kaçanikut, Xhabir Zharku, të hënë paradite, në Kaçanik. Ministri Stavileci ka vlerësuar se delegimi i kompetencave nga pushteti qendror në atë lokal do të kontribuojë zhvillimit të sektorit të pylltarisë, i cili ka trashëguar shumë probleme nga e kaluara. Njëri prej këtyre problemeve ka ... licencimit të pyjeve. "Këto kompetenca të bartura na i shtojnë përgjegjësitë, mirëpo besoj se punët në këtë rrafsh do të shkojnë mbarë e mirë tashti e tutje", ka thënë ai. Para ceremonisë së nënshkrimit të protokollit të dorëzimpranimit të kompetencave të sipërpërmendura, zyrtarë përgjegjës komunalë i kanë thënë KD-së se MBPZHR-ja ia ka transferuar Komunës së Kaçanikut buxhetin për 6-mujorin e dytë të këtij viti. "Buxheti i transferuar është në shumë prej 15.204 eurosh, ndërsa është i destinuar për pagat e stafit prej 8 vetash dhe për mallra e shërbime", ka thënë Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Financave. ...

Mbahet seanca e Kuven...

# Auditori gjen...

**Kreu aktual i Kamenicë... kryetarit, të cilat do të çoh... ka përmendur 10 mijë euro ... kompanie nga Gjilani d...**

KOHA Ditore — *Nexhat Buzuku*

KAMENICË, 12 KORRIK – Kuvendi i Kamenicës ka mbajtur seancën e radhës. Ka diskutuar raportin e auditorit të brendshëm dhe të jashtëm. Këshilltarët komunalë janë shprehur të shqetësuar me punën e ish-kreut komunal. Sipas raportit të auditorit të jashtëm dhe të brendshëm janë gjetur keqpërdorime dhe shkelje në menaxhimin e parasë publike për 2009-ën. Në raportin e auditorit të brendshëm të Komunës, Ismet Ahmeti, është thënë se ish-kreu i Kamenicës dhe stafi i tij nuk kanë respektuar procedurat ligjore të prokurimit, se ka pasur vonesa të mëdha në kryerjen e projekteve, ...

# Kaçaniku "ia merr" pyjet qeverisë

**KAÇANIK →** Komuna e Kaçanikut ka marrë kompetencat për menaxhimin e pyjeve në territorin e kësaj komune, pasi ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Blerand Stavileci, dhe kryetari i Kaçanikut, Xhabir Zharku kanë vënë të hënën firmat e tyre për bartjen e kësaj përgjegjësie nga niveli qendror në atë lokal. Në ceremoninë e transferimit të kësaj kompetence, në të cilën morën pjesë drejtuesit kryesorë dhe ata të dikastereve të pushtetit



lokal të Kaçanikut, ministri Stavileci këtë hap e ka konsideruar si kontribut për sektorin e pylltarisë, i sektorit i cili në të kaluarën kishte trashëguar shumë probleme. "Presim që me ligjin e ri roli dhe përgjegjësitë e strukturave kompetente në nivelin qendror dhe atë lokal përkitazi me pyjet, të definohen edhe më mirë, ku secili prej tyre do të mund ta realizojë në praktikë atë që është objektiv më i rëndësishëm i yni-mbrojtja e pyjeve dhe mos degradimi i tyre", ka vlerësuar ministri Stavileci, duke shtuar se realizimi i këtij objektivi është në strategjinë e ministrisë të cilën e drejton ai. "Me ndihm... e institucioneve komunale d... gjithë faktorëve relevan... MBPZHR-ja do të mund s... më më lehtë ta mbajë situa... nën kontroll, në mënyrë q... ruajmë pyjet", ka thënë kr... MBPZHR-së. Ndërkaq, kr... Kaçanikut, Xhabir Zharku, ... nimin e kësaj kompetence ... cilësuar si përgjegjësi më s... më për Komunën. Ai ka sh... hur besimin e tij se megjith... punët do të shkojnë mbarë ... mirë. **K. SALLAHU**

E MERKURE 11 GUSHT 2010
t Nura / xhavit.nura@infopress-rh.com
1€
1.2684 USD
0.8404 GBP
1.3520 CHF
136.26 LEKË

# Muajin tjetër, autostrada për Shkup

Xhavit Nura
Kaçanik, 10 gusht



Kaçaniku, në Ditën e Dëshmorëve, i gëzohet edhe një investimi të qeverisë. Të martën është përuruar rruga e re e asfaltuar, e cila lidh Kaçanikun e vjetër me magjistralen Prishtinë-Shkup.
Në përurimin e rrugës kanë marrë pjesë zyrtarë të lartë të Ministrisë së Transportit, deputetët e Parlamentit të Kosovës, Rexhep Hoti e Bahri Hyseni dhe zyrtarë komunalë.
Fatmir Limaj, ministër i Transportit, ka deklaruar se kjo rrugë ka një rëndësi mjaft të madhe për banorët e këtij fshati. "Për ne sot është një moment i veçantë, për arsye se po bëjmë përurimin e një rruge të re në Ditën e Dëshmorëve të Komunës së Kaçanikut, në ditën kur një njeri i madh jo vetëm i Kaçanikut, por edhe i Kosovës, komandant Agim Bajrami, e dha jetën për lirinë e Kosovës. Agimi ishte njëri nga bashkëluftëtarët tanë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kushtrimi i së cilit ngriti jo vetëm Kaçanikun, por gjithë këtë zonë, njëherësh ishte njëri nga shtyllat kryesore të UÇK-së", tha Limaj.
"Ne si popull dhe si Qeveri e Kosovës po vazhdojmë të bëjmë atë që kanë pasur ata ëndërr, ata që u flijuan për lirinë e këtij vendi, e cila ëndërr ka qenë liria e Kosovës, por njëkohësisht edhe ndërtimi i atdheut"

# Përroskat e Kaçanikut lirohen nga mbeturin

Pastrimi i përroskave është projekt i përbashkët i Komunës dh kuadër të programit të punëve publike për gjenerimin e punësi varfërisë

Kjani Sallahu



Nis pastrimi i përroskave dhe i lumit Neredime

KAÇANIK → Shtrati i lumit Neredime dhe përroskat në qytetin e Kaçanikut dhe ndonjë tjetër nëpër lokalitete të kësaj komune, kanë nisur të "çlirohen" nga mbeturinat dhe barishtet e vrazhda. Tridhjetë punëtorë me kontrata sezonale tremuajshe kanë filluar të enjten realizimin e punimeve, fillimisht në shtratin e lumit Neredime në qytet. Sipas zyrtarëve komunalë 15 punëtorë janë angazhuar nga kompania e cila e ka fituar tenderin dhe po aq janë përzgjedhur nga lista e të regjistruarve si të papunë në Zyrën e Punësimit. "Pastrimi i përroskave në komunën e Kaçanikut është projekt i përbashkët i Komunës së Kaçanikut dhe MPMS-së, në kuadër të programit të punëve publike për gjenerimin e punësimit dhe zvogëlimin e varfërisë", ka theksuar Rushan Ceka, drejtor i Shërbimeve Publike, e cila është duke e mbikëqyrur realizimin e këtij projekti. Sipas tij, me projekt janë planifikuar pastrimi i

se për realizmin e këtij projekti Komuna dhe MPMS-ja e kanë nënshkruar këtë marrëveshje më 1 qershor të këtij viti, ndërsa vlera e investimit është 43.092 euro. Zëdhënësi i Komunës, Ha-

e shtretërve të përroskave në lagjet "Rakoc" dhe "Ramadan Agushi". Ndërsa dje po bëhej punë në largimin e barishteve dhe mbeturinave afër "Urës së Konakut", një kalë i kug në

# "Deti i Zi" kërcënon Kaçanikun e Vjetër

Autoritetet lokale të Kaçanikut thonë se jemi në negociata me Ferizajn për ndërtimin e një impianti të ujërave të zeza, për ta eliminuar dukurinë e ndotjes së lumenjve

Kjani Sallahu



Muzaferi tregon "të zezat" e lumit "të zi"

KAÇANIK → Kundërmimi i ujit si pasojë e derdhjes së fekaleve në rrjedhën e lumit Neredime, nga Ferizaj e deri në Kaçanik, ka dëbuar peshqit. Pakujdesia dhe mungesa e kontrollit për hedhjen e mbeturinave dhe ujërave të zeza ka prodhuar edhe konsekuenca deri në braktisje "sporadike" të banorëve që jetojnë skaj këtij "Deti të Zi". Banorët e lagjes "Topojani" të Kaçanikut të Vjetër janë disa nga "viktimat" e këtij "kanalizimi fekal".

Remzi Shabani e ka shtëpinë vetëm 30 metra nga uji i ndotur dhe me erë kundërmuese. Aroma e luleve të bollshme e të llojllojshme në oborrin e tij përballë një "prodhuesi plehrash" nuk mund ta ndryshojnë peizazhin e as të tretin kundërmimin.

"Pasdite i kisha harruar dritaret hapur dhe kur erdha në shtëpi në mbrëmje vonë nga era e rëndë nuk mund të hyja brenda për t'i mbyllur dritaret. Në këtë lum derdhen ujërat e zeza nga Ferizaj, të lokaliteteve e lagjeve skaj lumit, por edhe disa ë fshatit tonë. Sidomos qe 4-5 vjetët e fundit na është rënduar jeta këtu", thotë ky

paskam pasur edhe një problem të madh", thekson Muzaferi, ndërsa tregon ngjyrën e ujit të pistë dhe mbeturinat që gjarpërojnë nëpër "binarin" e lumit Neredime.

Ai rrëfen se si banorë të kësaj lagje ditë e më shumë po e braktisin këtë vend, ndërsa thotë se po të kisha troje tjetërkund nuk do ta ndërtoja shtëpinë këtu.

"Topojanëve". Banorë të kësaj lagje thonë se vetëm shiu apo bora që e zbutë këtë gjendje "aromatike", ndërsa nxehtësia e madhe e ngre këtë pjesë në situatë alarmi. Nga ana tjetër, drejtues të dikastoreve për ruajtjen e ambientit në Kaçanik thonë së bashku me Ferizajn po bëjnë plane për ndërtimin e një impianti të ujërave të zeza, për ta eliminuar ndot-

me komunën fqinje jemi në kontakt edhe sivjet dhe shpresojmë në zgjidhjen e këtij problemi. Drejtori Troni e ka cilësuar si të pamundshme daljen nga kjo situatë në qoftë se nuk jetësohet projekti i impiantit.

Ndryshe nga ky problem ndërkomunal, zyrtarë të ambientit thonë se janë duke e zbatuar Rregulloren e mjedisit dhe Urba-

jobindëse dhe formale, kurse procesverbalet janë jopërmbajtjesore, të ... kohës. Ata gjithashtu konsiderojnë si të paarsyeshme dhe të dëmshme ... thotë Rifaj.

### Strukturat komunale civile e të sigurisë të Kaçanikut bashkërisht kundër dëmtuesve të pyllit

# Policia e gjykata me marrëveshje për mbrojtje pyjesh



**Komuna e Kaçanikut, PK-ja dhe Gjykata Komunale janë marrë vesh për të bashkëvepruar në planin e uljes në minimum të përmasave të dëmtimit të pyjeve nga prerësit pa leje**

*Ekrem Raka*

KAÇANIK, 22 SHTATOR - Komuna e Kaçanikut, Policia e Kosovës dhe Gjykata Komunale janë marrë vesh për të bashkëvepruar në drejtim të uljes në minimum të përmasave të dëmtimit të pyjeve nga prerësit pa leje. Marrëveshja për këtë çështje është lidhur në takimin e përfaqësuesve të institucioneve të sipërpërmendura, të mërkurën. ... pyje dhe transportim të tyre. Ideja për bashkëveprim në mbrojtje të pyjeve publike është mbështetur edhe nga Hebib Livoreka, kryetar i Gjykatës Komunale në Kaçanik. "Do t'u japim prioritet për zgjidhje lëndëve penale që kanë të bëjnë me prerje pa leje drush në pyjet publike", ka premtuar Livoreka. Ai i ka njoftuar të pranishmit se sivjet, nga 1 janari e deri më 21 shtator, në gjykatën "e tij" kanë arritur gjithsej ... drush në pyjet publike, ndërsa janë zgjidhur 7. Zyrtarët komunalë kanë rikujtuar se nga muaji korrik Komunës së Kaçanikut i janë bartur kompetencat për menaxhimin e pyjeve publike. "Ndërkohë kemi konstatuar se ka një rënie të përmasave të dëmtimit të pyjeve, mirëpo ende nuk mund të themi se gjendja është e kënaqshme", është shprehur Nuhi Provoliu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

# Komuna kundërshton privatizimin e Stacionit të Veterinës

**Është pohuar se Agjencia Kosovare e Privatizimit e ka paditur në gjyq Komunën e Kaçanikut për uzurpim të objektit të Stacionit të Veterinës në Kaçanik, i paraparë për privatizim në raundin e radhës**

*Ekrem Raka*



KAÇANIK, 1 TETOR – Me arsyetimin se është aset i saj, Komuna e Kaçanikut është përcaktuar për kundërshtimin e vendimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për nxjerrjen në tender për shitje të objektit të Stacionit të Veterinës në Kaçanik. "Fleta poseduese numër 224 është dëshmi jona se ky stacion është pronë e Komunës së Kaçanikut", u ka thënë gazetarëve Nuhi Provoliu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, të premten. Sipas tij, Komuna e Kaçanikut menaxhon stacionin që nga viti 1985. Zyra në Gjilan e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, më 27 shtator, i kishte adresuar një shkresë zyrtare kreut të Kaçanikut, Xhabir Zharku, në të cilën thuhet se NSH Stacioni i Veterinës në Kaçanik është përzg... për shkak të procesit të papërmbyllur gjyqësor lidhur me pronësinë mbi të. "Kontestin gjyqësor në Gjykatën Komunale në Kaçanik e ... interesuar. "Me privatizimin e stacionit do të përfitojë ky njeri, ndërsa do të dëmtohet rëndë Komuna" është shprehur drejtori ...

ZËRI
KULTURA 15

TRASHËGIMI

# "Kushtetuta e Kaçanikut"- identitet i Kosovës

KAÇANIK. "Kushtetuta e Kaçanikut", e njohur për faktin e shpalljes së Kushtetutës së Republikës së Kosovës në këtë komunë më 7 Shtator 1990, në Ditën e Trashëgimisë Kulturore, e cila është mbajtur të dielën në Kaçanik me rastin e Ditës së Trashëgimisë Evropiane, nëpërmjet një debati është vlerësuar se "Kushtetuta e Kaçanikut" është njëra nga ngjarjet e mëdha historike të shqiptarëve. "Kjo kushtetutë, e cila është nxjerrë nga vullneti i popullit të Kosovës, si dhe Beteja e Kaçanikut e kohës së Idriz Seferit, përbëjnë dy nga ngjarjet kryesore historike të zhvilluara në Kaçanik", ka vlerësuar Ilaz Ramajli, ish-nënkryetar i Kuvendit të Kosovës në vitin 1990, duke e çmuar lart kontributin e kaçanikasve për organizimin e kësaj mbledhjeje në kushte shumë të vështira e të rrezikshme për rrethanat e asaj kohe. Ramajli u ka shpjeguar rinisë së kësaj komune në një debat të mbajtur në "Sallën e Kushtetutës" përkitazi me organizimin e mbledhjes në të cilën është shpallur Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Ai e ka cilësuar 7 Shtatorin si identitet të historisë së re të Kosovës. Me këtë rast ka folur edhe Jusuf Musa, shef i sektorit të arkeologjisë në MKRS, ndërsa më pas është debatuar rreth trashëgimisë kulturore.

K.SALLAHU



KOHA Ditore • 13

Shkurt...

## Francezët i dhurojnë Kaçanikut një zjarrfikëse




KAÇANIK, 10 TETOR – Zjarrfikësit francezë të Komunës Meythet, prefektura Haute Savoie, u kanë dhuruar kolegëve kaçanikas një kamion për fikje zjarresh. "Kamioni i markës 'Renault' nuk është i ri, por teknikisht është në gjendje të rregullt për intervenime", ka theksuar Rushan Ceka, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, të dielën. Ndërkaq, vartësi i Cekës, Ylber Shehu, shef i Shërbimit të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, ka nënvizuar se tashti ky shërbim i ka në dispozicion 3 kamionë për fikje zjarresh. *(E.R.)*

## "Ekorajoni" kërkon larjen e borxheve prej 330 mijë eurosh

# Ndihet mungesë e madhe e drurit "ilegal"

**Komuna megjithatë ka lënë mundësinë që qytetarët të furnizohen me dru mbeturina që kanë mbetur nëpër male, por edhe ka nënshkruar kontratë me 4 operatorë të licencuar për blerjen e druve**

Kjani Sallahu



**Kaçanik** → Një vendim i Komunës për të parandaluar prerjen dhe transportimin në rrugë ilegale të drurit, duket të ketë dhënë rezultatet e veta, por në anën tjetër është evidente se druri "ilegal" për djegie është duke iu munguar shumë qytetarëve në prag të dimrit, për të cilin është prognozuar se do të jetë i ashpër. Në disa lokalitete të kësaj komune, ku përveç furnizimit të banorëve të atyshëm janë furnizuar edhe komuna të tjera, këto ditë banorët kërkojnë dru gjetiu, pasi nuk kanë gjetur nga bashkëfshatarët. A. K., një qytetar buzë malit Sharr, ende nuk i ka siguruar drutë e dimrit. "Gjithnjë kam blerë dru të pavulosura. I kam blerë këtu në lagjen time nga një person, por më ka thënë se nuk po guxon të bartë dru", tregon ky hallexhi.

Sipas një vendimi të Komunës, çdo dëmtuesi të pyjeve apo transportuesi ilegal të druve u konfiskohen mjetet me të cilat prehen drutë apo transpor-

# "Urës së Konakut" i shtohet edhe një krah

**Ky projekt pritet të realizohet falë një donacioni të Qeverisë Zvicerane, e cila i ka akorduar 50 mijë euro**

**KAÇANIK.** Vitin e ardhshëm urës ekzistuese mbi lumin Neredime në qytetin e Kaçanikut pritet t'i shtohet edhe një urë e re, duke binomizuar mbikalimin e lumit në rrugën kryesore të qytetit. Ky projekt pritet të realizohet falë një donacioni të Qeverisë Zvicerane, e cila i ka akorduar 50 mijë euro, ndërsa mësohet se do të participojë edhe Komuna e Kaçanikut.

Hajrush Dullovi, zëdhënës i komunës, ka thënë se ky projekt realizohet në kuadër të fazës së dytë të projektit zvicëran për përkrahje të qeverisjes lokale dhe decentralizimit- Logos, ndërsa realizohet nga Fondacioni zvicëran "Intercoorporation". "Për këtë projekt Zyra zvicerane ka alokuar 50 mijë euro, ndërsa Komuna do të participojë me 30 mijë euro.

